

Korrik 2017
Numri: 112
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

Ku je?



*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*

TË
RINJ


Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shoqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Korrik 2017

VITI: XI

NUMRI: 112

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardan Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7042 8245

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VIJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Historia është si shtegu i umeteve. Krenaria për mbartjen e amanetit hyjnor shpesh herë ka ndërruar dorë dhe vendin e njërit e ka marrë tjetri. Ky ndryshim, siç ka shkaqet e tij të dukshme, ka edhe ato të padukshme. Ky ajet fisnik na tregon qartazi se sipas cilit ligj hyjnor realizohet kjo e fshehtë:

"O ju që keni besuar! Nëse ndokush prej jush braktis besimin e vet, dijeni se Allahu do të sjellë njerëz, që i do dhe që e duan; të përlulur me besimtarët dhe të ashpër me femohuesit; që luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi. Kjo është mirësia e Allahut, të cilën Ai ia jep kujt të dojë. Allahu është Bujar i madh dhe i Gjithëditur." (Maide, 54)

Në këtë ajet fisnik bien në sy këto pesë cilësi të umetit prej të cilit Allahu Teala është i kënaqur:

1. Ndërmjet Allahut dhe këtij umeti ka një marrëdhënie me në qendër dashurinë. Ky umet është një popull që e ka zemrën të përkushtuar ndaj Allahut Teala. Asnjë dashuri tjetër nuk mundet dot t'ia kalojë dashurisë së Allahut te ai. Një dashuri e tillë është e domosdoshme dhe primare për të përfaqësuar sundimin e Zotit (xh.xh.), në sipërfaqen e tokës, sepse, të bësh një punë në emër të Atij, t'i japësh përparësi vullnetit të Atij ndaj vullnetit personal dhe vullneteve të tjera, të bëhesh rob vetëm i Atij dhe t'ia dedikosh çdo gjë Atij sa herë që të jetë e nevojshme, mund të realizohet vetëm në sajë të një dashurie të atillë.

2. Njerëzit e këtij umeti janë të përlulur ndaj besimtarëve. Mendjemadhësia është një pengesë mjaft e madhe që qëndron si kala e pamposhtur në frenimin për t'u bërë umet. Siç nuk mund të zhvillohen ndjenjat e vëllazërisë nëpër shoqëritë që e përçmojnë njëra-tjetrën, gjithashtu ato nuk mund të miqësohen, të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe të bëhen si një ekip.

3. Njerëzit e këtij umeti dinë të qëndrojnë denjësisht, fuqishëm dhe ndershmërisht ndaj femohuesve që nuk e pranojnë Zotin dhe të vërtetën. Asnjëherë nuk do të dalë një umet krenar nga ata që pothuajse e pranojnë poshtërimin për shkak të interesave të ndryshme të kësaj bote. Ata që përpiqen ta fitojnë krenarinë jo duke qëndruar në anën e Zotit (xh.xh.) dhe të vërtetës, por në anën e qafirëve dhe duke u përpjekur që t'u duken sa më mahnitës atyre, asnjëherë nuk do ta shijojnë krenarinë. Kjo është njëra prej humbjeve më të mëdha, në të cilën ka rënë sot umeti islam.

4. Ata nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi në rrugën e Zotit (xh.xh) dhe të vërtetës. Ai që nuk i beson kauzës së vet, nuk mund të ketë besim te vetja e tij. Ndërsa ata që nuk kanë besim në veten e tyre, nuk mund të bëjnë vepra proaktive, domethënë, vepra me në qendër vlerat. Njerëzit e tillë shtypen, nënshtrohen dhe e ulin kokën nga ndikimi i presionit që mund t'u bëhet. Andaj, krenaria nuk mund të fitohet me këndvështrimin "çfarë do të thonë të tjerët". Përkundrazi, respektin dhe krenarinë e fitojnë vetëm ata që thonë: "Ajo që duhet të bëhet është ajo që kërkon Zoti (xh.xh.) dhe e vërteta."

Umeti më i mirë është umeti mesatar. Domethënë, jo një umet në të cilin përfaqësohet radikalizmi, por në të cilin përfaqësohet mesatarja, ekuilibri dhe drejtësia. Në ajetin fisnik thuhet kështu për këtë cilësi të umetit krenar:

"Kështu, Ne ju kemi bërë një umet të mesëm, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju..." (Bekare, 143)

Përmbajtja



10

Besimtarit nuk i mbarojnë punët
Nuredin Jëlldëz



Ilaci shërues i dhunës dhe injorancës
Osman Nuri Topbash

34



14

22

Betejat e Kosovës 1389-1999
Dr. Ardjan Muhaj



- 5 Largohuni nga haramet
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- 8 Zemra të gjera sa deti
Dr. Adem Ergyl
- 12 Ruaje zemrën në namaz
Xhafer Durmush
- 14 Pendimi
Ibrahim Koç
- 16 Islami është çlirimi i zemrave
M. Ali Eshmeli
- 28 A nuk ka një kurë për autizmin?
Mikro Univers
- 30 Të kuptosh Kuranin,
natyrën dhe historinë
Një Ajet
- 32 Mbështetja tek Zoti... si zogjtë!
Një Hadith



42

- 40 El - Mutekebbir
Ilir Hoxha
- 42 Dashuria për Allahun kalon nga robërit e Tij
Prof. dr. Sulejman Derin
- 44 Vendosmëria për t'u bërë një umet krenar
Idris Arpat
- 46 Ku je, o umeti i Muhamedit?
Mehmet Dinç
- 48 Përse fëmijët e parë janë më të ndjeshëm?
M. Emin Karabaxhak
- 50 Kujdes nga rënkimi i atij
që i është bërë padrejtësi
Dr. Durak Puzmaz
- 53 Urtësi
- 54 Mendjemadhësia nuk është vetëbesim
Tuba Sëkmen


24



Shënime për marrëdhënien
e sistemit komunist me arkitekturën
Edison Çeraj

Gjërat me të cilat arrihet ëmbësia e besimit
Naim Drizaj

56



LARGOHUNI

NGA HARAMET

Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

Ebu Hurejra (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *“Kush prej (sahabëve dhe) umetit tim i merr (prej meje) pesë cilësi, punon me to dhe (ose) ua mëson atyre që mund të punojnë me to?”* Unë i thashë: *“I marr unë, o i Dërguari i Allahut.”*

Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut (a.s.), më kapi për dore dhe m'i radhiti ato një nga një:

“Largohu nga kryerja e veprave që Allahu i ka bërë haram! (Si rezultat) do të bëhesh prej adhuruesve më të mirë.”¹

LIDHJA MYSLIMAN – PJEKURI

Thelbësore është që të mendojmë dhe të pranojmë se çdo mysliman është i dhënë dhe i prirë për t'u bërë një njeri i pjekur, sepse asnjë fetar dhe asnjë fetari që nuk e ka një nijet dhe qëllim të tillë, nuk kanë ndonjë vlerë të madhe. Feja, fetaria dhe pjekuria nuk përbëhen nga një bukuri dhe veçori që fillon e mbaron duke thënë “besova”. Andaj besimtari ka nevojë të vazhdueshme për t'u zhvilluar, thelluar dhe lartësuar.

Në ajetin fisnik: **“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?!”** (Ankebut, 2) – dhe në shumë ajete të tjera, njoftohet qartazi se kjo botë është një skenë provimi dhe se ky provim mbështetet në një

1. Ahmed bin Hanbel, Musned, II, 310; XVI, 289; Tirmidhi, VIII, 275; Mishkatu'l-Mesabih, hadithi nr: 5171. Në pjesën tjetër të hadithit përmenden këto këshilla:

- Ji i kënaqur me riskun që ta ka dhënë Allahun! (Si rezultat) do të bëhesh njëri prej njerëzve më të pasur.
- Sillu me mirësi ndaj fqinjit! (Si rezultat) do të bëhesh besimtar i pjekur (prej të cilit fqinji është i sigurt).
- Duaq dhe kërkto edhe për njerëzit ato që do dhe kërkon për veten tëndë! (Si rezultat) do të bëhesh prej myslimanëve të pjekur.
- Mos e tepro në të qeshur, sepse e qeshura e tepruar e vret zemrën.

urtësi themelore, si dalja në pah se kush do të jetë më i përkushtuari nga aspekti i adhurimit/veprave të mira.

Në lidhje me aspektin real të sprovimit në vepra, ka tri lloj dispozitash të rëndësishme. Dy të parat prej këtyre dispozitave mbartin një rëndësi jash-tëzakonisht të madhe:

Fi'lu'l-me'murat: Kryerja brenda mundësisë e atyre që urdhërohen;

Terku'l-mahzurat: Lënia në mënyrë të prerë e atyre që janë të ndaluara (haram);

Tevakkuf ale'sh-shubuhut: Ndalimi nga veprat që janë të dyshimta.

I Dërguari i Allahut, pagja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, në hadithin fisnik që po përpiqemi ta shpjegojmë na tregon se njëra prej këtyre tri dispozitave është më e rëndësishme nga të tjerat në lidhje me ndikimin që ato kanë ndaj njëra-tjetrës dhe ajo është: Largimi nga haramet, domethënë, Terku'l-mahzurat.

Edhe në një hadith tjetër fisnik, Pejgamberi e ka shpjeguar këtë temë me radhë duke filluar nga ndalesat dhe pastaj te urdhëresat: Ai (a.s.), ka thënë:

"...Çfarëdo që jua kam ndaluar, largohuni menjëherë dhe në mënyrë të prerë nga ajo! Çfarëdo që jua kam urdhëruar, kryejeni sa të keni mundësi!" (Buhari, I'tisam, 2.)

LARGIMI NGA HARAMET

Një e vërtetë që dihet nga të gjithë është se "largimi nga haramet", domethënë, lënia e harameve, siç përfshin të gjitha gjërat e ndaluara, në të njëjtën kohë përfshin edhe moskryerjen e obligimeve që janë urdhëruar, sepse, terku'l-me'murat, domethënë, moskryerja e gjërave që janë urdhëruar është prej "meharimeve", domethënë, prej gjërave që jemi urdhëruar të qëndrojmë larg tyre. Ata që janë të kujdesshëm në qëndrimin larg harameve, sillen me zgjuarsiri edhe kundrejt çështjeve të dyshimta, gjë e cila shihet qartë te ata.

Situatën mund ta shpjegojmë edhe kështu: Largimi nga haramet natyrisht e bën të domosdoshme edhe kryerjen e obligimeve. Ndërsa kryerja e obligimeve nuk mund të rezultojë gjithmonë edhe në lënie e harameve. Kjo dukuri është një e vërtetë e dhimbshme që shihet në jetën e myslimanëve dhe që nuk mund të mohohet. Çuditërisht, në stilin e jetesës së përditshme të disa myslimanëve që janë të përpiktë në namaze e ibadete, mund të vihen re edhe haramet. Veçanërisht në kushtet e ditëve të sotme, sado që myslimanët të bëjnë kujdes, jeta e qytetit që është pushtuar nga haramet dhe ndalesat po përbën një rrezik të madh. Pothuajse në çdo vend është e pamundur të gjesh një qoshe të pastër nga primitivitetet moderne dhe haramet.

Mjetet e komunikimit dhe informimit masiv, media e shkruar dhe ajo vizuale po bëhen shkak për kryerjen e harameve në atë apo këtë mënyrë si mysafirë –ndoshta edhe të padëshiruar- në shtëpitë e myslimanëve. Nëse e marrim parasysh një gjendje të tillë, vëmë re se kuptimi i paralajmërimit dhe inkurajimit i të Dërguarit të Allahut (a.s.), në formën: "*Largohu nga kryerja e veprave që Allahu i ka bërë haram! (Si rezultat) do të bëhesh prej adhuresve më të mirë.*", duhet të merret shumë më seriozisht në ditët e sotme.

DY MYSLIMANË

Sipas transmetimit të Xhabir ibn Abdil-lahit, Allahu qoftë i kënaqur nga ai dhe babai i tij, në audiencën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), një person u përmend dhe u lavdërua për shkak të ibadetit e përpjekjes së tij dhe një tjetër për devotshmërinë (qëndrimin larg harameve) të tij. Në këtë mënyrë e pyetën të Dërguarin e Allahut (a.s.), se cili ka vepruar më saktë. Nisur nga kjo, Resulullahu (a.s.), u tha: "*Nuk ka si qëndrimi larg harameve.*" (Tirmidhi, Kijame 60 (IX, 59, (hadhithi nr. 2519); Bejhaki, ez-Zuhdu'l-kebir, II, 312, (hadithi nr. 831).

Ndërmjet myslimanëve që nuk largohen edhe aq shumë nga mëkatet, edhe pse përpiqen t'i kryejnë obligimet dhe myslimanëve që preokupohen me



nafilet, edhe pse kanë mangësi dhe borxhe në fuqinë e obligimeve, ka një gabim të përbashkët në vlerësimin e përparësisë ndërmjet detyrave dhe në kryerjen e tyre sipas përparësisë në rrugën që shkon drejt përsosmërisë.

Padyshim se feja islame është një fe që posedon radhë në sistem, rregulla dhe vlera. Për këtë arsye, në çdo mendim dhe vepër në jetën e myslimanit ka një radhë përparësie. Edhe lartësimi drejt përsosmërisë/pjekurisë ka pikën e fillimit, shkallët e nevojshme që duhet të ndiqen dhe fazat e domosdoshme. Paralajmërimi në hadithin e mësipërm na e shtron përpara mjaft qartë pikën e këtij fillimi.

PJEKURIA FILLON ME VERA (LARGIM NGA MËKATET)

Vera do të thotë mbrojtje, largim, devotshmëri, largim nga gjërat e dyshimta dhe (në një fazë më të përparuar) sjellje me kujdes e përpikëri edhe në çështjet mubah e mekruh. Edhe lënia e gjërave që nuk na interesojnë konsiderohet prej verasë. Në lidhje me këtë çështje, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “Lënia e çështjeve që nuk i interesojnë është prej bukurisë/përsosmërisë së fetarisë që ka njeriu.” (Tirmidhi, Zuhd 11; Ibn Maxhe, Fiten 12; Muvatta, Husnu’l-hulk 3, Kelam 17.)

Ja pra, një *vera* dhe një bukuri e atillë do të jetë fuqia shtytëse e hapave të mrekullueshëm që do të hidhen me kalimin e kohës dhe e veprave të pranueshme që do të kryhen.

Pikën më themelore në lidhje me këtë çështje e ka vendosur Pejgamberi ynë i Dashur (a.s.), kur po përcillte në Jemen Muadh ibn Xhebelin (r.a.). Atij i tha:

“O Muadh! Ndoshta pas këtij viti nuk do të takohesh më me mua. Ndoshta do të vizitosh xhaminë dhe varrin tim.” Muadh (r.a.), qau nga pikëllimi që i jepte ndarja prej Pejgamberit. I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, e ktheu nga Medina fytyrën e tij të bekuar, në

mënyrë që Muadh të mos e shikonte brengosjen e tij dhe pastaj i tha:

“*Myslimanët më të afërt me mua dhe që e meritojnë më shumë ndërmjetësimin tim janë të devotshmit, kushdo që mund të jenë dhe kudo që mund të ndodhen ata.*” (Mishkatu’l-Mesabih, hadithi 5227.)

Siç shihet qartë në hadithin fisnik, ky rregull nuk priset nga cilido popull, xhemat, ngjyrë dhe racë qoftë myslimani. Gjithashtu, ky rregull nuk ndryshohet nëse myslimani është prej të parëve të shoqërisë apo prej njerëzve të thjeshtë të saj. Po ashtu, ky rregull nuk ndryshon as nga vendndodhja e besimtarit kudo që mund të gjendet ai, si në Mekë, Medinë, Jemen, Basra, Kufe apo Stamboll. Myslimanit i jep vlerë dhe e afron

te Pejgamberi (a.s.), vetëm dhe vetëm devotshmëria, domethënë, një mënyrë jetese me respekt kundrejt Allahut Teala duke filluar nga largimi prej haramëve.

Në të vërtetë, edhe në ajetin fisnik është njoftuar se dinjiteti, krenaria, nderi dhe vlerat e vërteta gjenden në devotshmëri:

“...Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.”

(Huxhurat, 13) Ndërsa në një ajet tjetër fisnik njoftohet se ky rregull ka qenë i vlefshëm për të gjitha umetet:

“E Allahut është gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Ne i kemi porositur ata që u është shpallur Libri para jush dhe juve: Frikësojuni Allahut!..” (Nisa, 131)

Nisur nga këto që thamë më lart, asnjë mysliman nuk ka të drejtë të kaplohet nga ndonjë ndjenjë epërsie apo privimi duke u shprehur se është prej këtyre apo atyre xhemateve, racave etj., jeton në këtë vend apo në atë kohë dhe të bëjë llogari sikur ka pasur apo nuk ka pasur shans. E rëndësishme është përpjekja për të bërë një jetë brenda kufijve të Islamit duke filluar nga largimi prej haramëve.





ZEMRA TË GJERA SA DETI

Dr. Adem Ergyl

Në Kuranin Fisnik, Allahu Teala, flet për zgjerimin dhe ngushtimin e kraharorëve. Në këtë kontekst përdor shprehjet “sherhu’s-sadr” dhe “diku’s-sadr”. Pastaj e shtjellon lidhjen që ka kjo gjendje me besimin dhe Islamin. Gjithashtu nxjerr në pah të vërtetën se zemrat që hapen ndaj Islamit shndrisin me një dritë prej Zotit (xh.xh.) dhe pastrohen prej shqetësimeve.

Kur fjala “sherh”¹, që në kuptimin leksikor do të thotë të hapësh, të zgjerosh dhe të shpjegosh një shprehje të mbyllur apo më kuptim indirekt, i bashkëngjitet sadrit (kraharorit), siç shprehet edhe Ragib el-Isfehani, do të thotë: “Hapje dhe zgjerim i kraharorit me një prehje dhe dritë hyjnore.”² Ndërsa fjala “dik”, që përdoret për të shprehur varfërinë, koprracinë dhe shqetësimin e brendshëm, përdoret edhe në kuptimet si, të ngushtohesh, të mërzhitesh dhe të brengosesh. Kur kësaj fjale t’i shtohet edhe fjala “sadr”, mbart kuptimet si, shqetësim i brendshëm, stres, mërztije, pikëllim dhe brengosje.³

Çështja e zgjerimit të zemrës (sherhu’s-sadr) dhe ngushtimit të saj (diku’s-sadr), së pari është një temë që mund të shtjellohet si hapje apo ngushtim i rrugës së zemrës nga këndvështrimi i besimit apo mohimit. Me një shprehje tjetër, hapja e perdes së inkarit/mohi-

mit që e mbështjell zemrën dhe hyrja e dritës së besimit në zemër është “sherhu’s-sadr”, ndërsa mbulimi i zemrës me mëkatin e inkarit është “diku’s-sadr”. Ky ajet fisnik që do të transmetojmë tani qartazi shpreh këtë kuptim: **“Allahu ia hap zemrën për (të pranuar) Islamin atij që dëshiron ta udhëzojë, ndërsa atij që dëshiron ta lërë në humbje, (ia mbyll zemrën e) ia shtrëngon gjoksin si të jetë duke u ngjitur në qiell. Kështu, Allahu, i ndëshkon ata që nuk besojnë.”**⁴

Prehja dhe qetësimi i zemrës që ngushtohet për shkak të faktorëve të jashtëm, mund të konsiderohet si një lloj i “sherhu’s-sadrit”. Allahu i Lartësuar, i Cili na njofton se të Dërguarit të Tij iu ngushtua kraharori për shkak të thashethemeve dhe sjelljeve të femohuesve⁵, e këshillon kështu Hz. Pejgamberin për t’ia qetësuar zemrën: **“Prandaj duro! Durimi yt është vetëm me ndihmën e Allahut. Dhe mos u pikëllo për ta e mos u ngushto për shkak të dredhive të tyre!”**⁶ Nisur nga kjo, pastrimi i zemrës së të Dërguarit të Allahut (a.s.), nga shqetësimet e brendshme e pikëllimet dhe prehja e qetësia e saj prej këtyre është një lloj “sherhu’s-sadr”. Për këtë arsye, edhe ajeti: **“Vallë, a nuk ta hapëm dhe zgjeruam ty (Muhamed)**

4. En’am, 125.

5. “Ne e dimë mirë, që ty të ngushtohet zemra nga fjalët e tyre...” (Hixhr, 97) Në lidhje me këtë çështje ka edhe ajete të tjera. (Shik. Hud, 12; Nahl, 127; Shuara, 24-25; Neml, 70.)

6. Nahl, 127.

1. Shik. Ragib, Mufredat, fq. 258; Asim Efendi, Kamus, I, 909.

2. Ragib, Mufredat, fq. 258.

3. Ragib, Mufredat, fq. 300; Asim Efendi, Kamus, 924.

kraharorin?⁷ – është komentuar edhe në formën: “A nuk të shpëtuam dhe qetësuam ty (Muhamed) nga shqetësimet dhe pikëllimet?”⁸

Këto lloj shqetësimesh dhe qetësimesh që ndodhin në një zemër me besim mund të shprehen edhe me termat kabz (ngushtim) dhe bast (zgjerim). Fjalët kabz (inkibaz) dhe bast (inbisat) që më së shumti njihen si terma mistikë, janë përmendur pranë njëra-tjetrës në këtë ajet të Kuranit Fisnik: “...**Allahu e shtrëngon (kabz) dhe e liron/zgjeron (bast) (riskun)...**”⁹

Edhe një çështje tjetër që mund të vlerësohet si “sherhu’s-sadr” është ngjarja e largimit të shqetësimeve, zhdukja e telasheve dhe vendosja e prehjes në zemër. Lutja e Musait (a.s.): “**O Zoti im! Zgjeroma kraharorin tim, lehtësoma punën time dhe zgjidhja nyjen e gjuhës sime!**” (Ta Ha, 25-27) – në këtë kontekst është “sherhu’s-sadr”. Edhe një herë tjetër Musai (a.s.), i parashtrori Zotit (xh.xh.), këtë kërkesë: “O Zoti im! Unë kam frikë se ata do të më përgënjeshtrojnë. Kraharori po më ngushtohet dhe gjuha s’po më zgjidhet. Për këtë arsye, jepi profeci edhe Harunit!” Në këtë kontekst, “sherhu’s-sadr” mund të shpjegohet edhe si qetësim i zemrës së njeriut dhe shtim të forcës për përballimin e vështirësive.

Ndërkohë që ngushtimi i zemrës e shndërron jetën në një xhehenem të vërtetë, zgjerimi i zemrës e kthen jetën në një paradys. Bota jonë e brendshme që fillon të zgjerohet me besim, në sajë të kësaj gjen prehjen dhe rehatinë për t’u dhënë përgjigje shumë pyetjeve që e shqetësojnë zemrën. Ndërkohë që hallkat e para të zgjerimit të zemrës realizohen me besim, ky zgjerim arrin hallka edhe më të gjera me zbatimin e dispozitave të Islamit dhe përjetimin e moralit të tij. Gjendja e njeriut për të qenë dhe për t’u ndjerë sikur e sheh Allahun në çdo gjë që bën, domethënë, kur njeriu arrin në gjendjen e ihsanit, atëherë, nuk mund t’i vihet ndonjë kufi gjerësisë së botës shpirtërore të tij. Veçanërisht mistikët i japin rëndësi të madhe zgjerimit të zemrës. Madje, bëjnë një lidhje direkte ndërmjet zgjerimit të zemrës dhe arritjes së nivelit njeri i përsosur. Mevlana Xheleddin Rumi (k.s.), e përshkruan kështu pakufizueshmërinë e zemrës:

“Zemra është një qenie në të cilën humbasin dhe bëhen të padukshëm njëqind qiej si këta shtatë qiej.”¹⁰

Kur bota shpirtërore pastrohet dhe edukohet, njeriu mund të shpëtojë nga ngushtimi i brendshëm. Ata njerëz që kanë brenda smirë, urrejtje dhe mendjemadhësi, natyrisht që përjetojnë ngushtim të zemrës. Egoizmi dhe koprancia janë prej sëmundjeve më të rënda shpirtërore që e ngushtojnë zemrën. Dhënia e zemrës pas kësaj bote dhe gjërave që ajo mbart, apo me një thënie tjetër, dhënia e zemrës pas dashurive

të përkohshme, përbën shqetësim shpirtëror. Një ditë Mevlana Xhelaleddin Rumi pa njërin prej ndjekësve të tij që ishte i mërzitur dhe i tha:

“Bir! I gjithë ngushtimi i zemrës vjen nga lidhja e zemrës me këtë botë. Nëse e konsideron veten një hiç, mund të shikosh çdo lloj ngjyre dhe mund të marrësh kënaqësi nga çdo lloj shijeje. Pastaj do t’ia hapësh krahët një bote të atillë që asnjëherë në të nuk do të përjetosh ngushtim të zemrës.”

Sahibu’l-vefa, Musa Efendi (k.s.), thotë:

“Njerëzit që janë të përkushtuar ndaj dëshirave të nefsit, edhe nëse kanë shumë ibadete, prapë se prapë janë të dëshpëruar, sepse kraharorët (zemrat) i kanë të ngushta. Ato që pëlqejnë janë vetëm opinionet dhe mendimet e tyre. Kudo që të gjenden këta njerëz, nxjerrin kontradikta, sepse bota shpirtërore e tyre është e errët. Sado që të bëhen përpjekje, me njerëz të tillë nuk mund të ndërtohet një raport miqësor. Kur këtyre njerëzve t’u tregoni të bardhën, thonë se është e zezë, edhe pse e dinë që është e bardhë. Kur t’u tregoni të zezën, thonë se është e bardhë, edhe pse e dinë se është e zezë. Njerëzit e tillë absolutisht nuk mund të duan asnjë. Për shkak se nuk duan asnjë, nuk duhen edhe nga njerëzit e tjerë, sepse ata kanë moral të ulët. Për këtë arsye, me këta njerëz asnjëherë nuk duhet të këshillohemi, madje, duhet të qëndrojmë larg tyre sa të jetë e mundur. Gjendja e ngushtimit të zemrës është një sjellje e çuditshme që shikohet te njerëzit e ashpër, që e shikojnë veten mbi vëllezërit besimtarë të tjerë duke u mposhtur nga ndikimi i nefsit, që s’kanë vizion dhe që janë mendjengushtë. Ata që janë në këtë gjendje nuk mund të kenë marrëdhënie të mirë me asnjë njeri. Ata nuk kanë vendosmëri në asnjë punë dhe e gjithë dita e tyre kalon me zemërim dhe shqetësim. Këta njerëz bëjnë më shumë dëm se dobi. Këtë dëm ia bëjnë edhe vetes, edhe shoqërisë.”

Nëse dëshirojmë ta bëjmë këtë botë një vend në të cilin jetohet, madje, në të cilin merret frymë lirisht krahas të gjitha dhimbjeve dhe gëzimeve, baticave e zbaticave, vështirësive e lehtësive, mund t’ia dalim mbanë vetëm me zgjerimin e zemrës. Ata të cilët e zgjerojnë zemrën, edhe vetë janë të qetë, edhe të tjerëve u falin prehje e qetësi. Gjëja për të cilën kanë më shumë nevojë njerëzit në jetën familjare, në jetën e biznesin, në fushat e shërbimeve fetare, në marrëdhëniet me fqinjët, shokët dhe miqtë, është pjekuria për zgjeruar zemrën. Ata që e kanë zemrën e gjërë, nuk mund të ndoten dhe turbullohen. Ajo që duhet të bëjmë në këtë rrugë është arritja e bindjes absolute në besim me anë të pastrimit dhe edukimit serioz të nefsit, zbatimi i dispozitave të Islamit, përjetimi i moralit të Islamit dhe më kryesorja, zgjerimi i zemrës me dhikër të vazhdueshëm aq sa ajo të mund ta përfshijë të gjithë universin dhe të fitojë vetëdijen se gjithmonë jemi nën vëzhgimin e Allahut Teala.

7. Inshirah, 1.

8. Elmallëllë, VIII, 5911.

9. Bakara, 245.

10. Mesnevi (përkth. Shefik Khan), V, 80, bejt: 872; Veçanërisht shik. Mesnevi, I, 223, bejt: 3488.



Besimtarit nuk i mbarojnë punët

Nuredin Jëlldëz

Besimtari është njeri i Kuranit Fisnik. Ai gjithmonë përparon me Kurandin. Ndërkohë që Kurani Fisnik i tregon besimtarit metodën për t'u bërë prej njerëzve me zemër të qetë, besimtarit nuk mund t'i mbarojnë punët përderisa ai (Kurani) i thotë në suren Inshirah: **“Kur ta mbarosh një punë, fillo tjetrën!”** (Inshirah, 7) Inshirah do të thotë rehati, qetësi dhe prehje. Ndërkohë që Kurani Fisnik, i cili është udhëzuesi i jetës së besimtarit, i tregon atij rrugën për t'u qetësuar, i tregon edhe domosdoshmërinë për të nxituar nga një punë në një punë tjetër. Kjo botë është një vend në të cilin mund të jetohej ngaqë dita ndjek natën dhe nata ndjek ditën. Po të mos vinte dita pas natës dhe nata pas ditës, jeta do të ndalonte. Edhe këndvështrimi i besimtarit ndaj punës është si ndjekja që dita i bën natës dhe nata i bën ditës. Ai vazhdimisht punon duke kaluar nga një punë në një tjetër. Besimtari

kalon nga ibadeti në punët e shtëpisë, nga shtëpia në vakëf, nga vakëfi në vizitat e të afërmve, nga vizita e të afërmve kalon aty ku duhet të shkojë dhe të gjendet një besimtar. Në këtë mënyrë, besimtari lidhet me sistemin e zemrës së qetë që ia ka treguar Allahu i Lartësuar.

Besimtari që punon vazhdimisht është më aktiv se besimtari që përdor kohë të caktuara për punët e tij. Ai që ka shumë punë dhe program të ngjeshur, bën më shumë punë. Absolutisht, punën e mbarojnë njerëzit e zënë me punë. Ata që kërkojnë kohën dhe mjedisin e përshtatshëm për ta kryer punën që duan të bëjnë, asnjëherë nuk do t'i gjejnë ato që kërkojnë. Një kërkim i atillë i ngjan kërkimit të pakuptimtë të atij që kërkon një botë që të ketë vetëm pranverë, pra, pa dimër dhe pa verë, në mënyrë që të kalojë një ditë të bukur. Kjo botë nuk është një vend i tillë.

Përkundrazi, kjo botë është vendi i atyre që mund të bëjnë punë brenda punëve siç është edhe vendi i atyre që dinë të jetojnë ndërkohë që shpërthejnë furtunat dhe stuhitë.

Besimtari është njeri i punës. Andaj, ngaqë është njeri i punës, asnjëherë nuk nguron për t'i përdorur deri në fund aftësitë që ia ka dhënë Allahu Teala. Besimtari është durimtar dhe i vendosur. Nisur nga ky këndvështrim, programi i ngjeshur në punë asnjëherë nuk pranohet si justifikim për t'u hedhur edhe në një punë tjetër. Ndërkohë që po e bëjmë jetën në një shumëllojshmëri aktivitësh, nuk mund ta çojmë dem atë (jetën) duke u marrë vetëm me një punë.

Të bësh më të mirën e mundshme është gradë e besimtarit, sepse besimtari nuk bën asnjë punë shkel e shko. Cilësia e besimtarit nuk mund të jetë vetëm në një punë. Ai, çdo gjë që e bën, e bën në mënyrën më të mirë. Mbi të gjitha bën edhe punë mbi punë. Ja, ky është niveli i besimtarit. Specializimin në një fushë nuk mund ta shohim si pengesë për këtë nivel. Fusha në të cilën jemi specializuar është emri i aftësisë që kemi për të siguruar të ardhurat (jetesën). Ne si besimtarë, kur themi "punë", nuk synojmë vetëm punën që e bëjmë për të fituar riskun tonë. Këtë e shohim nga një pikëpamje më e gjerë. Siç nuk mund të jetë jeta vetëm punë në fabrikë, edhe puna nuk mund të jetë vetëm të punuarit në fabrikë. Puna për një njeri mysliman që i është nënshtruar Islamit, i cili ia ka mbushur të gjithë jetën, është çdo punë që ka bërë dhe duhet të bëjë derisa të dorëzojë shpirtin.

Listën e punës mund ta fillojmë me punën që bëhet për të fituar riskun. Besimtari e sheh si ibadet fitimin e riskut. Andaj, punën për ta fituar riskun e sheh ndërmjet të gjitha punëve që do t'i bëjë duke i kryer me radhë. Edhe të administrosh shtëpinë apo të jesh përgjegjës nga ana e Allahut Teala i një shtëpie si burrë apo si grua, është një punë. Edhe këtë punë besimtari e shikon si ibadet, madje, këtë nganjëherë e sheh edhe si xhihad (luftë e shenjtë). Mbrojtja e nderit në shtëpi, edukimi i fëmijëve dhe hyzmeti kundrejt prindërve është prej punëve më të rëndësishme dhe primare të tij.

Besimtari i shikon prej punëve të cilat është i obliguar t'i bëjë edhe adhurimet duke filluar nga namazi. Ato i shikon në formën: "Çfarë kuptimi do të kishte jeta po të mos ishin adhurimet duke filluar që nga farzet?" Në këtë mënyrë, besimtari fillon të bëhet më entuziast dhe më produktiv.

Ndërkohë që besimtari gjendet brenda jetës, nuk

mund të sillet sikur nuk është brenda saj. Dalja në një mal për t'u bërë një besimtar i mirë nuk është e vlefshme për asnjë besimtar. Besimtari është njeriu i shoqërisë në të cilën jeton dhe që e orienton shoqërinë sipas besimit të tij. Besimtari është njeri social. Ai nuk mund të ketë një pikëpamje të kufizuar vetëm me shtëpinë e tij. Gjithashtu, nuk mund të jetë një njeri që e ka mbushur listën vetëm me të afërmit e tij. Besimtari është njeri i umetit. Ai ekziston bashkë me umetin dhe ekziston për umetin. Për këtë arsye, në kohën e drekës është në xhenazën e ndonjë vëllai besimtar. Në kohën e ikindisë është në dasmën e ndonjë vëllai tjetër besimtar. Ndërsa në mbrëmje është në vakëf për t'u takuar me shokët e tij, apo në ndonjë hallkë dhikri ose në ndonjë mësim fetar. Ndërsa, pasi të kthehet në mbrëmje te shtëpia, është në shtrat me bashkëshorten e tij.

Besimtari, i cili vazhdimisht është aktiv, pret detyrë dhe e kryen me besnikëri detyrën që i është dhënë, është njeriu që mbart të njëjtat cilësi me ata që punuan me entuziazmin për ta bërë shtet Islamit në njëzet e tre vjet. Vazhdimësia e brezit të sahabëve, të cilët ia dolën mbanë për t'u takuar me bashkëshortet e tyre dhe për t'u interesuar për fëmijët e tyre, ndërkohë që nxitonin nga një front në një front tjetër, nuk mund të arrihet me vajtime, por me këtë këndvështrim. Brezi që e futi në dorë të gjithë botën, por që e kishte ballin në sexhde sikur t'i ishte ngjitur, ngeli në historinë e kësaj bote si simbol i punës. Andaj, edhe besimtari është një njeri që e imiton besimin dhe pikëpamjen e atyre ndaj punës. Prej shenjave të besimtarit është se ai nuk nxjerr pretekste, por përpiqet me të gjitha mundësitë e tij.

Besimtarit nuk i mbaron puna ngaqë, gjendet në qendër të jetës në çdo kohë dhe në çdo vend. Përveç të tjerash, ai është një njeri që asnjëherë nuk dëshiron t'i mbarojnë punët. Ai e mbaron punën, por punët e tij nuk mbarojnë kurrë. Punët e shumta nuk e mërzhisin atë. Ai e pranon se ekziston për të punuar. Besimtari është si dielli. Ai e ngroh edhe tokën, edhe ujin.

Ne nuk duhet të mendojmë nëse duhet të gëzohemi apo jo kur të na mbarojnë punët që kemi. Vallë, për çfarë të gëzohemi kur të na mbarojnë punët? A të gëzohemi se na mbaruan punët, ndërkohë që gjendemi ndërmjet të gjitha këtyre problemeve pothuajse të pazgjidhshme? A nuk është më mirë të qash se sa të gëzohesh në një situatë të tillë?

RUAJË zemrën në NAMAZ

Xhafer Durmush

Namazi, i cili është përkujtimi i begatë i miraxhit të të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe shenja dalluese e Islamit tonë, është ibadeti më i rëndësishëm prej adhurimeve me të cilat jemi obliguar. Namazi është një adhurim që kryhet në mënyrë të vazhdueshme. Besimtarëve asnjëherë nuk u është lejuar që të mos e falin namazin në udhëtim, në sëmundje apo në gjendje të tjera të ngjashme me këto, por u është lejuar që t'i shkurtojnë rekatët e tij. Namazi e fut në disiplinë jetën e besimtarit duke filluar që nga periudha e pubertetit e deri në frymën e fundit të tij. Në shumë ajete të Kuranit Fisnik është përsëritur urdhri: *"Faleni namazin!"* – qoftë në mënyrë të vetme apo qoftë bashkë me zekatin.

Ndërsa me ajetin fisnik: **"Namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar."** (Nisa, 103) – është njoftuar obligimi i pesë kohëve të namazit. Ndërsa në suren Mu'minun është përmendur "frikë-respekti dhe vazhdimësia në namaz", të cilat janë prej tërësisë së kushteve të shpëtimit të përhershëm:

"Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përgjatur në namazin e tyre..." (Mu'minun, 1-11)

Këtu duam të tërheqim vëmendjen te dy çështje në lidhje me këto ajete fisnike. E para është: Edhe pse në Kuranin Fisnik është njoftuar për obligimin e namazit, nuk është dhënë informacion për mënyrën se si të falet ai. Ndërsa e dyta është: Namazit i është vënë kushti i frikë-respektit dhe vazhdimësisë, në mënyrë që ai të bëhet shkak për shpëtimin e përhershëm. Po, në Kuranin Fisnik nuk është dhënë informacion i detajuar në lidhje

me namazin, sepse çdo gjë që duhet ta dimë duke filluar që nga çështjet "lahik" e "mesbuk" dhe deri te dispozitat "zel-letu'l-kari", janë treguar me anë të praktikave dhe shpjegimeve të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ndërsa në brezat e mëvonshëm këto të dhëna janë mbledhur dhe janë bërë libra...

I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, thotë në një hadith fisnik: *"Faleni namazin siç më keni parë mua duke e falur!"* (Askalani nga Buhari, I, 379.) Në këtë hadith fisnik janë treguar kufijtë e kijamit (qëndrimin në këmbë), kiraatit (këndimit të Kuranin përgjatë qëndrimin në këmbë), të rukusë dhe të sexhdes. Po ashtu, janë treguar dhe fillimi dhe mbarimi i kohëve të namazeve farz. Përveç të tjerash, i Dërguari i Allahut (a.s.), na ka inkurajuar që ta bëjmë si traditë faljen e namazit të Duhasë, Evvabin dhe Tehexhhudit. Ndërsa në një hadith tjetër, (a.s.), na ka dhënë këtë sihariq duke u shprehur:

"Pesë kohët e namazit i ngjajnë një lumi që kalon para shtëpisë së ndonjërit prej jush dhe ai lahet pesë herë në ditë aty." (Muslim, Mesaxhid, 284.) Po ashtu, me hadithin fisnik: *"Namazi i falur me xhemat është njëzet e shtatë herë më i mirë se namazi i falur i vetëm."* (Buhari, Ezan 30.) – na ka inkurajuar që namazin ta falim me xhemat. Pejgamberi na i ka treguar edhe rregullat e pastërtisë nëpër xhamia.

I Dërguari i Allahut (a.s.), e ka qortuar dikë që e falte namazin pa e respektuar tadilu'l-erkanin, duke i thënë: *"Kthehu dhe fale namazin përsëri, sepse ti nuk ke falur namaz."* Pasi e qortoi tri herë, i tha për t'ia mësuar se si falet namazi: *"Bëj ruku në namaz dhe qëndro në ruku de-*

1. Shih. Bekare 43; 110; En'am 72; Haxh, 78.

risa të të qetësohen të gjitha gjymtyrët! Pastaj, kur të ngrihesh nga rukuja, drejtohu mirë! Pastaj shko në sexhde dhe qëndro në sexhde derisa të të qetësohen të gjitha gjymtyrët. Pastaj ngrihu nga sexhdeja dhe qëndro ulur derisa të të qetësohen të gjitha gjymtyrët. Pastaj shko përsëri në sexhde dhe qëndro në sexhde derisa të të qetësohen të gjitha gjymtyrët. Pastaj vepra kështu në të gjitha namazet e tua.” (Muslim, Salat, 45.)

Tashmë mund të themi: Me anë të këtyre haditheve fisnike të të Dërguarit të Allahut (a.s.), sa herë që t’i lexojmë, do ta kuptojmë më mirë inkurajimin dhe qortimin e Pejgamberit. Gjithashtu, krahas kushteve dhe rëndësisë së namazit, do ta perceptojmë edhe frikë-respektin ndaj Allahut Teala në namaz dhe vazhdimësinë që duhet të shfaqim përgjatë gjithë jetës në lidhje me namazin. Përveç të tjerash, do të përpiqemi më shumë për t’i rinovuar emocionet tona në lidhje me faljen e namazit, i cili është shenja jonë dalluese për besimin që i përkasim. Pastaj do të jemi më të përpiktë ndaj faljes së namazit duke e respektuar tadilu’l-erkanin, në mënyrë që prehja shpirtërore të depërtoje te të gjitha gjymtyrët tona. Pastaj do të përpiqemi që të lidhemi me poseduesin e zemrës kur të drejtohemi nga kibla fizikisht dhe do të përpiqemi të jemi të vetëdijshëm në lidhje me lartësimin e Zotit (xh.xh.), që bëhet me fjalët e Tij (me këndimin e Kuranit).

Nisur nga këto që thamë, nefsini duhet ta përgatisim më shumë në lidhje me namazin. Gjithashtu duhet të përpiqemi seriozisht që këtë vetëdije ta mbartim edhe te të afërmit tanë, edhe te ata që i kemi nën përgjegjësi. Gjithmonë duhet të jemi të përpiktë në namaz, në mënyrë që namazi ynë të konsiderohet miraxh. Namazin asnjëherë nuk duhet ta falim sikur të ishte një detyrë. Këtë e kemi të nevojshme që ta përsërisim gjithmonë në mënyra të ndryshme... Në lidhje me këtë çështje, besoj se është shumë e dobishme që t’ia vëmë veshin paralajmërimit të Imam Gazaliut, rahmetullahi alejh, i cili thotë:

“Pa mendo pak! Kufiri i fundit i ibadetit dhe dhikrit tënd është namazi. Për këtë arsye, kontrolloje zemrën tënde! Pa shikojë një herë se në çfarë gjendjeje është ajo! Kur ti je në namaz, Shejtani i mallkuar ta merr zemrën dhe ta çon nëpër rrugë, të bën që të mendosh për llogaritë e të tjerëve, të kujton përgjigjet që mund t’ua japësh njerëzve kryeneçë dhe të shpie nëpër lugina e male. Ai të shpërqendron aq shumë sa që t’i kujton të gjitha ato që ke harruar jashtë namazit. Shejtani ta sulmon zemrën veçanërisht kur je në namaz. Ndërkohë namazi është pasqyra e zemrës. Mirësia dhe ligësia e zemrës bëhet e qartë në namaz. Një namaz që falet me zemër të mbushur plot me epshet e kësaj bote, nuk pranohet nga Zoti (xh.xh.). Siç e shikon edhe vetë, Shejtani përpiqet të të largojë nga qëllimet sublime edhe në namaz duke i shtuar vesveset e tij. Ai të dëmton siç të dëmtojnë ilaçet që konsumohen pa bërë dietën e duhur. Nëse dëshiron të shpëtosh nga shejtani, para së gjithash bëj dijet me devotshmëri. Ja, pikërisht atëherë, Iblisi i mallkuar do të ikë edhe prej teje siç ka ikur nga Umeri (r.a.).”

Le ta përmbledhim temën me një fjalë të Abdullah ibn Abbasit, radijallahu anhuma: “Dy rekatë namaz që falen me qetësi dhe frikë-respekt ndaj Zotit (xh.xh.), janë më të mira se namazi i falur nga mbrëmja e deri në mëngjes prej një zemre të shkujdesur.”


HORIZONTET E PAFUNDME TË MIRËSISË

Në suren Bekare thuhet: **“Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirimin e të robëruarve; e atij që fal namazin dhe e jep zekatin; dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun.”** (Bekare, 177)

Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës nga lindja apo perëndimi. Përkundrazi, mirësia është pasuri e përbashkët e të gjithë njerëzve. Për këtë arsye, specifikave që jepen me detaje në ajetin fisnik duhet t’u dalim për zot si një tërësi. Këto mund t’i mbledhim në katër pika kryesore: 1) Besimi ndaj kushteve të imanit, 2) Kryerja e ibadeteve, 3) Ndershmëria dhe besnikëria në vepra, 4) Posedimi i virtyteve etike.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: **“Mirësia është moral i lartë. Ndërsa mëkat janë ato gjëra që ta brejnë zemrën dhe nuk dëshiron që t’i dinë njerëzit.”** (Muslim, Birr 14, 15.) Ndërsa në Ihjau Ulumi’d-Din ka një transmetim të tillë: **“Janë dy vepra që s’ka më të këqija se ato: T’i bësh shirk Allahut dhe t’u bësh dëm robërve të Allahut. Janë dy vepra që s’ka më të mira se ato: T’i besosh Allahut dhe të jesh i dobishëm kundrejt robërve të Allahut.”**

Si përfundim, mund të themi: Dyert e mirësisë janë të hapura për të gjithë, qofshin të mëdhenj apo të vegjël. Kufijtë e tyre janë të gjerë aq sa korniza e hallallit. Mjafton që ne ta plotësojmë fetarinë tonë me mirësi.





Pendimi

Ibrahim Koç

Pendim do të thotë që njeriu të ndjejë pishmanllëk për mëkatin që ka bërë dhe t'i drejtohet Allahut Teala duke iu përgjëruar që ta falë. Pendim do të thotë pastrim nga papastërtitë e mëkatis dhe premtim ndaj Zotit (xh.xh.), se nuk do të bëhet më ai mëkat.

Pendimi është kalim nga mëkati në sevap dhe kthim nga e keqja në të mirë. Pendimi është kthim te Allahu i Lartësuar dhe dalje nga errësira në dritë. Pendimi është pastrim dhe shpresa e vetme për të shpëtuar e njeriut që është ndyrë me mëkate. Pendimi është pishmanllëk dhe çdo pishmanllëk

është pendim. Pendim do të thotë që robi ta kuptojë gabimin e tij dhe të kthehet nga ai gabim, duke e rregulluar përsëri jetën e tij shpirtërore që e pati prishur me mëkate.

Sa e bukur është përpjekja për pendim që i bën zemrat të rrahin fort para se të vijë një ditë në të cilën shikimet do të çoroditen dhe zemrat do të rrahin fort! Ah sikur t'ia dilnim mbanë që ta bënim pendimin aq të madh sa ai të mbyllte çdo shteg që hapë mëkati. Po, pendimi është emri i një kthimi të tillë. Në të kundërt, çdo fjalë është një gënjeshtër dhe çdo vepër

është një mashtrim, sepse, pohimi për pishmanllëk kundrejt të këqijave të bëra pa u rregulluar gjërat që janë bërë me mëkate dhe pa u shfaqur trishtim në ndjenja, vuajtje në shpirt dhe lot në sy, është i pavërtetë dhe i papranueshëm.

Lum për ata që i kuptojnë mëkatet e tyre dhe nxi-tojnë për t'u penduar!

Pendimi është dhimbja e turpërimit që japin mëkatet dhe që ndjehet në thellësi të ndërgjegjes. Pendimi është lartësim i përgjërimeve që bëhen në net të errëta e të qeta drejt Arshit të Zotit (xh.xh.). Pendimi është emri i lagies së sixhadeve me lotët e pishmanllëkut që rrjedhin nga sytë. Pendimi është plagë e brendshme që formohet brenda robit për shkak të mëkatit, është rënkim që vjen nga brendësia e tij dhe që ia djeg zemrën, është qarje me ngashërim nëpër qoshe të vetmuara dhe është lot që derdhet në sixhade. Këta lot janë stoli e pendimit dhe dokument i tij.

Allahu e bën haram (përgjithmonë) zjarrin e xhehenemit për atë besimtar që derdh lot për shkak të frikës ndaj Allahut, edhe nëse ai lot është sa koka e mizës dhe arrin deri te buzët e tij. Ata që pendohen siç duhet për mëkatin e tyre, janë sikur të mos e kenë bërë atë mëkat. Allahu Teala e pranon pendimin e robit përderisa nuk i ka ardhur shpirti në fyt. Ai që dëshiron të pendohet, duhet ta bëjë këtë lutje me frikërespekt ndaj Zotit (xh.xh.) dhe sa më shpesh: “Estagfirullah ledhi la ilahe il-la hu hajje'l-kajjume ve etubu ilejh...”

Atij që i kërkon falje Allahut dhe i përgjërohet Zotit (xh.xh.), duke u shprehur se është penduar për mëkatet e tij, i falen mëkatet.”

Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik:

“...Ai që pendohet, beson dhe punon vepra të mira. Një njeriu të tillë Allahu ia ndërron veprat e këqija në të mira. Allahu është shumë Falës e Mëshirëplotë.” (Furkan, 70)

Kur Allahu Teala e gjen robin duke iu penduar në derën e Tij, gëzohet më shumë se ai që humb çdo gjë dhe i gjen përsëri. Çdo mëkat që bëjmë dhe çdo dyshim që hyn në kokën tonë, hapin plagë të thella në zemrën dhe shpirtin tonë. Mëkati hyn në zemër, e nxin atë, e ngurtëson derisa ta nxjerrë prej saj dritën e besimit dhe e shuan atë dritë. Brenda çdo mëkati ka një rrugë që të shpie në kufër. Nëse ai mëkat nuk pastrohet shpejt me pendim, e kafshon zemrën si një gjarpër i vogël shpirtëror.”

Në hadithin fisnik thuhet: *“Nëse njeriu që bën mëkat merr abdest bukur duke i respektuar rregullat e tij, fal dy rekate namaz dhe pendohet për mëkatin e tij, Allahu e fal atë.”*

Mëkati nuk shkruhet dhe nuk merr ndëshkim pa

kaluar nga mendimi në praktikë. Atij që i kërkon Zotit (xh.xh.), falje shtatëdhjetë herë pas namazeve, i falen mëkatet që ka bërë... O njeri! Edhe nëse i ke mëkatet e mëdha aq sa kanë zënë horizontet, nëse pendohesh, Allahu Teala do të t'i falë duke mos e parë madhësinë e tyre. Atij që thotë njëqind herë në ditë “subhanallahi ve bihamdih”, i bien mëkatet (që janë bërë kundër të drejtave të Allahut), edhe nëse janë sa shkuma e detit. Pa dyshim se Allahu i do ata që pendohen dhe pastrohen. Allahu Teala thotë në Kuran:

“Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'i gjejë rrugë-dalje (nga çdo vështirësi) dhe do t'i japë risk prej nga nuk e pret. Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai. Allahu e përmbush me siguri vendimin e Tij dhe për çdo gjë Ai ka caktuar masë.” (Talak, 2-3)

PENDIMI NASUH

Nasuh do të thotë njeri shumë këshillues dhe shumë i sinqertë. Ndërsa pendim “nasuh” do të thotë kthim te Allahu Teala me një pendim të dëlirë që e bën mëkatarin ta lërë mëkatin dhe e shpëton atë nga gjynahu. Gjithashtu pendim “nasuh” do të thotë ta lësh mëkatin menjëherë, të bëhesh pishman për ato që kanë ndodhur në të kaluarën, të vendosësh të mos bësh mëkate në të ardhmen dhe t'ia kthesh hakun (të drejtën) çdo njeriu që ia ke uzurpuar. Në ajetin fisnik thuhet:

“O ju, që keni besuar! Kthehuni tek Allahu me një pendim nasuh (të sinqertë), që Zoti juaj t'ju shlyejë gabimet e t'ju shpjerë në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, Ditën, kur Allahu nuk do ta turpërojë Profetin dhe ata që besuan bashkë me atë. Drita e tyre do të shkëlqejë para tyre dhe në të djathtë të tyre. Ata do të thonë: “O Zoti ynë, përsose dritën tonë dhe falna ne! Vërtet Ti je i Fuqishëm për çdo gjë.” (Tahrim, 8)

Në një hadith fisnik njoftohemi se ai që pendohet në përputhje me kushtet e pendimit dhe e mban me vendosmëri pendimin e tij, do të jetë në gradën e dëshmorëve. Ndërkohë, pendimi i atij që nuk e lë mëkatin edhe pse pendohet, është tallje me derën së cilës i është drejtuar.

Ai që thotë se ka frikë nga xhehenemi, por që nuk largohet nga mëkatet, ai që thotë se është përmalluar për xhenetin dhe nuk bën vepra të mira dhe ai që thotë se e do Pejgamberin, por është i pa interesuar kundrejt traditës profetike, nuk mund të jetë serioz në pohimin e tij.



Islami

është çlirimi i Zemrave

— M. Ali Eshmeli —

Në esencën e të gjitha çlirimeve që kemi bërë përgjatë historisë ka një mesazh: Përgëzimi i Pejgamberit (a.s.). Të mos harrojmë se çdo përgëzim ka edhe një kusht: Personaliteti i Pejgamberit (a.s.). E fshehta e atij personaliteti është feja e qartë, Islami. Ndërsa e gjithë shfaqja e Islamit është çlirimi i zemrave. Ja, zemrat që u përsosën duke e kuptuar këtë të fshehtë dhe që iu drejtuan çlirimeve të mëdha me këtë pjekuri sublime, u bënë çliruese në kuptimin e vërtetë, sepse ato e morën mesazhin e çlirimit nga i Dërguari i Allahut (a.s.). Atë e bënë qëllim dhe dashuri. Këtij qëllimi dhe kësaj dashurie nuk i shtuan asnjë pikë tjetër të ndryshme dhe flijuan jetët e çdo gjë të tyre për t'i realizuar ata me pastërti shpirtërore, sepse ata e perceptuan se çlirimi i zemrave është specifika më e rëndësishme në mesazhin e çlirimit. Për këtë arsye, qëllimi i atyre asnjëherë nuk ka qenë një luftë e thatë. Ata nuk kanë hyrë në betejë të përgjakshme. Gjithashtu nuk u bënë kurbane të dëshirës së zjarrtë për të mos lënë gurë mbi gurë dhe kokë mbi supë.

Ata gjithmonë e kuptuan saktë mesazhin e çliri-

mit. Në sajë të kësaj, shkruan legjenda të mëdha me perceptimin se çlirimi nuk është vrasje por gjallërim. Shtetet dhe kontinentet që i panë ata, nxituan për t'u futur në Islam. Kështu është bërë myslimane Afrika, kështu është bërë myslimane Andaluzia, kështu është bërë mysliman Turkistani, kështu është bërë mysliman Anadulli, kështu është bërë mysliman Ballkani dhe kështu është bërë Stamboll / qyteti i Islamit Kostandinopoja. Kështu kanë arritur të zgjerohen kufijtë e gjeografisë sonë deri në njëzet e katër milion kilometra. Ndërsa kufijtë tanë shpirtërorë kështu e morën në vete të gjithë botën, sepse qëllimi gjithmonë ishte zemra, gjithmonë ishte në zemër dhe gjithmonë ishte prej zemrës. Sepse kjo ishte edhe e fshehta e çlirimit në përgëzimin e të Dërguarit të Allahut (a.s.) edhe e vërteta. Për këtë arsye, shumë herë në historinë e Islamit, faqet e vetme që duhet të shihen për ta parë dhe kuptuar qartë esencën e të gjitha çlirimeve, në të cilat është arritur edhe e pamundura, janë fletë të arta e të pashoqe të mbushura plot me çlirimet shpirtërore të

të Dërguarit të Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, që nuk mund të fshihen nga historia, sepse edhe luftërat e atij (a.s.), në të vërtetë ishin të stolisura nga fillimi e gjer në fund me çlirim të zemrave.

Kur të shtjellohen me kujdes kujtimet e shenjta të atij (a.s.), në çdo luftë, do të shihet qartë se edhe fitorja në Bedër ishte çlirim i zemrave. Edhe përvoja në Uhud ishte çlirim i zemrave. Edhe sukcesi në Hendek ishte çlirim i zemrave. Edhe legjenda në Hajber ishte çlirim i zemrave. Edhe durimi dhe vendosmëria madhështore në Tebuk ishte çlirim i zemrave. Ndërsa marrja e Mekës realizoi një çlirim plotësisht tjetër të zemrave. Për sa i përket Medines, ajo në të vërtetë, krejtësisht ishte çlirim i zemrave. Sahabi i ri, Mus'abi (r.a.), i cili shkoi në Medine me urdhrin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), për t'ua predikuar dhe mësuar Islamit banorëve të saj, arriti begati të mëdha dhe u bë shkak për përhapjen e Islamit. Një ditë shkoi në bahçen e Beni Zaferëve bashkë me Es'ad ibn Zuraren, në shtëpinë e të cilit rrinte. Ndërkohë që ata po bisedonin në krye të pusit, Sa'd ibn Muadh, i cili ishte prej Beni Abdulshhelëve, i tha Usejd ibn Hudajrit: "O Usejd! Ti je një njeri që nuk ke nevojë për ndihmën e të tjerëve. Edhe punën tënde di ta bësh mjaft mirë. Andaj, shko te ata burra që kanë ardhur në lagjen tonë për t'u ndryshuar besimin të dobëtëve tanë dhe largoji nga aty! Këtë mund ta bëja edhe vetë, por siç e di, Es'adi është i afërmi im."

Usejdi u nxit nga fjalët që dëgjo. Andaj, menjëherë e mori heshtën, u hodh në këmbë, shkoi te ata dhe u foli më shumë zemërim dhe kërcënim: "Çfarë pune keni ju këtu? O Es'ad! A na e ke sjellë këtë të huaj që të prishë besimin e të dobëtëve ndërmjet nesh? Bëj kujdes dhe asnjëherë mos tento ta bësh edhe një herë diçka të tillë! Nëse nuk doni të vdisni, largohuni menjëherë nga ky vend!" Mus'abi (r.a.), i cili ishte i urtë dhe i zgjuar, iu përgjig me qetësi: "A nuk dëshiron të ulesh dhe të dëgjosh ato që do të të

them? Me sa shoh, keni një personalitet me mendje të shëndoshë. Dëgjo! Nëse nuk i pëlqen ato që do të të them, mos i prano! Ti mund t'i pranosh ato vetëm nëse i pëlqen!" Usejdi u qetësua dhe i tha: "Kjo që më the është një qasje e logjikshme dhe e drejtë." Pastaj e nguli në tokë heshtën që kishte në dorë, u ul dhe filloi ta dëgjonte. Mus'abi, radijallahu anh, ia shpjegoi Islamit duke i lexuar Kuran. Usejdi u zbut prej atyre që dëgjo. Kurani Fisnik filloi t'i hynte në zemër. Drita e udhëzimit i reflektoi edhe në shpirt, edhe në fytyrë. Andaj tha me një entuziazëm dhe admirim të madh: "Sa fjalë e bukur dhe sublime që qenka kjo! Çfarë duhet të bëj për të hyrë në

Islam?" Pastaj mori gusul ashtu siç e mësoi Mus'abi dhe Es'adi. Po ashtu veshi edhe rroba të pastra. Pastaj tha plot sinqeritet edhe shehadetin. Pastaj filloi namazin dhe fali dy rekatë. Pastaj tha:

"Atje pas gjendet një njeri që nëse lidhet me ju, asnjë prej fisit të tij nuk do të kundërshtojë. Ai është Sa'd ibn Muadh. Menjëherë po shkoj te ai dhe po e dërgoj te ju." Edhe Sa'd ibn Muadh ishte mjaft i zemëruar kur shkoi atje. Por pasi e dëgjo në të njëjtën mënyrë Mus'abin, edhe ai besoi duke e pranuar Islamit me gjithë zemër. Menjëherë pasi e pranoi Islamit, e mblodhi fisin e tij dhe i pyeti të gjithë pjesëtarët e fisit: "Si më njihni mua, o Beni Abdulshhelë?"

Të gjithë iu përgjigjën: "Ti je i nderuari ynë. Edhe nga aspekti i mendimit je prijësi ynë dhe më i zgjuari prej nesh." Atëherë Sa'di u bëri këtë deklaratë: "Unë nuk do të flas as me gratë dhe as me burrat tuaj derisa ju t'i besoni Allahut dhe të Dërguarit të Tij duke thënë shehadetin." Në këtë mënyrë, deri në mbrëmje të gjithë pjesëtarët e këtij fisi hynë në Islam atë ditë. (Ibn Hisham, II, 43-46; Ibn Sa'd, III, 604-605; Ibn Esir, Usdu'l-Gabe, I, 112-113.)

Për shkak të këtyre çlirimeve shpirtërore, i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha: "Medina është çliruar me Kuran." (Bezzar, Musned, nr: 1180; Rudani, nr: 3774.)

*Shumë herë
në historinë e Islamit,
faqet e vetme që duhet
të shihen për ta parë dhe
kuptuar qartë esencën e
të gjitha çlirimeve, në të
cilat është arritur edhe e
pamundura, janë fletë të arta
e të pashoqe të mbushura
plot me çlirimet shpirtërore
të të Dërguarit
të Allahut.*

Ja edhe një shembull tjetër i çlirimeve shpirtërore të veçanta po nga epoka e lumturisë: Umejri ibn Vehbi... Umejri ibn Vehbi ishte i njohur me torturat dhe vuajtjet që ua shkaktoi të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe sahabëve të tij në periudhën e Mekës. Ai ishte një politeist djallëzor prej të parëve të kurejshëve. Biri i tij Vehbi pati rënë rob në luftën e Bedrit. Kur një herë po bisedonin për ato që kishin ndodhur në Bedr, miku i tij, Safuan ibn Umejje i tha Umejrit: “Betohem se është e kotë të jetojmë pas kësaj gjendjeje!” Umejri u acarua dhe tha: “Betohem se kjo që the është e drejtë. Po të mos kisha borxhet dhe familjen për të cilën kam frikë se vdesin nga uria pas meje, patjetër do të ngrihesha menjëherë dhe do të shkoja për ta varur Muhamedin. Mbi të gjitha, kam edhe një pretekst që ata e vlerësojnë. Atyre mund t’u them se kam ardhur për birin tim që e kanë zënë rob. Përveç të tjerash, kam dëgjuar se biri im mund të dalë jashtë.” Safuanit i qeshi fytyra prej këtyre fjalëve të Umejrit. Andaj i tha: “Mos u shqetëso! Borxhi yt tashmë është borxhi im. Do ta paguaj të gjithin. Edhe jetesa e familjes tënde më përket mua.”

Pasi Umejri e mori këtë besë, e mprehu shpatën e tij dhe e leu me helm. Mori ushqimin që ia përgatiti Safuani, i hipi kafshës së tij dhe shkoi drejt e te Xhamia e Pejgamberit. E mori shpatën dhe e lidhi devenë. Sapo Umeri e pa atë, mendoi: “Ky është armiku i Allahut, Umejri! Ardhja e atij këtu për Zotin është vetëm për ndonjë të keqe. A nuk ishte ai që na ngatërronte me kurejshit? A nuk ishte ai që e llogariti numrin tonë ditën e Bedrit dhe u tregoi kurejshëve politeistët?” Pastaj menjëherë shkoi te i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe e njoftoi duke i thënë: “O i Dërguari i Allahut! Armiku i Allahut, Umejri është këtu. Mbi të gjitha, ka edhe shpatën të varur për qafe.” I Dërguari i Allahut (a.s.), i tha: “*Sille pranë meje!*” Umeri (r.a.), e kapi atë për këllëfi të shpatës dhe e solli. Edhe ensarëve që gjendeshin aty u tha që të bënin kujdes duke u shprehur: “Rrini pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe mbrojeni atë nga ky njeri i keq! Padyshim se këtij pisi nuk i besohet!” Por i Dërguari i Allahut (a.s.), ishte i qetë dhe i tha: “*O Umejri! Mos e pengo atë! O Umejri! Eja pranë meje!*” Pastaj e pyeti Umejrin për shkakun e ardhjes së tij. Umejri i dha përgjigjen që kishte planifikuar: “Biri im është rob te ju. Unë kam ardhur për atë. Shpresoj që të shfaqni mirësi ndaj tij.” I Dërguari i Allahut (a.s.), e pyeti përsëri: “*Nëse është ashtu, përse e ke këtë shpatë në qafë?*” Umejri përsëri iu përgjigj siç e pati planifikuar: “Allahu i mallkoftë shpatat! Çfarë

dobie kemi pasur prej tyre?!” I Dërguari i Allahut (a.s.), e pyeti përsëri: “*Më thuaj të vërtetën! Cili është shkakun që ke ardhur këtu?*” Umejri këmbënguli në pretekstin e tij: “Nuk kam ndonjë shkak tjetër. Biri im është rob te ju. Unë kam ardhur vetëm për atë.” Këtë herë i Dërguari i Allahut (a.s.), e pyeti kështu: “*Atëherë më thuaj! Çfarë kushti i ke vënë Safuanit në Hixhr?*” Umejri u zu në befasi dhe tha: “Çfarë kushti i paskam vënë unë atij?” Së fundi i Dërguari i Allahut (a.s.), ia tregoi të gjitha fjalët një për një që ata të dy i patën bërë bashkë dhe i tha: “*Allahu i Lartësuar ndërhyri ndërmjet teje dhe asaj që deshe të bëje dhe të ndaloj.*”

Zemra e Umejrit u mbush plot me dritën e besimit kundrejt kësaj shfaqjeje. Umejri tha: “Unë dëshmoj se me të vërtetë je i Dërguari i Allahut! O i Dërguari i Allahut! Ne gjithmonë e kemi mohuar se ty të zbret shpallje dhe të vijnë lajme nga qielli, por ja që ato paskan qenë të vërteta, sepse këtë çështje nuk e ka ditur askush përveç meje dhe Safuanit. Betohem se vetëm Allahu të ka njoftuar për këtë çështje. Falënderimi i përket Allahut që më solli këtu dhe më nderoi me Islamin në audiencën tënde.” Nisur nga ky rezultat i mrekullueshëm, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha: “*Mësojani mirë Islamin vëllait tuaj të ri! Këtë bëjeni duke i lexuar Kuran! Ndërkohë, lirojani edhe birin e tij që gjendet rob tek ne!*” Ky urdhër i të Dërguarit të Allahut (a.s.), u zbatua menjëherë dhe me përpikëri. Pastaj Umejri (r.a.), kërkoi leje duke u shprehur: “O i Dërguari i Allahut! Deri më tani u kam bërë shumë tortura të rënda besimtarëve dhe jam përpjekur për ta shuar dritën hyjnore. Tani më jep leje që të shkoj në Mekë dhe këtë herë të derdh djersë për t’i ftuar politeistët e atjeshëm te Allahu dhe i Dërguari i Tij, domethënë në Islam. Ndosh-ta Allahu i udhëzon edhe ata.” I Dërguari i Allahut (a.s.), i dha leje kësaj dashurie që sapo gjelbëronte në rrugën e Allahut Teala.

Ndërkohë Safuan ibn Umejje, i cili nuk dinte asgjë nga ato që kishin ndodhur, u jepte përgëzime politeistëve të Mekës duke u thënë: “Edhe pak ka ngelur, edhe disa ditë. Ka për të ardhur një lajm që do të gëzoheni të gjithë. Ai do të jetë një lajm aq i madh, sa që do t’ju bëjë ta harroni dhimbjen e Bedrit!” Ai pyeste çdo karvan që shikonte. Më së fundi, nga një kalorës erdhi lajmi se Umejri ishte bërë mysliman. Ndërkohë edhe Umejri u kthye në Mekë dhe filloi të predikonte Islamin. Ata që deshën ta ndalonin, nuk ia dolën dot mbanë. Në sajë të përpjekjeve të tij largpamëse dhe guximtare, shumë zemra u udhëzuan.

Një ditë kur ishte në Qabe, u takua me Safuanin. Atij i thirri menjëherë: “O Safuan! Ti je prej të parëve tanë. A nuk e shikon se këto gjëra që i adhurojmë dhe për të cilat therim kurbane nuk janë tjetër veçse gurë të thatë?! A bën një fe e tillë? Dëshmoj me plot bindje se nuk ka zot tjetër përveç Allahut! Gjithashtu, dëshmoj me plot bindje se Muhamedi është robi dhe i dërguari i tij!” Safuani heshti. Nuk tha dot asnjë fjalë. (Ibn Hisham, II, 306-309; Vakidi, I, 125-128; Ibn Sa’d, IV, 199-201.)

Ja, kështu u ngjall te i Dërguari i Allahut (a.s.), Umejri (r.a.), i cili shkoi për ta vrarë atë, sepse Pejgamberi (a.s.), i çliroi zemrën. Edhe Umeri (r.a.), u ngjall kur pati shkuar për ta vrarë të Dërguarin e Allahut (a.s.). Edhe mekasi i quajtur Fedale ishte njëri prej atyre që shkoi për ta vrarë të Dërguarin e Allahut (a.s.), por që u ngjall te ai...

Përgjatë çlirimit të Mekës Fedale iu afrua shumë të Dërguarit të Allahut (a.s.), me qëllimin për ta vrarë. I Dërguari i Allahut (a.s.), e dinte nijetin e keq të tij, por nuk shfaqti asnjë shqetësim apo zemërim. Vetëm hapi fletët e dhembshurisë e mëshirës dhe e pyeti: “Ti je Fedale, apo jo?” Fedale iu përgjigj: “Po.” I Dërguari i Allahut (a.s.), i tha: “O Fedale! Pendohu dhe kërkoji falje Zotit për ligësinë që ke planifikuar brenda teje!” Pastaj i Dërguari i Allahut (a.s.), ia lehtëtoi kraharorin Fedales me duart e tij të bekuara. Menjëherë Fedales i iku nga mendja ai mendimi i keq që kishte më parë, zemra iu ngroh dhe shpirti iu mbush me dritën e udhëzimit. Në këtë mënyrë, Pejgamberi u bë njeriu më i dashur për të. (Ibn Hisham, IV, 37; Ibn Kethir, es-Sire, III, 583.)

Ja çlirimi shpirtëror! Ja Islami! Ja udhëzimi!

Përsëri ishte dita e çlirimit të Mekës. Politeistët mekas që i patën bërë të Dërguarit të Allahut (a.s.), çdo lloj torture e padrejtësie dhe që i patën shkakuar atij shumë vuajtje e probleme, atë ditë çlirimi gjendeshin përpara tij të turpëruar. Të gjithë i kishin kokat të ulura, sepse meritonin ndëshkimet më të rënda. Ndërsa disa prej tyre meritonin vetëm dënimin me vdekje. Ata që e patën përzënë të Dërguarin e Allahut (a.s.), nga ky qytet, tashmë kishin ardhur për të kërkuar mëshirë nga ai po në këtë qytet. Të gjithë ishin të turpëruar përpara jetimit që dikur e patën nënçmuar dhe torturuar. Tashmë po kërkonin dhembshuri nga jetimi që dikur nuk patën mëshirë për të. Tashmë po kërkonin mirësi dhe falje nga i varfri i mjerë që dikur e patën lënë të uritur pa i vrarë aspak ndërgjegjja. Fati i të gjithëve ishte i li-

dhur me vendimin që do të jepte ai. Andaj po prisnin me zemra të shqetësuara, me sy të brengosur dhe me fjalë shprese. Vallë çfarë do të bëhej me ta? Të gjithë po heshtnin. Madje, mezi po merrnin frymë. I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, filloi të fliste:

“O Mekas! Edhe unë po ju them siç iu tha Jusufi (a.s.), vëllezërve të tij: “...**Sot s’ka qortim për ju; Allahu ju faltë. Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve!**” (Jusuf, 92) Hajt shkoni të sigurt! Tashmë të gjithë jeni të lirë... Sot është dita që Allahu i Lartësuar i ka forcuar kureshët dhe i ka lartësuar me Islam...” Ja çlirimi shpirtëror! Ja Islami! Ja udhëzimi! Atë ditë zemrat vrapuan në besim dhe Islam grupe-grupe, karvanë-karvanë prej këtij çlirimi shpirtëror. (Shik. Ibn Hisham, IV, 32; Vakidi, II, 835; Ibn Sa’d, II, 142-143.) Ja, ky është çlirimi shpirtëror!

Përsëri ishte dita e çlirimit të Mekës. Ebu Sufjani ishte ulur në Qabe dhe ishte zhytur në mendime të thella. Hodhi një vështrim. Përpara ishte i Dërguari i Allahut (a.s.). Ndërsa myslimanët ecnin pas tij. Nga brenda e nxiste diçka: “Vallë, a të formoj përsëri ndonjë ushtri tjetër kundër Muhamedit? A thua të luftoj përsëri me atë?” Pikërisht në ato momente i Dërguari i Allahut (a.s.), shkoi drejt tij, iu afrua, e preku me dorën e tij të bekuar ndërmjet dy shpatullave dhe i tha: “Atëherë edhe Allahu do të të bëjë ty një të mjerë të poshtëruar.” Ebu Sufjani u tremb dhe e ngriti kokën. Kur e pa të Dërguarin e Allahut (a.s.), pohoi: “Deri më tani nuk isha i bindur plotësisht se je pejgamber. Ndërsa tani pendohem sinqerisht te Allahu për mendimet e këqija që kam pasur në mendje. Atij i kërkoj falje dhe mëshirë.” (Ibn Kethir, el-Bidaje, IV, 296.)

Ja Islami! Ja çlirimi shpirtëror! Ja çlirimi i një zemre të fituar duke duruar ndaj të gjitha armiqtëve dhe sulmeve për një kohë të gjatë njëzet e një vjeçare. Padyshim se madhështia e këtij çlirimi buronte nga një pjekuri shpirtërore që mund ta realizojë atë. Kjo është një pjekuri shpirtërore që nuk e humb veten dhe durimin as në kohëra të vështira dhe as në betejat më të përgjakshme. Gjithashtu, kjo pjekuri shpirtërore gjithmonë bëhet shkak për udhëzimin e njerëzve. Kjo është një pjekuri shpirtërore që i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ua ka mësuar shokëve të tij. Shembujt janë të shumtë:

Në çlirimin e Hajberit i Dërguari i Allahut (a.s.), ia dha flamurin Aliut (r.a.) dhe i tha: “*Ec Ali, përparo! Mos shiko djathtas e majtas derisa Allahu të të japë*

fitoren!” Aliu (r.a.), u hodh përpara, por një moment ndaloi dhe e pyeti Pejgamberin pa e kthyer kokën pas: “O i Dërguari i Allahut! Për çfarë të jetë lufta ime kundër atyre?” I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha: “Lufto me ata derisa të thonë: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut! Muhamedi është i Dërguari i Allahut!” Kur ta thonë shehadetin, përderisa nuk i shkelin ndalesat e fesë, i kanë të mbrojtura jetën dhe pasurinë e tyre nga ti. Atëherë i takon Allahut që ta bëjë llogarinë e tyre. (Në këtë çështje) mos nxito! Shko te ata plotësisht i qetë! Së pari ftoji në Islam! Nëse me këtë ftesën tënde një njeri bëhet mysliman, kjo është më e mirë për ty se sa të të jepen deve të kuqe!..” (Buhari, As’habu’n-Nebi, 9; Muslim, Fedailu’s-Sahabe, 32-34; Hejsemi, VI, 151.)

Ja çlirimi shpirtëror! Ja udhëzimi i Islamit!

Ja kështu çliruan ata! Ata fituan zemra pa e përzier kurrë nefsin në këtë çështje, sado që të ishte i shtrenjtë çmimi që paguan. Ata asnjëherë nuk harruan se zemra është zemër vetëm nëse nuk përzihet nefsi. Sahabët e nderuar u edukuan me mësimin e përvojën e kësaj dhe arritën pikat më kulmore. Kur Aliu (r.a.), po e vriste kundërshtarin e tij në një betejë të përgjakshme, menjëherë hoqi dorë nga vrasja e tij kur e pështyu në fytyrë. Këtë e bëri në sajë të urtësisë që kishte marrë nga i Dërguari i Allahut (a.s.). Ndërsa tani, lëri mënjanë armiqtë, por ka disa prej myslimanëve injorantë që i bëhen përbindësh vëllait të tyre me pretekstin dhe zemërimin se ka bërë një vepër që nuk u pëlqen atyre. Për shkak të këtyre po shkatërrohen shumë gjëra në botë dhe veçanërisht në gjeografinë islame. Shumë prej vendeve myslimane po shkatërrohen në duart e armiqve që kanë hyrë nëpërmjet zbrazëtirave që kanë formuar disa prej organizatave viktimë nga aspekti shpirtëror. Le ta shtjellojmë edhe një herë Aliun (r.a.) dhe ngjarjen e famshme duke e hapur pak edhe më shumë:

Aliu (r.a.), e pati shtrirë për tokë kundërshtarin e tij politeist. Pikërisht në momentin kur do t’i ngulte shpatën, armiku e pështyu atë në fytyrë. Sa ofendim i rëndë ishte ajo pështymë për një fytyrë kaq të pastër! Veçanërisht në një betejë për jetë a vdekje. Kjo pështymë ishte si një shigjetë me helm që e plaste damarin e zemërimin dhe të urrejtjes pështymë ishte një shuplakë aq shumë e pistë, sa që mund ta çmendte edhe durimin. Por çudi! Aliu (r.a.), papritur e hodhi shpatën në tokë dhe nuk ia nguli armikut. Çudi! Një sjellje kaq e keqe që ia nxit edhe më shumë zemërimin të gjithëve, atij ia shoi. Çudi! Çfarë ndodhi vallë që poseduesi i Dhulfikarit, i cili ishte rrufe në



çdo luftë, këtë herë papritur u shndërrua në një re mëshire? Çudi! Një sjellje përçmuese që i ngushton kraharorët, ia zgjeroi kraharorin Aliut (r.a.). Në këtë mënyrë, ai hoqi dorë nga vrasja e armikut që e pati vënë nën këmbë. Edhe ai i mjeri, i cili u kthye përsëri në jetë pasi e pati humbur shpresën për të jetuar, u habit pa masë. Ai e pyeti Aliun (r.a.): “O Ali! Përse hoqe dorë pikërisht në momentin kur do të më vrisje? Mos ke për qëllim të ma marrësh jetën pa shpatë?”

Luani i Allahut, Aliu (r.a.), iu përgjigj: “O ti që u ktheve përsëri në jetë! Dije se këtë Dhulfikar që e kam në dorë, e përdor vetëm me urdhrin e Allahut Teala. Ndërsa me urdhrin e idhullit që quhet nefsi nuk mund të lëviz as edhe një qime. Duarte e mia e shkulën dhe e copëtuan derën madhështore në kalanë e Hajberit vetëm me urdhrin e Allahut. Ndërsa me urdhrin e idhullit nefsi, nuk mund të këpus qoftë edhe një gjethe. Fryma ime i copëton gurët dhe malet e larta duke gjëmuar vetëm me urdhrin e Allahut të Madhëruar. Ndërsa me urdhrin e idhullit nefsi nuk mund të nxjerrë zë as sa fletët e mizës.”

Domethënë, o njeri! Ty të pata shtrirë për tokë vetëm për Allahun dhe do të të vrisja vetëm për Allahun. Por ti më pështyve në fytyrë. Nefsin tim e vure ballë për ballë me nefsin tënd. Atëherë puna ndryshoi. Tashmë lufta u shndërrua në luftë për fitoren e nefsit. Ndërsa unë menjëherë ia ngula shejtanit heshtën “eudhu” dhe shpatën që do të të godisja ty, ia ngula idhullit nefsi. Siç kam bërë gjithmonë, edhe këtë herë veprova sipas urdhrin të Allahut Teala. Kështu që u përpoqa të merrja vetëm pëlqimin e Tij. Domethënë u përpoqa të bëhesha prej atyre fatlumëve që gjithmonë çlirojnë zemra me një pjekuri të cilën Allahu i Lartësuar e lavdëron kështu në Kuran: **“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit.”** (Al Imran, 133-134) Për këtë arsye, ti e pe ligësinë të përshtatshme për

Ti më hodhe ferra, ndërsa unë të dhashë trëndafila. Ti zgjodhe për mua zemërimin dhe ofendimin. Ndërsa unë preferova për ty faljen dhe mëshirën.

mua, ndërsa unë pashë mirësinë të përshtatshme për ty. Ti më hodhe ferra, ndërsa unë të dhashë trëndafila. Ti zgjodhe për mua zemërimin dhe ofendimin. Ndërsa unë preferova për ty faljen dhe mëshirën.

Ti tentove të më përçmosh për të më zhytur në humbje, ndërsa unë u solla me një moral të lartë kundrejt teje. Ti dëshirove të më rrokullisje në zjarr, ndërsa unë dëshirova të të tërhiqja drejt xhenetit të Allahut Teala. Ti dëshirove të më njollosje për të më dhunuar, ndërsa unë e shtova dashurinë time ndaj mëshirës së pafundme për të të pastruar ty. Tani, o zemër e plagosur! Çfarë mendon nëse të them që të vish bashkë me mua te ajo dashuri, udhëzim dhe mëshirë? Zemra e burrit armik shpërtheu si lumenjtë prej këtyre fjalëve si perla që i dëgjoi nga morali i pashoq që e përjetoi dhe rrodhi drejt derës së dritës së udhëzimit. Dera e shenjtë u hap. Edhe ai hyri brenda pa u vonuar aspak. Ai nuk dinte çfarë të thoshte:

“O Ali! Nefsi im të paska njohur shumë gabim nga që të krahasoi ty me njerëzit e këqij. Diellin tënd nuk arrita ta shikoja për shkak të verbërisë sime. Ti më tregove diçka aq sublime, saqë m’u hapën edhe sytë, edhe zemra. Tashmë e shoh edhe diellin, edhe hënën. Ti u bërë dera e shpëtimit për mua. Në derën tënde hyra me dashuri. Sapo hyra, menjëherë arrita te qyteti fisnik i dijes së vërtetë dhe të pafundme. Pastaj e kuptova se qyteti i asaj dijeje të pashoqe është Muhamed Mustafai (a.s.). Tashmë edhe unë, pikërisht si ti, jam një i dashuruar që e kam lidhur zemrën me atë. Tashmë e kuptova se sulltani i pejgamberëve është një dritë e atillë, saqë yjet e pashoqe e të pafundme në qiell shkëlqejnë prej saj. Këtej e tutje, pjesa e jetës që më ka mbetur le të jetë kurban për atë! Ja çlirimi i zemrave! Ja Islami! Ja udhëzimi!

Për ta arritur një çlirim të tillë shpirtëror, është e qartë se duhet të jemi besimtarë të devotshëm, sepse zemrat nuk çlirohen me asnjë urrejtje, zemërim apo padrejtësi. Nisur nga ky këndvështrim, çdo zemër nuk e ka aftësinë për t’i çliruar zemrat, sepse kjo aftësi është mirësi jo e një jete të devijuar, por e një jete mjaft të pastër. Domethënë, një zemër nuk arrin dot

ta realizojë çlirimin shpirtëror në kuptim të vërtetë pa u bërë një pasqyrë e pastër muhamedane në të cilën shikon Zoti (xh.xh.). Ndoshta mund të mbledhë njerëz si ndonjë skuadër apo mund të formojë klientë si ndonjë qendër tregtare, por në kuptimin e vërtetë nuk mund të fitojë zemra, sepse të çlirosh zemra do të thotë që t’i bësh edhe ato pasqyra muhamedane dhe t’i çosh në një pjekuri të atillë, saqë mund t’ia shfaqësh Zotit (xh.xh.). Do të thotë që zemrat me gjemba t’i shndërrosh në trëndafila dhe zemra të xhenetit. Do të thotë që të këqijtë t’i bësh të mirë. Do të thotë që ligësinë ta shndërrosh në mirësi. Do të thotë që ta bësh qafirin besimtar, ta bësh hipokritin të sinqertë dhe ta bësh vrasësin gjallërues. Nisur nga kjo, çlirimi i zemrave kurrë nuk është mbledhje simpatizantësh me një qasje joshëse mashtruese e të përkohshme që bëhet duke i mbyllur sytë kundrejt gabimeve fatale të njerëzve, duke i lënë ligësitë e tyre ashtu siç janë pa tentuar për t’i rregulluar dhe duke mos nxjerrë zë ndaj devijimeve të tyre që mund t’u shkaktojnë tragjedi. Edhe formimi i masave të gjera nga metoda për t’i shtirë në dorë zemrat e tyre me të njëjtën qasje të ligë, nuk është çlirim shpirtëror. Kjo nuk është gjë tjetër përveçse pushtim i njerëzimit me aftësi djallëzore dhe një lloj tjetër i padrejtësisë.

Andaj, asnjëherë nuk duhet të harrojmë se një i pavendosur që nuk e mposht dot shejtanin asnjëherë nuk mund të fitojë ndonjë zemër. Një i shkujdesur që nuk mund ta mposhtë nefsin e tij asnjëherë nuk mund të çlirojë asnjë zemër. Një mjek apo një i sëmurë që nuk mund ta mposhtë mikrobin, asnjëherë nuk mund ta arrijë fitoren që quhet shërim. Për këtë arsye, çliruesit e vërtetë shpirtërorë para së gjithash e zbatuan Islamit vetë dhe ua mundësuan edhe të tjerëve zbatimin e tij. Ata u lidhën me gjithë shpirt ndaj Allahut Teala dhe të Dërguarit të Allahut (a.s.). Nisur nga kjo, i falën zemrat e tyre dhe çliruan zemrat e të tjerëve. Ja, ky ishte një çlirim i vërtetë. Ja, nga kjo e vërtetë lindën çlirime të mëdha e të qarta. Lindi Stambolli. Përgëzimet u shfaqën njëra pas tjetrës. Për këtë arsye, ata që kërkojnë përgëzim nga i Dërguari i Allahut (a.s.), në këtë botë dhe në botën tjetër, së pari duhet të dinë mirë se si t’ia japin zemrën atij. Edhe Islamit duhet ta zbatojnë në formën më të mirë duke çliruar zemra përgjatë gjithë jetës. Lum për ata që arrijnë ta realizojnë këtë! Të bekuara qofshin përgëzimet për çlirime të reja të tyre!..

BETEJAT E KOSOVËS

1389-1999

✦ Dr. Ardian Muhaj ✦

Beteja e pare e Kosovës (qershor 1389). Tashmë statuja gjigande e “car” Llazarit me dorën ngritur lart në drejtim të Fushë-Kosovës po shënon përvjetorin e parë të vendosjes në sheshin kryesor të Mitrovicës veriore. Edhe pse vendosja e kësaj statue u konsiderua si provokim i padenjë për shqiptarët e Kosovës, nuk duhet harruar kurrsesi se “car” Llazarit me kohë ia ka ngritë permendoren historiografia shqiptare. Serbët thjesht i ngritën shtatoren apo bustin. Ajo që gjoja e justifikon historiografinë shqiptare për ta amnistuar krejt politikën genocidale të ndjekur nga serbët ndaj shqiptarëve, që nga shek. VII e deri në shek. XV, duke përfshirë edhe politikën e njërit prej carëve më antishqiptar, Llazarit, është e ashtuquajtura Beteja e Kosovës. Këta historianë janë treguar akoma edhe më fanatikë në mbrojtjen dhe propagandimin e miteve historiografike serbe ndër shqiptarë, se sa besimtarët që përkujdesen për tyrben e Sulltan Muratit.

Meqë kjo betejë e mbyll kapitullin e shtetit genocidal mesjetar serb për disa shekuj, atëherë që fundi i tij të na paraqitet si një fund i lumtur, si fundi i një shteti të dashur e mirëdashës për mbarë popujt ballkanikë, shpiken terma fanta-historikë që arrijnë ta shtrembërojnë aq shumë realitetin, sa që për pak nuk krijojnë herë një komb të vetëm “ballkanas”, liridashës e të drejtë, herë një “aleancë” të popujve ballkanikë. Domosdo, duhej që akti final i politikës genocidale qindrvjeçare serbe të mbyllej për mesjetën me një heroizëm të pashoq në të cilin i pushtuari dhe i masakruari shqiptar ndritohet nga frymëzimi i aleancës së popujve ballkanikë. Historianët shqiptarë janë përpjekur me sa kanë mundur të arnojnë ndonjë të dhënë nga burime të dyshimta historike për të vërtetuar se gjoja në përlëshjen kaotike të dy ushtrive të papërcaktuara mirë, në anën e pushtuesit mijëvjeçar e genocidal serb luftonin me trimëri edhe rajatë shqiptare, që i kishin hedhur tutje dhjetë shekuj robërim e farëshfarosje. Kështu u madhërua dhe u naltësua pushtuesi dhjetëshekullor serb, përkundër kandidadit për pushtues, që akoma nuk i kish kaluar dhjetë ditë në trojet shqiptare.

Absurditeti arrin kulmin kur diskutohet se në se do kish fituar “cari” Llazar, do të kishte qenë në favor të shqiptarëve, apo jo? Në se do kish fituar “car” Llazari, me “aleatët ballkanas”, kjo do të ishte po aq në favor të shqiptarëve sa fitorja e masave sllave që u dyndën në trojet ilire në antikitetin e vonë dhe zhdukën nga faqja e dheut dhjetra qytete të lulëzuara, shkretuan fusha e male, dhe e kthyen Ilirinë në epokën e gurit. Fitorja e “car” Llazarit dhe e ushtarit të mirë Millosh, do të kishte qenë po aq në favor të shqiptarëve sa ç’që fitorja e pushtimi i car Dushanit. Për të pasur akoma edhe më të qartë se si fitorja serbe do i kishte ndihmuar shqiptarët e shtypur e të pushtuar nga vetë serbët, mjafton të hedhësh sytë nga bashkëkohësi serb i “car” Llazarit, pushtuesi i Janinës, Toma Preljuboviçi. Nofka e tij të cilën ai e mbante me krenari, aq larg nga atdheu i tij ishte “alvanitoktoni”, që do të thotë, vrasësi, masakruesi apo shfarosësi i shqiptarëve. Preljuboviçi që krenohej me epitelin “shfarosësi i shqiptarëve”, nuk ndryshonte aspak nga bashkëkohësi i tij “car” Llazari.

Beteja e Dytë e Kosovës u zhvillua në Fushë Kosovë në datat 17 tetor–20 tetor 1448 në mes të një ushtrie të Mbretërisë së Hungarisë të udhëhequr nga Janosh Hunyadi, kundër një koalicioni osman të udhëhequr nga Sulltan Murati II. Rezultati i betejës ishte fitore vendimtare e osmanëve. Synimi i Huniadit ishte të rifitoheshin territoret hungareze të humbura pas betejës së Varnës më 1444. Mirëpo, në këtë betejë, komandanti hungarez nuk gjeti mbështetjen e popullsisve ortodokse të jugut të Danubit, të cilat ekspansionin e hungarezëve katolikë e shihnin si kërcënim për lirinë e tyre fetare. Një vit më herët në 1447, provinca e Vllahisë që ishte nën sundimin hungarez, u ngrit në revoltë kundër këtij sundimi, pikërisht për shkak të persekutimit të rumunëve ortodoksë nga hungarezët. Mbasi e shtypën kryengritjen rumune, hungarezët shpresonin të arrinin një fitore të shpejtë mbi osmanët, të cilët shiheshin me simpati nga popullsia ortodokse të mbretërisë hungareze. Beteja e dytë e Kosovës u zhvillua në të njëjtën zonë të Fushë-Kosovës sikurse e para dhe pati pasojë po aq të rënda për forcat jashtëballkanike. Shumë komandantë hungarezë humbën jetën në këtë betejë, ndërkohë që Huniadi ia doli të arratiset, megjithëse më vonë u arrestua nga serbët dhe u la i lirë vetëm pas pagesës së një

shume të madhe dhe pasi riktheu një pjesë të territoreve të marra më parë.

Beteja e tretë e Kosovës (25-28 tetor 1689)

Kulmi i betejës së tretë të Kosovës është djegja e qytetit të Shkupit dhe masakra e banorëve të saj nga forcat austriake të udhëhequra nga gjenerali Italian Enea Silvio Piccolomini, me prejardhje nga një familje italiane që kishte nxjerrë dy papë. Djegja e qytetit nga forcat ushtarake austriake që filloi më 26 tetor 1689, vazhdoi për disa ditë, duke bërë shkrumb e hi pjesën më të madhe atij qytetit të lulëzuar dhe duke shkatërruar ndërtesat më të bukura dhe më madhështore të tij. Vetëm disa ndërtesa të ndërtuara me gurë, si kështjella dhe një pjesë e kishave dhe xhamive i mbijetuan shkatërrimit. Është interesant të theksohet se lagja hebreje u shkrumbua plotësisht, me sinagoga, banesa e shkolla. Përvec se një djegje masive kjo rezultoi në një masakër të vërtetë për popullsinë civile. Tetëdhjetë për qind e popullsisë civile pa tmerrin e djegjes për së gjalli. Nga 60 mijë banorë që kishte, 50 mijë, burra, gra, pleq e fëmijë u dogjën për së gjalli dhe qyteti e humbi rëndësinë dhe lulëzimin që kishte pasur. Popullsia civile u zu në befasi për shkak të avancimit të shpejtë të forcave austriake, të cilat marshuan pothuajse pandalur nëpër Kosovë, duke mbërritur në 25 tetor në Shkup, menjëherë sapo kishin marrë kështjellën e Kaçanikut. Popullsia paqësore e qytetit nuk bëri asnjë rezistencë dhe madje edhe garnizoni osman ishte tërhequr më herët. Megjithatë kjo nuk e ndaloi komandantin italian të forcave austro-serbe, të kryejë një nga masakrat më të rënda në historinë e Europës, të padëgjuar që nga koha e fushatës mongole të vitit 1242-1243. Në këtë masakër ai natyrisht kishte mbështetjen e trupave serbe që ishin bashkuar me forcat austriake në Kosovë. Kjo masakër dhe tragjedi e padëgjuar rëndohet edhe më shumë nga autorë ekstremistë deri në atë pikë, sa që e konsiderojnë këtë si një masakër të motivuar nga dëshira për ta mbrojtur popullsinë nga një epidemi që gjoja kishte rënë në qytet.

Shkupi ishte zhvilluar vullshëm deri në atë kohë si një nyje e rëndësishme lidhëse e rrugëve tregtare mes Ballkanit dhe Europës Qendrore. Që në vitin 1469 kishte një bezisten, apo treg të mbuluar me dyqane të shumta dhe një karavansaraj për akomodimin e tregtarëve nga vende të ndryshme si arabë, hebrej, grekë, raguzanë, venedikas, përvec atyre shqiptarë e bullgarë. Deri në këtë kohë ishte një qendër e rëndësishme, ku banorët me besime fetare dhe etni të ndryshme si shqiptarë, bullgarë, hebrej, raguzianë jetonin paqësisht e në harmoni. Mjaftuan tre ditë për ta zhdukur nga faqja e dheut lagjen e lulëzuar hebreje të Shkupit që u shkrumbua dhe u bë hi nga ekstremizmi fetar. Në mesin e shek. XIX francezi Ami Boue raportonte se Shkupi nuk kishte mbërritur të ketë as sa gjysma e banorëve të vitit 1689. Vetëm në shek. XX, popullsia e Shkupit arriti sërish në nivelin që kishte përpara masakrës. Pra, u deshën tre shekuj që popullsia e Shkupit të arrijë numrin që kishte në prag të shkatërrimit.


Beteja e katërt e Kosovës (1912-1913)

Në 1912-1913 sërish Kosova u shndrrua në pikësynimin kryesor të shovinizmit serb. Përpara se të mblidhej Konferenca e Ambasadorëve e Londrës dhe përpara se kjo konferencë të zyrtarizonte në tavolinë copëtimin e trojeve shqiptare dhe aneksimin e kreu Kosovës në kuadër të shtetit serb, tashmë Serbia e kishte pushtuar krejt Kosovën dhe pjesën më të madhe të Shqipërisë. Masakrat kishin muaj që vazhdonin pa ndërprerje dhe nuk duhet harruar kurrsei se copëtimi politik i trojeve shqiptare në Konferencën e Londrës, erdhi mbas pushtimit serb dhe masakrave të kryera prej tyre. Në këtë betejë për Kosovën, u vranë dhjetra mijra shqiptarë, dhe mijra të tjerë u detyruan të konvertohen me dhunë në ortodoksë.

Beteja e pestë e Kosovës (1998-1999)

Ngjarja më e rëndësishme në botë që e mbylli siparin e shek. XX-të ishte beteja e radhës për Kosovën. Mbi një milion shqiptarë u shpërngulën për t'i shpëtuar masakrimin nga forcat serbe, ndërkohë mijra të tjerë ishin vrarë e masakruar masivisht, qindra fshatra e mijra shtëpi u dogjën, dhjetra qytete u bombarduan. Kjo betejë e fundit e Kosovës, në fakt shembullon me një përmbledhje të të gjitha betejave të mëparshme, asaj të vitit 1389, asaj të vitit 1448, asaj të vitit 1689 dhe asaj të viteve 1912-1913.

Historia e dhimbshme e fqinjësisë sonë 1500 vjeçare nuk është asgjë më shumë se sa një akt i vetëm genocidal i shtrirë përgjatë gjithë këtyre shekujve, me intensitet më të ultë apo më të lartë në varësi të rrethanave, por asnjëherë jashtë kësaj përpjekjeje genocidale. Politikanët shqiptarë gabojnë rëndë që nuk e konsiderojnë genocid dhunën e hapur të serbëve në Kosovë në vitet 1998-1999. Ashtu edhe historianët shqiptarë gabojnë rëndë që nuk i shohin carët mesjetarë serbë si projektues e përcues të politikës genocidale ndaj shqiptarëve. Asgjë nuk ka ndryshuar në politikën serbe jo vetëm që nga koha e Millosheviçit, por madje as që nga koha e car Dushanit dhe e "car" Llazarit. Beteja e parë e Kosovës e vitit 1389 nuk është e ndryshme nga betejat e tjera për Kosovën mes serbëve e shqiptarëve dhe as nga beteja e fundit e vitit 1999.



Shënime për marrëdhënien e SISTEMIT KOMUNIST me ARKITEKTURËN

Edison Çeraj

Siç kemi pasur rastin ta trajtojmë edhe në ese të tjera, sipas çdo ideologjie dhe sistemi, njeriu nuk lind, por bëhet, dhe duhet të bëhet medoemos. Fundja pse të mos bëhet, përderisa qëllimi e justifikon mjetin, gjë që përbën thelbin e çdo sistemi, pra të çdo utopie. Pse të mos bëhet përderisa çdo gjë lejohet. Kur njeriu bën atë vrasjen tanimë të mirënjohur (e gjithaq të keqkuptuar) të Zotit, siç na kujton Nietzsche, ai e shpall veten zot, dhe kur e bën këtë – natyrisht pasi kalon disa mundime të mëdha, mbi të gjitha të brendshme – ai e ndjen veten të plotfuqishëm, të pamposhtur, ndaj të cilit duhet të nënshtrohet çdo gjë. Më pas, kur bashkë me këtë i hapet rruga edhe drejt pushtetit politiko-ekonomik (gjë që shënon një rrjedhje pothuajse të pashmangshme – vullneti për pushtet), zakonisht atë nuk mund ta kthejë mbrapsht askush dhe asgjë tjetër përveç vdekjes.

Tekste të ndryshme me natyrë religjioze apo tipike religjioze, si Upanishadet, Tora, Ungjilli, Kurani etj., vende-vende, kryesisht në mënyrë implicite, na thonë se brenda njeriut ka diçka nga Zoti. Edhe fakti që, të paktën me sa dimë ne, njeriu është e vetmja krijesë apo qenie që është e lirë në zgjedhje, si dhe e vetmja qenie që mendon, e shpreh dhe e vepron mendimin, përbën një dëshmi domethënëse në këtë drejtim.

Mungesa e vetëdijes së duhur për këtë, pra që kjo

është një karakteristikë e çdo njeriu, jo vetëm e njërit apo disave, bën që disa syresh ta shohin veten si të zgjedhur, si misionarë për të përmbushur ndonjë të ashtuquajtur projekt të cilit na u dashka t'i bindemi të gjithë.

Për ta thënë përmbledhtazi:

A nuk ndodhi një gjë e tillë me tipa si Lenini, Stalini, Maoja, Hitleri etj.? A nuk konsideroheshin ata zota? A nuk ishte misoni i tyre udhëheqja e njerëzimit nga errësira në dritë?

Natyrisht që kjo vazhdon akoma, por me të tjera forma. Ose vazhdon në atë mënyrë që e gjithë ajo që deri dje i atribuohet një individit të caktuar, tani i atribuohet sistemit.

Kështu, për çdo sistem, edhe për atë komunist, një ndër elementet më domethënëse që bënte pjesë në “paketën” e tij ishte edhe çështja e arkitekturës. Nga përvoja jonë në Shqipëri, e dimë fort mirë se çfarë u ndodhi shumë e shumë xhamive, kishave, teqeve, hamameve, pazareve (bixhisteneve) e shumë ndërtesave të tjera, të cilat, sipas ideologjisë së “re”, i takonin botës së “vjetër”¹, klasave të përmbysura, ose armikut.

1. Çdo ideologji pretendon se po largon “të vjetrën” e po sjell “të renë”.



Për të krijuar të ashtuquajturin “njeriu i ri”, domosdo që duhej edhe një terren i ri. Do të ishte e pamundur që “njeriu i ri” të mbruhej e të formohej i rrethuar nga pamje e shenja të vjetra, të cilat do t’i kujtonin se nga vinte e ku përkiste; të cilat do t’i kujtonin se po jepej pas një iluzioni; të cilat do t’i kujtonin individualitetin e do ta ruanin nga depersonalizimi që shkakton masa.

“Arkitektura ka veçorinë e saj karakteristike, që nuk e fut dot në sirtarin e një kategorie të veçantë. Arkitektura nuk është vetëm të ndërtosh diçka të domosdoshme, përndryshe do të quhej thjesht ndërtim. Arkitektura nuk është vetëm art, siç duan ta përkufizojnë disa. Arkitektura është edhe sociologji dhe, në llojin e vet është një fushë e cila pa kuptuar, në mënyrë subtile, ndikon fuqishëm në ndërtimin dhe bashkëjetesën e një shoqërie. Arkitektura ka gjuhën e saj. Arkitektura, me simbolikën e shfaqur ne gjuhën e saj, është një tregues kokëfortë i asaj se në çfarë rendi shoqëror jetojmë dhe i asaj se cilët jemi dhe çfarë dëshirojmë të bëhemi.” (Pedro, 2010)

Në këtë mënyrë, pas shkatërrimit e tjetërsimit të shumë ndërtesave, nisi puna (“kur hidheshin themelet”) për ndërtimin e një mjedisi të ri, pikërisht në kuadër të projektit “njeriu i ri”.

Ndërtesa të tipit Pallati i Kulturës, Muzeu Historik Kombëtar, disa qendra kulture e bibliotekat kuboide, parafabrikatet etj., nuk qenë gjë tjetër vetëm se fidanishtet ku do të rritej “njeriu i ri”, që me formën e tyre të alienuar, me ngjyrën gri që kishte efektin e

anestezisë, me ndarjet kabah që evokonin një mi në laborator e kështu me radhë përbënin parathënien e një rrugëtimi tëhuajësues që e priste njeriun, tashmë i dorëzuar.²

Pikërisht masiviteti mbytës që të rrethon dhunshëm i arkitekturës totalitariste, ka të ngjarë ta ketë shtyrë një arkitekt si Günter Behnisch të bëjë thirrje për “një arkitekturë e njeriut për njeriun, ku njeriu e dominon arkitekturën dhe jo arkitektura njeriun.”³

Ngaqë ndodhi një transformim me thikë, “revolucionar” edhe në arkitekturë, pikërisht në emër të njeriut të ri, pasoja që një shpërfaqje në rrafshin estetik nga i cili nuk e kemi marrë akoma veten. Jo rastësisht ministritë dhe bulevardi “Dëshmorët e Kombit” në kryeqytet, që i takojnë kohës së Mbretit Zog, mbeten akoma veprat më të mira arkitektonike/urbanistike që kemi, ku ana estetike dhe ajo funksionale është ekuilibruar në atë mënyrë që i bën edhe sot e kësaj dite “unike” në vendin tonë. Kjo sepse këto vepra u ndërtuan nën parimin “një arkitekturë e njeriut për njeriun”, dhe jo siç bëjnë komunistët: për një arkitekturë që e zhbën njeriun për të ndërtuar “njeriun e ri”, i cili rezultoi një monstër i llojit të vet, që po mban peng akoma zhvillimin normal të vendit.

Nëse arrijmë ta lexojmë me vëmendje arkitekturën dhe urbanistikën e një vendi, do mësojmë shumë edhe për njerëzit e atij vendi.

2. “Na robëroni, vetëm na ushqeni” është lutja e re e njeriut të ri që paralajmëron Dostojevski te *Vëllezërit Karamazov*.

3. Cituar nga Pedro, 2010.

Shpërthimet E DIELLIT

Kohët e fundit në media po dëgjojmë gjithnjë e më tepër lajme në lidhje me diellin. Shkak i kësaj janë shpërthimet e fuqishme dhe të shpeshta të Diellit. Dikush këto shpërthime i komenton si sinjal lajmërues për fatkeqësi të mëdha, dikush tjetër e hiperbolizon duke e lidhur me apokalipsin. Por përse dielli është aktivizuar pikërisht këto vitet e fundit? Për të kuptuar këtë fenomen, po ndjekim metodën e psikologëve që do të thotë të zbresim në fëmijërinë e diellit, madje deri në lindjen e tij para 4.6 miliard vitesh.

FORMIMI I DIELLIT

Para 13.7 miliard vitesh, pas Shpërthimit të madh universi ishte i zhytur në errësi. Kjo errësi vazhdoi deri sa gazrat u bashkuan për të krijuar yjet që janë kandilat e universit. Në këtë periudhë fillon edhe historia e diellit. Dielli dhe planetët u krijuan nga një nebulozë gazore, e cila ruante një trysni të caktuar. Nga rënia gravitacionale e nebulozës gjigande filloi të formohej Dielli dhe planetët e tij. Se çfarë e shkaktoi dhe e nxiti këtë rënie gravitacionale, shkencëtarët ende nuk kanë një përgjigje të prerë, por mendohet që ky proces të jetë shkaktuar nga një dallgë shoku e një supernove të largët ose të afërt. Si do qoftë, të gjitha këto janë mjete, sepse "Krijuesi i Diellit dhe Hënës është AI (Zoti)" Enbija, 33

Dielli, i cili është formuar nga grumbullimi masiv i mjegullnajave gazore, çdo ditë e më shumë po bëhet edhe më i nxehtë dhe për pasojë edhe më energjik.

Ndërsa temperatura në sipërfaqe është 6000 C, në bërthamë ajo arrin vlerën 15 milion C. Duke pasur parasysh këtë temperaturë është krejt normale që dielli arrin të na ngrohë në 150 milion km larg. Por si e siguron ai këtë temperaturë kaq të lartë?

Dielli e prodhon energjinë duke e konvertuar hidrogjenin në helium përmes zinxhirit të reaksioneve të fuzionit nuklear të bërthamës, e cila nga ana e vet është nën një trysni dhe nxehtësi të lartë. Duke qenë se këto reaksione kanë nevojë për mjedise jashtëzakonisht të nxehta, bërthama e Diellit shërben si një laborator i përkryer.

Procesi i shndërrimit të hidrogjenit në helium është burimi i energjisë kolosale që ka dielli. Nga kjo pikëpamje dielli është një burim i jashtëzakonshëm energjie. Energjia që përhap dielli për tri ditë është e barabartë me energjinë e prodhuar nga të gjitha burimet e energjisë në Tokë. Vetëm 1 e një milionta e energjisë kolosale që prodhon dielli arrin në tokë.

DIELLI HUMBET QETËSINË

Dielli, i cili prej mijëra vjetësh ngroh dhe ndriçon Tokën, kohët e fundit nuk është aspak i qetë. Në sipërfaqe të tij po ndodhin shpërthime të mëdha gazi dhe po krijohen njolla të zeza disa herë më të mëdha se Toka.

Në fakt këto shpërthime janë parashikuar nga shkencëtarët. Sipërfaqja e tokës vëzhgohet me teleskop qysh prej vitit 1609. Njollat e diellit në fillim u konsideruan si normale. Por në ditët tona pas një



sërë vëzhgimesh u vu re se aktiviteti i Diellit një herë në 11 vjet arrinte maksimumin. Pra shpërthimet në sipërfaqen e diellit janë krejt normale sipas shkencës.

Këto shpërthime nuk kanë asnjë ndikim mbi njeriun. Grimcat që përhapen në hapësirë si pasojë e këtyre shpërthimeve kur mbërrijnë në tokë përplasen në magnetosferë dhe thithen prej saj, në këtë mënyrë dëmi që mund të vije prej tyre ulet në minimum. Por

këto shpërthime mund të ndikojnë shumë mbi valët e radiove dhe sistemeve të tjera elektronike. Si përfundim, diellit i duhet të paktën 4.5 miliard vjet për t'u harxhuar plotësisht. Por nuk duhet të harrojmë se Kiameti do të ndodhë në mënyrë të papritur . Për të gjithë ata që janë kureshtarë për Kiametin, dëshiroj t'u kujtoj ajetin 47 të sures En'am Thuaj: ***“Më thoni, nëse ju vjen dënimi i Allahut papritmas ose sheshazi, a do të zhduej kush përveç popullit keqbërës?”***

A nuk ka një kurë PËR AUTIZMIN?

Nëse përpiqemi të klasifikojmë sëmundjet, sipas jush, cila prej tyre të çon drejt pashpresës? Ti gruposh në sëmundje vdekjeprurëse dhe jo vdekjeprurëse apo t'i klasifikosh në sëmundje me shpresë dhe pa shpresë? Sado të kemi frikë nga vdekja, kur mendohet në lidhje me sëmundjet vdekjeprurëse, nëse ato kanë një kurë, a mund të humbë shpresa? Për shembull, murtaja e zezë ka qenë një nga sëmundjet vdekjeprurëse më të famshme. Një sëmundje, e cila u bë shkak i zhdukjes së një të tretës së popullsisë së Evropës në mesjetë, por që në kohën tonë është zhdukur pothuajse krejtësisht, në sajë të vaksinave, antibiotikëve dhe kurave përkatëse. Mirëpo, nëse mendojmë përsëri për kohën e mesjetës, ajo pranohej si një nga llojet e sëmundjeve që nuk kishin shpresë shërimi.

Pikërisht në recetën që mund të marrë një i sëmurë mbase i pashpresë, menjëherë mbi paragrafin e fjalisë “s’ka shpresë dhe ilaç”, duhet shkruar me germa të mëdha ky hadith fisnik: *“Allahu nuk ka krijuar asnjë sëmundje pa shërim!”* (Ahmed bin Hanbel, 4278.) dhe *“Përveç pleqërisë, çdo sëmundje e ka një zgjidhje dhe një ilaç.”* (Buhari, 10/113.)

Ndërkohë që meditoja mbi këto hadithe, në një cep të mendjes kam ruajtur gjithmonë këtë pyetje: Po sëmundjet e trashëgueshme, pra ato gjenetike? Sepse kur shkruani një poezi, mund ta fshini një varg që nuk ju pëlqen, por nuk mund ta fshini kurrë e ta filloni nga e para një vepër shumë vëllimshme që është bërë shkak i lindjes së një kulture, një jetese dhe që ndodhet një qelizat e një shoqërie të tërë. Pra, në kuadër të përgëzimit që na ka dhënë Profeti ynë (a.s.), për sëmundjet, ne jemi të detyruar të jetojmë me sëmundjet tona gjenetike, derisa shkenca të zbulojë një kurë për to.

Pikërisht, një nga këto sëmundje, për të cilën kur shqiptojmë fjalën “shërim”, menjëherë na thuhet “ah, po kjo është një sëmundje gjenetike!”, është edhe sëmundja e autizmit. ADN-ja jonë, e cila është përafërsisht dy metra, ruhet në një kromozom që ka formën e kasetave të vjetra, në bërthamën e çdo qelize. Dhe, në

çdo qelizë tonën gjenden dyzet e gjashtë kasetat e tilla. Ndërsa autizmi shkaktohet nga anomalitë e kasetës së pesëmbëdhjetë në trilionat qeliza të të gjithë trupit të sëmurit. Pra, ka një cilësi plotësisht gjenetike.

Shpresa e kurimit të autizmit me anë të parazitëve!

“Autizmi është një problem gjenetik që fillon (të dallohet) para moshës trevjeçare dhe vazhdon gjatë gjithë jetës. Ai dëmton marrëdhëniet dhe komunikimin shoqëror. Ai bëhet shkak i sjelljeve të kufizuara dhe të përsëritura dhe pengon zhvillimin e trurit.” Mirëpo, në studimet që janë kryer kohët e fundit, ka filluar të bjerë një dritë shprese edhe për këtë sëmundje “të pashpresë”.

Sipas një studimi të botuar nga Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin Baylor të Teksasit në SHBA, një bakter me emrin “L. reuteri” që ndodhet në zorrë, mund të përmirësojë marrëdhëniet shoqërore të pacientëve të sëmurë me autizëm. Në eksperimentet që janë kryer mbi minjtë, është vënë re se minjtë që nuk i kanë këto bakterie në zorrët e tyre, kanë probleme në sjelljet shoqërore. Këta minj që përjetojnë probleme të ngjashme me ato që shkakton autizmi, i janë nënshtruar një ushqyerjeje të ekuilibruar në sajë të së cilës është bërë i mundur formimi i bakterit “L. reuteri”, në zorrët e tyre. Pas një farë kohe, është vëzhguar se tek këta minj është përmirësuar sjellja dhe madje është eliminuar papërshtatshmëria e tyre sociale.

Po ashtu, edhe kompania farmaceutike Coronado Biosciences është duke punuar me disa parazitë të quajtur TSO: *Trichuris suis ova*, CNDO-201, të cila ua kanë injektuar kafshëve, duke arritur të ekuilibrojnë sistemin mbrojtës dhe kanë pasur sukses në pakësimin e anomalive që shfaqen në trup të bashku me autizmin. Ky parazit i cili nuk shtohet kur i injektohet njeriut dhe nuk i sjell asnjë problem sistemit mbrojtës, përveç autizmit, shpresohet të kurojë edhe sëmundje të tjera si Multiple Skleroza dhe Chronin, të cila janë pothuajse të pashpresa.





“Ky (Kuran) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsiatur mbi vargjet e tij dhe për t’u këshilluar me të mendarët..”

(Sad, 29)

TË KUPTOSH KURANIN, NATYRËN DHE HISTORINË

Mendja e shëndoshë nuk është vetëm një kusht për të qenë përgjegjës në aspektin fetar. Mendja duhet përdorur edhe për bërë një jetë me parime islame, prej së cilës do të jetë i kënaqur edhe Allahu. Siç kuptohet edhe nga ajeti që kemi dhënë në hyrje, një nga shkaqet e zbritjes së Kuranit na bëhet e ditur në atë formë.

Kurani, si një thesar i dijes dhe i urtësisë, i fton ata të cilëve u drejtohet të mendojnë mbi të dhe këtë, e përsërit vazhdimisht në raste të ndryshme. Për shembull, në një ajet tjetër, çështja trajtohet në këtë formë: **“Ne e zbritëm këtë Kuran në gjuhën arabe, me qëllim që të kuptoni!”** (Jusuf, 2.)

Meditimi fetar kërkon aktivizimin e të gjitha mënyrave të kuptimit, me qëllim që tek njeriu të sigurohet uniteti mendje-zemër. Kurani e përdor këtë si një metodë, sepse njerëzit që nuk e kanë të gjallë botën e mendimit dhe meditimit, edhe jeta e tyre fetare do të mbetet e dobët. Për rrjedhojë, me qëllim që të fitohen disa vlera dhe sjellje të caktuara, është shumë e rëndësishme që ajetet të bëhen temë e mendimit. Por për fat të keq, nëse sot shohim marrëdhënien e myslimanëve me Kuranin, vëmë re se kjo marrëdhënie nuk ka në qendër të kuptuarit. Në thelb, kjo marrëdhënie nuk bazohet në mendim, por në ndjenja. Pra, nuk ka të bëjë me mendjen, por me adhurimet. Gjithashtu, kjo marrëdhënie synon më tepër fitimin e sevapeve dhe shpërblimeve në botën tjetër, sesa ndërtimin e një personaliteti islam dhe të kësaj bote. Si rezultat i këtij botëkuptimi për të cilin bëhet fjalë, respekti ndaj Kuranit është kthyer prej respektit ndaj urdhrave hyjnore që përmban, në respektin ndaj Librit si objekt fizik dhe në shpresimin e begatisë prej tij.

Nga një anë, Kurani u shenjtërua, por nga ana tjetër u largua nga jeta reale. Sot myslimanët nuk po ndajnë kohën e duhur për të kuptuar këtë fjalë hyjnore. Tashmë, ata duhet t’i ndryshojnë këto

zakone dhe çdo ditë duhet të qëndrojnë për një farë kohe duke meditaruar mbi të. Përndryshe, urdhrat dhe mësimet e tij në lidhje me besimin, adhurimin, moralin, historinë dhe shoqërinë, do të vazhdojnë të neglizhohen.

Në fakt, a nuk ka qenë kultura e shpalljes burim i frymëzimit për myslimanët e parë dhe qytetërimin Islam? A nuk duhet të jetë edhe sot kështu? Për shkak se shumica e myslimanëve e kanë neglizhuar të kuptuarit e Kuranit, ata nuk i kanë dhënë rëndësi as kuptimit të ajeteve në lidhje me natyrën. Mirëpo, këto ajete na ftojnë të kuptojmë argumentet e krijimit.¹

Qëllimi kryesor i Kuranit në këto ajete, është të ndërtojë përfytyrimin e teuhidit, pra, të konceptit të një Zoti të vetëm. Është e qartë se kjo formon një prapaskenë të rëndësishme në formimin e mendimit të studimit të gjithësisë e për rrjedhojë edhe të zhvillimit të shkencave natyrore. Në Kuran, funksionimi normal dhe i rregullt i natyrës cilësohet si një argument hyjnor. Po në të njëjtën mënyrë, edhe mrekullia që e tejkalon këtë normalitet apo rregullsi, cilësohet si argument hyjnor. Dhe kjo përbën një situatë të çuditshme. Mbase me këtë, kërkohet të na kujtohet fakti se, “Ashtu siç interesoheni për mrekullitë, ashtu duhet të interesoheni edhe për misteret dhe urtësitë e ajeteve të Kurani në lidhje me natyrën, të cilat to t’ju mahnitin. Pra, përse nuk mediton mbi to?”

Në botëkuptimin e Kuranit, i gjithë krijimi është i mbushur me argumente të panumërta që e thërrasin njeriun tek Zoti i tij. I gjithë krijimi me çdo lloj forme të tij, vërteton dijen e pakufishme të Krijuesit, forcën e Tij të pashoqe dhe fuqinë e Tij të krijimit. Të gjitha krijesat, që prej kafshëve, deri tek bimët, gjallesat mikroskopike etj., janë krijuar me një përsosmëri që e mahnit njeriun. Në këtë

1. - shih. Xhathije, 3-6.

pikëpamje, i gjithë krijimi qëndron para njeriut si një libër plot me mistere që presin të kuptohen. Por për fat të keq, shoqëritë myslimane të ditëve tona nuk bëjnë përpjekje të mjaftueshme për të kuptuar natyrën dhe për të deshifruar sistemin dhe mënyrën se si funksionon gjithësisë. Përkundër këtyre, atyre u tërheqin më shumë vëmendje tregimet në lidhje me mrekullitë dhe kerametet, duke treguar një interes të jashtëzakonshëm për ndodhitë e jashtëzakonshme.

Me sa po shohim, sot, me studimin e madhëstisë së mënyrës së funksionimit të natyrës, po interesohen më tepër perëndimorët me qytetërimin e tyre modern. Ata, mrekullinë (!) po e kërkojnë në zbulimin e mënyrës së funksionimit të gjithësisë dhe në shndërrimin e saj në teknologji. Mirëpo, duhet theksuar se në botëkuptimin perëndimor natyra është një tërësi mundësish prej të cilave njeriu mund të përfitojë vetëm në aspektin material. Ajo nuk ka asnjë kuptim metafizik dhe shpirtëror. Për ta, natyra merr vlerë vetëm kur zbulohen ligjet e saj, të cilat pasi aplikohen në teknologji, i ofrohen përdorimit njerëzor.

Sot njeriu ka arritur në një nivel të jashtëzakonshëm në zbulimin e mistereve të gjithësisë. Mirëpo, gjithë ato dije të akumuluar në fushën e shkencës, nuk shprehin ndonjë gjë të veçantë në lidhje me falënderimin ndaj Krijuesit. Ata nuk po nxjerrin ndonjë mësim prej librit të gjithësisë. Dijet e fituara në lidhje me mrekullitë në krijimin e natyrës dhe të njeriut, nuk po i hapin rrugë një botëkuptimi shpirtëror dhe konceptit të Zotit. Këto evidentime, nuk janë vetëm për botën jomuslimane, por kryesisht vlejné edhe për shoqëritë islame, sepse në librat e lëndëve të shkencave natyrore që jepen sot në shkollat tona, vazhdon të ndikojë botëkuptimi për të cilin po flasim. Dhe kjo nuk është asgjë tjetër përveçse struktura e një mentalitetit të copëtuar.

Kuptimi i Kuranit, natyrës dhe historisë (shoqërisë), përbëjnë tri pikat kryesore ku mbështetet qytetërimi islam. Për sa kohë që myslimanët nuk i bëjnë këto tri fusha tema të dijes dhe të botëkuptimit, nuk do të jetë e mundur të ndërtojnë një kulturë dhe një qytetërim që do t'i japë shpresë njerëzimit. Kuptimi dhe interpretimi i Kuranit nuk është konsumuar

në të shkuarën dhe nuk do të konsumohet as në të ardhmen. Përkundrazi, myslimanët duhet të kuptojnë dhe ta interpretojnë Kuranin çdo shekull brenda metodave të përcaktuara.

Nga ana tjetër, botëkuptimi i myslimanëve në lidhje me natyrën dhe historinë nuk duhet të bazohet në atë të qytetërimeve të tjera. Prej tyre duhet të përfitojnë, por këto fusha duhet t'i bëjnë vetë personalisht objekt studimi brenda kuadrit të parimeve themelore islame.

Një nga pasojat që ka shkaktuar mostregimi i interesit të duhur të myslimanëve në kuptimin e Kuranit, është edhe fakti se një pjesë e rëndësishme e Kuranit përbëhet nga tregime, ku flitet për ligjet që kanë shkaktuar ngritjen dhe rrënimin e shoqërive të ndryshme. Nisur nga kjo, myslimanët duhet të zhvillojnë doktrina në lidhje me shkencat shoqërore të frymëzuara prej Kuranit. Por për fat të keq, kërkimet në këtë fushë janë ende në gjendje të pamjaftueshme.

Kurani Fisnik pret të kuptohet dhe të studiohet me kujdes të madh në këtë aspekt. Studimet që do të bëhen në këtë fushë, nuk duhet të jenë vetëm teorike, por në të njëjtën kohë, duhet të synojnë edhe zbatimin e tyre në jetën reale. Këtë aludon edhe Allahu në Kuran, kur thotë: **“...Vallë! A nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë për të parë se si ka qenë fundi i popujve, që kanë jetuar para tyre?..”** (Jusuf, 109; shih. En'am, 11.)

Çështja që prek ajeti i mësipërm, nuk nënkupton konfirmimin e historisë së popujve të shkuar prej librave të historisë, por duke shkuar vetë personalisht në vendbanimet e tyre të vjetra. Pra, është e domosdoshme të bëhet një interpretim i ri i historisë duke u nisur prej zbulimeve arkeologjike dhe argumenteve konkrete. Mirëpo, është e vështirë të thuhet se myslimanët po bëjnë studimet e nevojshme edhe në këtë fushë, sepse shkenca e arkeologjisë që jepet ende në universitetet tona, bazohet kryesisht në kërkimet e bëra nga të huajt, e për rrjedhojë edhe në gjykimet dhe studimet e tyre.

Si përfundim, për arritjen e një rigjallërimi dhe rindërtimi duhet të pohojmë se kultura e shpalljes, duhet të bëhet burimi i dijes dhe jetës sonë.



Profeti (a.s.), ka thënë:

“Nëse do të mbështeteshit ashtu siç duhet tek Allahu, do të furnizoheshit ashtu siç furnizohen zogjtë të cilët në mëngjes dalin të uritur, e në mbrëmje kthehen të ngopur!”

(Tirmidhi, Birr, 3)

MBËSHTETJA TEK ZOTI... SI ZOGJTË!

Sa i përket zogjve që dalin të uritur nga foletë në agim dhe kthehen të ngopur në mbrëmje... Si çdo mëngjes, edhe këtë herë çdonjëri prej tyre u ngrit në fluturim i uritur... I qetë, me shpresë e me dëshirë... Më pas, pa qëndruar në pritje, përqafoi qiellin me flatrat e tij. Besnik, i përzemërt dhe i sinqertë... Fluturuan me kënaqësi mes reve të bardha, vallëzuan me hare duke lëshuar krahët mbi erë dhe shpuan qiellin për të zbritur në thellësitë e tij... Kush i shih-te, pandehte se ishin sundimtarë të qiellit, por ata vetëm sa po kalonin përmes qiellit pa kërkuar ta posedojnë atë.

Ajo që i bënte ata të fluturonin dhe të ishin optimistë pa i mbajtur shpresat tek qielli, ishte se ata furnizimin nuk e prisnin prej qiellit, por prej Sunduesit të qiellit... Ndërkohë që ne ecnim, prej qiellit tonë kalonin zogj. Ngritëm kokën dhe ata ishin gjithmonë në lartësi... qielli blu është shtëpia e tyre. Me sa duket, na kaploi dëshira dhe zilia... filluam të vraponim, aq sa mbetëm pa frymë. Mirëpo, nuk e dinim se të vraposh, nuk ishte e njëjtë sikur të fluturosh... E çfarë na pengonte neve të fluturonim me dy krahë, kur ata fluturonin me dy flatra? Po, edhe neve duhet të kishim flatra... jo vetëm dy, por tre, katër, pesë, e madje edhe më shumë... Duhet të bënim llogari e plane për të garantuar edhe çështjen e fluturimit si çdo gjë tjetër! U llogaritën të gjitha mundësitë deri në detajet më të imta, u bënë statistikat dhe u eliminuan të gjitha rreziqet.

Çdo gjë ishte në rregull, por nuk u bë!.. Nuk arritëm ta shijonim dot atë kënaqësi. Flatra kemi, apo jo? Po, dhe me tepicë! Mirë, por pse nuk mund të fluturojmë? Sepse flatrat e shpirtit tonë janë të thyera! Po çfarë është ajo që e bën me flatra shpirtin tonë? Mbështetja tek Zoti! Këtë e thoshte Profeti që njëhte qiejt dhe sillte lajme prej andej. Ai na ka bërë të ditur se ne mund të rrihnim flatrat së bashku me zogjtë

e të ndiheshim të lirë si ata duke u mbështetur tek Allahu... E nëse do të ndiqnim gjurmët e zogjve, këmbët tona do të lëshonin tokën. Ai na tregon se për të shpëtuar prej peshave që na tërheqin drejt tokës dhe të ngrihemi lart, na duhet të mësojmë shumë prej zogjve. Prandaj ai na jep shembull zogjtë dhe thotë: “Nëse do të mbështeteshit ashtu siç duhet tek Allahu, do të furnizoheshit ashtu siç furnizohen zogjtë të cilët në mëngjes dalin të uritur, e në mbrëmje kthehen të ngopur!” (Tirmidhi, Zuhd, 33.)

Zogjve mund t’u ngajjnë vetëm ata që mbështeten plotësisht tek Allahu... Dhe këtë mund ta bëjnë vetëm ata që kanë hall qiellin dhe dëshirojnë të fluturojnë... Të mbështetesh tek Allahu nuk do të thotë të rrih në vend, por të fluturosh. Kjo është vepër e atyre që i kanë sytë në lartësitë qiellore. Vepër e atyre që kanë ëndrra, ideale dhe synime të mëdha dhe mbështeten tek “Ekberi”, tek më i Larti...

Ai që furnizon milingonat, peshqit, e zogjtë, Ai na furnizon edhe ne. Për këtë duhet të jemi të vetëdijshëm, sepse shpirtat që nuk kanë besuar, nuk janë mbështetur dhe nuk janë përkushtuar, nuk mund ta ndejnë këtë kënaqësi... Ata që përjetojnë mjerimin e mosbesimit dhe ata që mbështetjen tek Allahu e konsiderojnë dembelizëm, nuk mund ta dinë se si mbështetja në Allahun e vë në lëvizje njeriun me gjithë qenien e vet... Vetëm ata që i hapin duart drejt qiellit mund ta shijojnë mbështetjen tek Allahu... Ata që ndoqën të dërguarit që sillnin lajme prej qiellit e dinë shijen e saj... Vetëm ata që njohin Sunduesin e vetëm të shtatë qiejve mund të ngrihen deri tek mbështetja në Allahun. Prandaj, mbështetja tek Allahu është vepër e njerëzve të qiellit, jo të “esfel-i safilin”-ëve (më të ulëtit e të ulëtëve)...

Ata që nuk arrijnë t’i shkëpusin këmbët prej tokës, si mund ta dinë çdo të thotë të fluturosh? Ata që janë lidhur në tokë me njëmijë e një lloj prangash, si



mund të lëvizin? Ata që merren me lloj-lloj hallesh të tokës, si mund të marrin hise prej qiejve? E si mund t'i lejojë ata egoizmi i vet, lakmitë dhe luftërat e pambarim t'i besojnë një qenieje tjetër përveç vetes së tyre? Nuk i lejon! Në këtë situatë, për ta, edhe dita, edhe nata është një... Njeriu bëhet peng i dyshimeve dhe frikës. Ai harron se çdo gjë e ka një Sundues dhe përpiqet vazhdimisht të sundojë gjithçka. Qetësia e braktis atë qetësisht dhe zhurmat plaçkitin brendësinë e tij. Ndërsa pyetjeve pa përgjigje nuk u vjen fundi.

Shqetësimi i furnizimit, ankthi i jetesës dhe angazhimi me këtë botë nuk e lënë asnjëherë rehat. Dyshimet, ankthet, pritshmëritë, probabilitet, vallë-t, sikur-et, mbase-t nuk kanë fund për të. Ai humbet në vorbullën e skenarëve të fatkeqësive...

Pa besuar Atë, nuk mund të arrijë paqen zemra e njeriut. Pa u mbështetur tek Ai, nuk mund ta dijë ç'është qetësia. Pa i zënë besë Atij, nuk mund ta ndjejë veten të sigurt. Kemi nevojë të zëmë besë, të besojmë e të strehohemi, sepse jemi të dobët. Jeta jonë, vdekja jonë, madje edhe furnizimi i ynë është në dorën e Tij. Kur i besojmë kësaj dhe mbahemi tek Ai, atëherë mund të shijojmë ëmbëlsinë e mbështetjes tek Ai. Atëherë mund të shpëtojmë prej hamallëkut të peshave të panevojshme, e të lehtësohemi. Prej peshave që kërrusin belin tonë dhe prej tepricave që nuk jemi të detyruar të bartim, mund të shpëtojmë vetëm atëherë kur punët tona t'ia besojmë Atij. Ne nuk mund të jemi sundimtarët e gjithçkaje, nuk mund të mbajmë gjithçka nën kontroll, nuk mund t'i llogaritim të gjitha mundësitë dhe nuk mund të harrojmë dobësinë dhe të qenit njeri, e të hymë në rolin e Zotit. Jemi të detyruar të kuptojmë se peshoret

nuk peshojnë vetëm materien, llogaria nuk mund t'i lihet vetëm numrave dhe ajo nuk mund të bëhet vetëm me matematikë.

Ne përpiqemi ta nxjerrim qiellin nga bota jonë dhe synojmë të ndërtojmë një botë për veten tonë në tokë. Dhe, as që jemi të vetëdijshëm se po e burgosim veten në tokë, ndërkohe që sipër kemi qiejt pakufi. Madje as që e ngremë kokën të shohim zogjtë që fluturojnë në paqe. Fakti që nuk ngopemi, nuk dimë të ngopemi dhe nuk jemi të kënaqur me atë që meritojmë, na ndan prej zogjve dhe nuk mund të fluturojmë. Ne nuk arrijmë të shpëtojmë prej ngushëtisë së shpirtit pavarësisht gjithçkaje që kemi. Nuk arrijmë ta kuptojmë se boshllëkun brenda vetes nuk mund ta mbushim me materialen.

Por, a ka më të qetë se ai që thotë: **"...Më mjafton Allahu, s'ka zot tjetër përveç Tij. Unë mbështetem tek Ai që është Zot i Fronit të Madh!"** (Teube, 129.) E çfarë tjetër mund ta bëjë njeriun të përjetojë lehtësinë që i jep ajeti: **"...Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai!.."** (Talak, 3.)? E çfarë mund ta pengojë njeriun nga ngritja pasi të ketë thënë: **"Allahu i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë!.."** (Nisa, 132.) dhe **"O Allah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash; Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Çdo e mirë është në Dorën Tëndë!"** (Al-i Imran, 26.)? Mjafton që ai të ngrejë kokën e të shohë zogjtë. Një harabel i vogël, një pëllumb, ose një pupëz mund t'i tregojë rrugën...

Profeti ynë (a.s.), na dha shembull zogjtë, por a ka ndonjë prej nesh që mund t'u bëhet shembull zogjve?..



ILAÇI SHËRUIES I DHUNËS DHE INJORANCËS

SEKRETI I FAMILJES

I Madhi Zot unitetin, apo të qenit Një, e ka veçuar vetëm për veten e Tij. Çdo gjë e ka krijuar në çift. Po ashtu edhe njeriun e krijoj çift, burrë dhe grua.

Krijoi me vullnetin e Tij familjen me anë të bashkimit të burrit dhe të gruas. Dhe kështu, njerëzimi u zhvillua nga Ademi dhe Havaja me anë të formimit të familjes së parë në emër të Zotit.

Allahu i Lartësuar e ka krijuar njeriun të dobët dhe të pafuqishëm, në mënyrë që ai që prej momentit të lindjes të ndjejë nevojë për dashurinë e nënës dhe edukimin e babait. Më pas, me fshehtësinë e përkohshmërisë dhe urtësinë e plakjes, prindërit i bën që të kenë nevojë për fëmijët e tyre.

Në këtë mënyrë lind dhe krijohet një shoqëri e lidhur ngushtë me ndjenjat dhe virtytet e bukura të dashurisë, mëshirës, besnikërisë, bindjes, dhembshurisë dhe respektit. Ademi (a.s.), babai i parë i gjithë kësaj familjeje të madhe, ishte gjithashtu një pejgamber.

Urtësia Hyjnore i dhuroi burrit dhe gruas disa të drejta dhe detyra të përshtatshme me karakteristikat e tyre të krijimit. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Të gjithë ju jeni barinj dhe të gjithë jeni përgjegjës për kopenë tuaj. Burri është bariu i familjes dhe ai është përgjegjës për kopenë e tij. Gruaja është bareshë e shtëpisë dhe ajo është përgjegjëse për kopenë e saj.” (Buhariu, Vesajat, 9)

Në këtë botë të mbushur me sprova i Madhi Zot dëshiroi formimin e familjes dhe krijimin e një strukture shoqërie në përputhje me kënaqësinë e Tij.

Andaj sipas kësaj urtësie:

Pejgamberët i zgjodhi nga familjet fisnike, të pastra dhe të moralshme. Ndërkohë që përhapnin urdhëresat hyjnore tek njerëzit, ata shpalosnin edhe moralin, sjelljen dhe urtësinë e tyre ashtu sikurse dëshironte i Madhi Zot, por përpara se ta praktikonin këtë edukim tek popujt e dërguar, ata në radhë të parë e ushtronin në familjet e tyre.

Edhe i nderuari i kësaj bote, Pejgamberi (a.s.), rrjedh nga një familje e ndritur, e pastër në moral, e kujdesshme në hallalin martesor; pasardhëse e familjes së Ibrahimit (a.s.) dhe Ismailit (a.s.).

Pas një rinie të pastër dhe të moralshme, në moshën njëzet e pesë vjeçare krijoi së bashku me nënën e besimtarëve, Hatixhen (r.a.), familjen më të qetë, më të lumtur dhe me të bukur të botës. Kjo familje dhuroi më pas martesën e bekur në mes të Fatimes (r.a.) e Aliut (r.a.) dhe pasardhësit e tyre Hasanin e Hysejnin, duke i treguar njerëzimit sekretin e krijimit të familjes më të lumtur dhe më të hajrit në botë, atë të familjes së Ehli Bejtit.

Tradita e Profetit të Zotit (a.s.), dhe morali i tij i lartë luajnë një rol të rëndësishëm në lumturinë e jetës sonë familjare...

KRITERET E FAMILJES SË LUMTUR...

Kriteri ynë më i vlefshëm është ai i të Dërguarit të Allahut r. Ekuilibri i lumturisë sonë është i nderuari i botës, Pejgamberi (a.s.). Ndërsa pasuria dhe cilësia e botës së tij shpirtërore vjen e shpalosur më së miri tek ne në karakterin e sahabëve të ndritur, shokëve të tij më të mirë.

Mashkull apo femër, grua apo burrë, djalë apo vajzë apo kushdo qoftë, do ta arrijë lumturinë dhe kënaqësinë në të dy botët në sajë të përpjekjeve të tij për



t'ia pështatur kriteret personale sa më shumë të jetë e mundur formës së asaj familjeje të bekuar.

Gjatë historisë së ymetit të Muhamedit (a.s.), e cila i ka kaluar tanimë katërbëdhjetë shekuj, personat apo shoqëritë që u kanë kushtuar kujdes këtyre kri-tereve hyjnore, janë bërë pjesë e mëshirës. Ndërsa ata që qëndruan larg këtyre kriterëve, u bënë pjesë e dhunës dhe dëshpërimit.

Në ditët e sotme; zemrat e ngurtësuarra, të cilat kanë braktisur Sunetin dhe traditën mëshiruese të Pejgamberit (a.s.), duke rënë pre e robërisë dhe forcës, ushtrojnë dhunë ndaj gruas.

Sipas Islamit, femra në statusin e nënës, fsheh Xhenetin nën këmbët e saj, si grua mbrohet nga ligji, si fëmijë rritet në mes bukurive natyrore; për fat të keq sot shtypet, dhunohet, dëbohet nga shtëpia, detyrohet të prostituojë, torturohet dhe shfrytëzohet në çdo lloj forme.

Porse:

Sa i hidhur është përfundimi i një diamanti në koshin e mbeturinave! Sa i pafat është ai diamant, i cili përfundon në mbeturina! I ngjashëm me lulen e mbirë në cepin e një kalldrëmi që është e destinuar për t'u shtypur nga këmbët e kalimtarëve.

E NGJASHME ME KOHËN E INJORANCËS...

Edhe përpara se drita e Islamit ta zhdukte errësirën e periudhës së injorancës, gjendja e femrës ishte po ashtu e shkretuar. Foshnjët e lindura vajza, sapo vinin në këtë botë, përballëshin me fytyrën e zemëruar të babait. Nën ulërimat e pashpresa të nënës rrëmbeheshin nga duart e saj për t'u groposur më pas të gjalla.

Edhe nëse shpëtonte nga vdekja, vuajtjet e saj nuk mbaronin. Gjatë armiqtësive të lindura në mes të fi-

seve, ofendimi më i madh që i bëhej armikut ishte nëpërkëmbja e ndonjë femre.

Edhe nëse martohej nuk mbaronin vuajtjet për të. Në kohën e anarkive, aty ku drejtësia dhe ligji nuk ekzistonin, e martuar qoftë apo e pa martuar, femra ishte gjithmonë një gjallesë e nënçmuar, e shtypur, e privuar nga të drejtat, e përdorur si plaçkë ose si diçka e rëndomtë, e cila shërben vetëm për të ngopur dëshirat seksuale.

Përfshirja e prostitucionit në mbarë shoqërinë dhe vala rrëmbyese e imoralitetit po e dërgonin gruan drejt shtigjeve akoma më të pakapërcyeshme. Brezi i ardhshëm ishte i pambrojtur. Qoftë nëna, qoftë bashkëshortja, qoftë fëmija... Gruaja ishte e pambrojtur!..

Ajo ishte periudha e terrorit të vërtetë. Shpallja hyjnore e Pejgamberit tonë të dashur r, erdhi si përgjigje ndaj këtij terrori të egër dhe brutal.

Në suret mekase ndjekin njëra-tjetrën paralajmërimet e mëposhtme:

“Kur foshnja e varrosur për së gjalli të pyetet. Për çfarë faji ishte vvarë: Atëherë çdokush do të marrë

vesh çfarë kishte përgatitur (për këtë Ditë).” (Tekvir, 8-9, 14)

“Kur ndonjëri prej tyre merr lajmin se i lindi një vajzë, fytyra i nxihet dhe i mbushet me mjerim. Ai fshihet nga njerëzit për shkak të lajmit të keq që mori dhe s’di: a ta mbajë këtë fëmijë, pavarësisht poshtërimit apo ta varrosë në dhë. Ah! Sa mbrapsht që gjykojnë ata!” (Nahl, 58-59)

I dërguari si mëshirë për mbarë botën, dhurata më e mirë e njerëzimit, Pejgamberi (a.s.), nuk u mjaftua vetëm me çlirimin e njeriut qoftë burrë apo grua, fëmijë apo i moshuar, nga duart e arrogancës, dhunës, poshtërsisë dhe urrejtjes, por mbrojti me mëshirë e dashuri kafshët dhe bimët.



Në njëfarë mënyre, i strehoi nën krahët e tij të mëshirës të gjitha krijesat...

KRAHUN E TIJ TË MËSHIRËS E SHTRIU PËR GJITHËSINË...

Zemra e tij nuk u pajtua me dëmtimin e pemëve, qoftë edhe me shkundjen e tyre të panevojshme...

Ndërhyri me mëshirë...

Nuk u pajtua asnjëherë me mjeljen e kafshëve në kushte të papastra dhe sjellje të ashpër, sidomos mjeljen e gjithë qumështit duke mos lënë aspak për të voglin e saj.

I dha rëndësi mësimit të pastërtisë, dashurisë dhe mëshirës.

Nuk ishte i kënaqur me bisedat e stërgjatura gjatë udhëtimit mbi kafshë.

Mësoi të përsosurën dhe të hijshmen.

Zemra i tha të mos e shqetësonte nënën e qenushit, e cila po i jepte gjë të voglit të saj, andaj vendosi ta ndryshojë drejtimin e gjithë asaj ushtrie të madhe.

Praktikoi sakrificën dhe sjelljen e mirë.

Sidomos kur pa një fole milingonash që po digjej nga zjarrin u skuq nga zemërimi, madje edhe devetë e mbingarkuara erdhën dhe u ankuan tek ai.

Shkurtimisht, në atë vend ku drita e tij, u përhap, dhuna u shua njëherë e mirë përgjithmonë; prania e tij, i la vend mëshirës, hijeshisë dhe të bukurisë.

Ashtu sikurse të gjitha krijesat e tjera edhe gruaja është bërë pjesë e mëshirës së Pejgamberit (a.s.).

Femra zuri vend në pallatin mbretëror, në fronin e krenarisë së të qenit nënë. U përcaktuan të drejtat dhe detyrat në formën më të përshtatshme të krijimit të saj si në martesë, divorc, trashëgimi, në shtëpi, në publik apo në çdo situatë tjetër. Gjeti respektin dhe krenarinë e humbur.

Pejgamberi (a.s.), për ta realizuar këtë gjë, i foli ymetit të tij;

U FOLI NDËRGJEGJEVE

Urdhëroi dhe tha: *“Më i miri ndër ju është ai i cili sillet më mirë me familjen e tij!”* (Ibn Maxhe, Nikah, 50; Darimi, Nikah, 55)

“Mos i rrihni gratë!.. Ata që i rrahin gratë e tyre, nuk janë më të mirët në mesin tuaj.” (Ebu Davud, Nikah, 42; Ibn Maxhe, Nikah, 51)

Me sjelljen e tij u kthye në një shembull të pashoq të jetës familjare.

Duke u nisur nga fakti se nëna e njerëzimit Havaja u, ishte krijuar nga brinjët e burrit, Pejgamberi (a.s.), këshillonte që të mos ushtrohej forcë, dhunë apo presion mbi gratë të cilat paraqitnin sjellje të gabuara, sepse një veprim i tillë nuk do të japë rezultat, por të punohet për t'i edukuar me sugjerime dhe këshilla të mira dhe të dobishme.

Urdhëronte që çështjet e vogla të mos zmadhohehin, si dhe këshillonte që durimi, mbështetja tek Zoti e kënaqësia për atë çka posedon janë rrugë më të hajrit për njeriun.

Përhapi urdhërin hyjnor:

“Jetoni e silluni mirë me to! Në qoftë se ato nuk ju pëlqejnë aq shumë, duroni sepse është e mundur që juve të mos ju pëlqejë diçka, pikërisht për këtë Allahu do t'ju sjellë shumë të mira.” (Nisa, 19)

Sa bukur e tregon ky shembull sjelljen e butë dhe të çiltër që rekomandonte i Dërguari i Allahut (a.s.), ndaj gruas dhe ndaj gjinisë femërore në përgjithësi:

“Mos ta urrejë ndonjëri gruan e tij. Nëse nuk i pëlqen një sjellje e saj, do t'i pëqejë një sjellje tjetër.” (Muslim, Rada, 61)

KUJDES QË TË MOS THYHEN KRISTALET!

Tek arabët ishte zakon që gjatë udhëtimit të nxiteshin devetë me anë të këngëve dhe melodive në mënyrë që të ecnin më shpejt. Gjatë një udhëtimit, një skllav i quajtur Enxheshe duke kënduar i shpejtoi ritmin e ecjes devesë me melodinë e tij. Me qëllim që të mos shqetësoheshin gratë të cilat ndodheshin mbi devetë, Pejgamberi (a.s.), me një krahasim të këndshëm i thotë:

“O Enxheshe! Kujdes që të mos thyhen kristalet!” (Buhari, Edeb, 95; Ahmed, III, 117.)

Sa shembull të bukur ka zgjedhur i Dërguari i Allahut (a.s.), në rastin e përngjasimit të grave me kristalet. Këshilla të rëndësishme të cilat na tregojnë ndjeshmërinë dhe delikatesën që posedon shpirti, mendja dhe trupi fizik femëror.

Pejgamberi (a.s.), u mundua gjithë jetën e tij, me qëllim që drejtësia, morali i lartë dhe sjelljet e mira të mbizotëronin si brenda familjes ashtu edhe në shoqërinë përreth. Edhe në fjalët e tij të fundit nuk harroi që t'ia linte emanet ymetit (popullit) të tij këto këshilla:

“Mos ta urrejë ndonjëri gruan e tij. Nëse nuk i pëlqen një sjellje e saj, do t'i pëqejë një sjellje tjetër.”
(Muslim, Rada, 61)

Enesi (r.a.), tregon kështu:

Gjindeshim pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.), në momentin e vdekjes së tij. Para se të ndërronte jetë, na tha tri herë;

“Kijeni frikë Allahun në çështjen e namazit!”

Pastaj vazhdoi dhe tha:

“Frikësojuni Allahut për njerëzit të cilët ndodhen nën urdhrin tuaj, frikësojuni Allahut për të dobëtit si: gratë e veja dhe fëmijët jetimë...” (Bejhaki, Shuab, VII, 477)

Profeti (a.s.), i kushtoi rëndësi të madhe sidomos të drejtave të personave të dobët brenda shoqërisë, të cilët ishin më të rrezikuar për t'u shtypur, nënçmuar, keqtrajtuar apo lënë pas dore. Kështu që para se të vendoste ligjet që impononin drejtësinë, u mundua të edukojë ndërgjegjet dhe zemrat e njerëzve. Shkatërroi arrogancën e periudhës së injorancës dhe themeloi çiltërsinë e besimit dhe madhësitinë e Islamit. Kur filluan të zbrisnin ajetet në lidhje me sistematizimin e së drejtës familjare, shokët e nderuar ishin kthyer në një shoqëri të përsosur, saqë në shenjë respekti ndaj Profetit (a.s.), përdornin gjithmonë shprehjet:

“Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë” ose “Nëna dhe babai im të qofshin falë o i Dërguari i Allahut!...”

Tanimë kjo shoqëri e tëra, duke përfshirë mashkull e femër, fëmijë e të moshuar, zbatonte me përpikmëri urdhrat jetësore të Profetit (a.s.), duke mos pranuar asnjë formë tjetër adhurimi përveç adhurimit ndaj Zotit të Gjithësisë.

Kështu që ajo femër e periudhës së injorancës (para-islame), në të cilën përveç lidhjes biologjike nuk kishte asnjë vlerë tjetër dhe ku shfrytëzohej dhe dhunohej vazhdimisht, në shekullin e artë (periudhën e parë islame), ajo fitoi vlerat jetësore të dërguara nga i Madhi Zot nëpërmjet të Dërguarit të Tij (a.s.) dhe arriti një shkallë të lartë duke u quajtur “femër e denjtë dhe e devotshme”...

FEMRA E DEVOTSHME

Prej mbështetësve të parë shpirtërorë të Pejgamberit të Zotit (a.s.) dhe e para e cila i besoi mesazhit të tij, ishte gruaja e parë dhe nëna e besimtarëve, Hatixhja (r.a.).

Urtësia dhe caktimi hyjnor deshën që Pejgamberi (a.s.), të rritej jetim, pa mbështetjen e prindërve, por pati në krahë një grua të devotshme sikurse Hatixhja (r.a.). Ajo i dhuroi qetësi dhe lumturi në familje dhe për një kohë të gjatë ishte shtylla kryesore për mbështetjen materiale dhe shpirtërore të tij. Më pas edhe ajo bashkëshorte dhe grua e begatë ndërroi jetë. Pejgamberi (a.s.), së bashku me të kishte kaluar vitet më të vështira të shpalljes hyjnore. Sa e sa probleme dhe fatkeqësi kishin përballuar së bash-

ku. Asnjë fatkeqësi nuk e preku aq shumë zemrën e Pejgamberit (a.s.), sa vdekja e Hatixhes (r.a.). Atij viti ku humbi këtë grua të begatë iu dha emri “viti i dëshpërimit”.

Edhe gradën e lartë të dëshmorit të parë në Islam e fitoi një grua, Sumejja (r.a.).

Ajo çka e shndërroi Omerin e egërsuar nga zemërimi, me shpatën e zhveshur dhe qëllimin për të “vrrarë Pejgamberin (a.s.)” në Omerul-Faruk (Omerin e drejtë), ishte vendosmëria e mbushur me besim e motrës së tij, Fatimes (r.a.).

Lindën dhe u edukuan në këtë periudhë të artë për njerëzimin nëna të tilla si bija e Pejgamberit të Zotit (a.s.), Fatimja (r.a.)...

U rritën figura madhështore në fushën e diturisë dhe edukimit, si ajo e nënës së besimtarëve, Aishes (r.a.), e cila ishte njëra prej themelueseve të para të shkencave të Fikhut dhe Hadithit.

Kopja e parë e Kuranit Famëlartë iu besua nënës së besimtarëve, Hafsës (r.a.).

Lindën nëna si Esmaja, bija e Ebu Bekrit, vendimtare si një fortesë e palëkundshme përballë dhunës dhe padrejtësive. Nesibja (r.a.), trimëreshë që u bë mburojë në luftë përkrah Pejgamberit të Zotit (a.s.).

I cilësuar si kalifi i pestë dhe sunduesi i një periudhe të artë, Omer bin Abdulazizi, ishte nipi i një shitëseje qumështi, e cila dridhej nga frika ndaj Zotit dhe në shpirtin e saj mbizotëronte ndjenja e mirësisë.

Në këtë shoqëri të mbështjellë me mëshirë, femra ishte një heroinë e padukshme. Ato rritën Fatihët, çliruesit e vendeve dhe të zemrave prej Semerkandit e deri në Kajravan, brenda një kohe të shkurtër. Ato u kthyen në simbol të heronjve në luftërat çlirimtare dhe fitoret e shumta. Njëra prej këtyre fitoreve ishte edhe ajo e Çanakkale-së.

NJË NËNË MËSHIRUESE

Hudhejfe (r.a.), tregon kështu:

Një ditë nëna më pyeti:

“Kur je takuar për herë të fundit me Pejgamberin (a.s.)?”

Unë iu përgjigja;

“Ka disa ditë që nuk e kam takuar dot.”

Ajo u zemërua shumë dhe më kritikoi shumë ashpër.

Atëherë unë i thashë:

“Nënë e dashur! Prit, mos u zemëro! Po shkoj menjëherë tek i Dërguari i Allahut (a.s.), ta fal namazin e akshamit së bashku me të dhe t'i kërkoj që të lutet për mua dhe për ty.” (Tirmidhi, Menakib, 378; Ahmed, V, 391-2.)

Nëna të ngjashme merituan gjithmonë respektin më të lartë, dashurinë e pafundme dhe falënderimet

e përrjetshme për veprat, fjalët dhe këshillat e tyre të arta. Andaj një sahab vjen një ditë dhe pyeti;

“Kush është personi më i rëndësishëm, të cilin duhet ta ndihmoj dhe të sillem mirë me të?”

I Dërguari i Allahut (a.s.), u përgjigj:

“Nëna jote!”

Sahabiu e pyeti;

“Po pas saj kush vjen?”

Pejgamberi (a.s.), u përgjigj;

“Nëna jote!”

Sahabiu e pyeti përsëri:

“Po pastaj kush vjen?”

Pejgamberi (a.s.), përsëri u përgjigj:

“Nëna jote!”

Kur sahabiu e pyeti përsëri:

“Po pastaj kush vjen?”

Këtë herë i Dërguari i Allahut (a.s.), u përgjigj;

“*Babai yt!*” (Buhari, Edeb, 2)

Një shembull i gjallë i respektit për nënën, është sjellja që shpaloste i Dërguari i Allahut (a.s.), kundrejt nënës së tij të qumështit. Sa herë që e shikonte nënën e tij të qumështit, Halimen, e thërriste “O nëna ime e dashur!”, i paraqiste respektet më të ngrohta, e shtrinte rida-në (pelerinën e tij) dhe i thoshte të ulej mbi të. Nëse kishte ndonjë nevojë, ia plotësonte menjëherë. (Ibn Sa’d, I, 113, 114)

Ata që tregojnë respekt ndaj nënës së tyre dhe sillen në formën më të mirë me të, meritojnë gjithmonë përgëzimin e Zotit të Gjithësisë dhe të Pejgamberit (a.s.).

Një ditë i Profeti (a.s.), urdhëroi dhe tha:

“Më kishte marrë gjumi dhe e pashë veten time në Xhenet. Dëgjova zërin e dikujt i cili po lexonte Kuran. Pyeta;

“Kush është ky?”

Më thanë:

“Ky është Harith bin Nu’man.”

Më pas Pejgamberi (a.s.), vazhdoi duke thënë:

“Ja kështu fitohet mirësia, ja kështu fitohet mirësia!”

Harithi (r.a.), ishte një sahabi, i cili sillej shumë mirë me nënën e tij. (Ahmed, VI, 151-152; Hakim, IV, 167.)

Edhe figurat e ndritura në historinë e Islamit, të cilat ndoqën rrugën e artë të Pejgamberit (a.s.), përmenden ndër shekuj për shembullin e respektit dhe të dashurisë që treguan ndaj nënës.

Imami Azam Ebu Hanife, e kundërshtoi ofertën e kalifit të asaj kohe, Mensurit, në postin e gjykatësit të Bagdatit, për shkak se nuk dëshironte të mbarte pëgjegjësinë e dhënieve të fetvave. Si përfundim u burgos. Edhe në atë gjendje madje, i vetmi shqetësim që kishte, ishte se nëna e tij do të dëgjonte lajmin dhe do të mërzitej për këtë gjë.

Abdurrahman Xhami shprehej shumë bukur, ndër-
sa fliste për domosdoshmërinë e falënderimit të përrjetshëm ndaj nënës së devotshme kur thotë:

“Si të mos e dua nënën time. Ajo më mbajti për një kohë në barkun e saj, për një kohë në krahët e saj, ndërsa gjithë jetën në zemrën e saj.”

Në këtë formë dëshironte që në fillim të respektohej nëna e tij, po ashtu të fitonte edhe sevapet e sadakasë së vazhdueshme (sadekatul-xharije).

Pas atyre burrave që kanë ndyshuar popujt dhe botën fshihet gjithmonë një nënë e devotshme.

Edhe nënat me meritën e plotë të respektit dhe të falënderimit, janë gjithmonë lapidarë të vetësakrifikimit për fëmijët e tyre. Në portretin e tyre është mëshiruar gjithmonë morali i ëmbël, si cilësi dalluese në të gjitha format e edukimit dhe për këtë arsye merituan dome-
thënien e fjalës:

“Nëna është një shkollë më vete”

Ato nuk janë thjesht nëna të fëmijëve të tyre, por nënat e të gjithë ymetit të Muhamedit.

ZGJIDHJA E VETME, DEVOTSHMËRIA

Zgjidhja e vetme është një edukim i cili u flet shpirtërave, një edukim i moralshëm, i cili lulëzon zemrat, praktikon devotshmërinë, praktikon mirësinë.

Feja jonë mbron këta pesë faktorë si përmbledhës të të gjitha rregullave dhe moralit islam:

1. Mbrojtja e jetës;
2. Mbrojtja e mallit (pasurisë);
3. Mbrojtja e fesë;
4. Mbrojtja e mendjes;
5. Mbrojtja e brezave (gjeneratave).

Në këto pika nuk bëhet asnjë tolerim. Nëse nuk

“O Zoti ynë,
dhurona nga gratë tona
dhe trashëgimtarët tanë,
ç’është prehje për sytë tanë
dhe bëna shembull
për të mirët!”

(Furkan, 74)

u kushtohet rëndësi brezave të ardhshëm, familjes dhe martesës, nëse nuk parandalohet imoraliteti dhe alkooli, atëherë nuk është e mundur mbrojtja as e jetës dhe as e pasurisë. Po ashtu, nëse nuk i dilet për zot fesë dhe nuk zbatohet devotshmëria, nëse nuk qëndrohet larg nga imoralja dhe egoizmi, atëherë mbrojtja e familjes dhe e gjeneratave nga mashtrimet e djallit dhe kurthet djallëzore është e pamundur.

Kurani Famëlartë na mëson se duhet të lutemi në këtë mënyrë për një familje të qetë dhe të mbarë:

“O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç’është prehje për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët!” (Furkan, 74)

Një brez i artë dhe një grua e mirë buron vetëm nga një shoqëri e devotshme.

Gratë e ndershme dhe të sjellshme meritojnë burra të urtë dhe të devotshëm. Në familjet e privuara nga devotshmëria dhe të zhytura në gjynahe nuk mund të ketë qetësi dhe lumturi, por gjithmonë padrejtësi dhe zemërim.

Për një brez të mbarë, për fëmijë të hajrit, është e domosdoshme që kafshatat e përziera me gjak para se të lindë dhe të përziera në qumësht, pasi të lindë të jenë të hallallit. Kafshatat i japin fëmijës energjinë e duhur në sajë të mënyrës më të cilën ato janë fituar. Kafshata haram bëhet shkak i errësirës, shturjes dhe dhunës tek fëmija, ndërsa kafshata hallall i bëhet qetësi, udhëzim dhe mëshirë.

Një familje e qetë nuk formohet e vetme, ka nevojë për mbrojtjen e Zotit, pasimin e të Dërguarit (a.s.), ka nevojë për përpjekje dhe dua (lutje).

Kjo dua (lutje) e shprehur në ajetin e mësipërm të Kuranit, zë vend pas renditjes së më shumë se dhjetë cilësive të robërve të devotshëm të Allahut. Domethënë, qetësia në familje arrihet vetëm atëherë kur cilësitë e radhura në Kuran të përputhen me një jetë modeste, të ndritur me dhikër dhe namaz nate, të mbushur me frikë për Ahiretin, larg rrugëve që të çojnë në imoralitet, shpërdorim dhe kopraci. Larg dhunës, padrejtësisë dhe gënjeshtres, e nënshtuar me pendim dhe zbukuruar me vepra të mira, jo e verbër dhe e shurdhër përballë urdhrave hyjnore, por e gjallë, e ndjeshme dhe vigjilente.

Dijetari i madh i Pakistanit, Muhamed Ikbali, e shpreh në këtë formë poetike pozicionin e femrës myslimane brenda një shoqërie të tillë të devotshme:

O FEMRA MUSLIMANE!

“O ti femra myslimane! Mbulesa jote është perdja e nderit tonë. Drita në fytyrën tënde, është vaji e kandilit të besimit tonë.

Pastërtia në krijimin tënd, është mëshirë prej Zotit, është forca e fesë, është themeli i ekzistencës së ymetit tonë.

Ti je ajo që ua mëson shehadetin (dëshminë islame) për herë të parë fëmijëve të sapo ndarë nga qumështi. Dashuria jote rregullon çdo punë, çdo lodhje, çdo mendim e çdo fjalë.

O ti femra myslimane në të cilën janë lënë amanet mirësitë e fesë së Zotit! Zjarri i kësaj feje të madhërshme është ndezur me frymën tënde.

Ky shekull është hipokrit, mashtrues, pamjen e jashtme e ka të zbukuruar, ndërsa përbrenda mban erë. Hajdutët e këtij shekulli ia presin rrugën karvanëve, të cilët shtegtojnë në rrugën e fesë dhe besimit.

I “mençuri” i këtij shekulli është i verbër, nuk e njeh Krijuesin.

Vetëm ata të cilët kanë dalë jashtë njerëzillëkut mund t’i nënshtrohen zinxhirëve egoistë të këtij shekulli.

Sytë e këtij shekulli janë të mbuluar me gjak dhe pasion rebelues. Shikimin e ka të pamëshirshëm. Qerpikët i ngjajnë kthetrave të cilat dëshirojnë të nënshtrojnë çdo pre që u bie në dorë.

Ai që bie në kurthet e këtij shekulli mendon se është i lirë.

Ka pirë helm nga duart e tij dhe akoma mendon se është i shëndetshëm.

Ti je uji i jetës për fidanin e njerëzisë. Ti je ajo që ruan amanetin e këtij ymeti.

Zbulo dhe medito mbi cilësitë e tua të larta në krijimin tënd të pastër! Fatimja e nderuar (r.a.), është një shembull i rrallë për ty, mos i ndaj sytë dhe zemrën tënde prej saj!

Deri atëherë kur, edhe prej degëve të pemës tënde të lindë një fryt si Hysejini; dhe prej lulishtes së trëndafilave të rikthehet edhe njëherë ajo stinë.”

O Zoti ynë! Na dhuro në familjet tona qetësinë dhe lumturinë që i dhurove familjes së të Dërguarit Tënd (a.s.)...

O Zoti ynë!

Bëji familjet tona burime të mirësisë dhe bereqetit. Na i ruaj prindërit dhe na i udhëzo fëmijët tanë.

Amin!..



EL-MUTEKEBBIR

AI QË TREGON MADHËSHTINË E TIJ NË ÇDO PUNË

Ilir Hoxha

Ju e dini dallimin midis kryelartësisë dhe shfaqjes së madhësisë. Kur themi “u bë kryelartë ndaj meje”, shprehim kritikë, ndërsa kur themi “tregoi madhësi”, shprehim admirim.

Ka njerëz prej të cilëve presim që të jenë të mëdhenj, por ka edhe njerëz prej të cilëve nuk presim të tregojnë madhësi... Pranë atyre që në të vërtetë nuk janë të mëdhenj, por bëjnë si të mëdhenj, ka edhe prej atyre që e kanë fshehur madhësinë e tyre pas perdes së modestisë, madje, i kanë lëshuar aq shumë krahët e modestisë duke u bërë njësh me tokën, sa as vet nuk janë të vetëdijshëm për madhësinë e tyre...

Cilësia “Mutekebbir”, përmban në vetvete edhe kuptimin pozitiv, edhe kuptimin negativ të madhësisë. Kur përdoret për njerëzit, është në kuptimin negativ dhe tregon kryelartësi ose arrogancë. Ndërsa kur përdoret si emër i Zotit të botëve, është në kuptimin pozitiv dhe është tregues madhësie.

Siç mund ta kujtoni, kështu ishte edhe emri Xhebar. Kur përdorej për njerëzit, nënkuptonte despotizëm, ndërsa kur përdorej si emër i Allahut, nënkuptonte, “dikë që të gjithë ia dëgjojnë fjalën”. Të tregohesh kryelartë, është përpjekje e dikujt për t’u dukur i lartë, por që në të vërtetë nuk ka ndonjë madhësi. Duke u nisur nga vështirësia e këtij veprimi, të vjetrit e kanë quajtur “sforcim”. Mirëpo të gjithë e dimë prej jetës sonë se me sforco nuk mund të jesh i madh apo i vogël.

Në analizën e emrit Mutekebbir, dijetarët kanë thënë se, “ajo shpreh diçka të pashoqe dhe të veçantë, e jo kuptimin e papranueshëm të mburrjes dhe mendjemadhësisë”. Pra, ajo nënkupton njëshmërinë e

Zotit tonë dhe se madhështia i takon Allahut... Madhështia e Tij është aq larg imagjinatës njerëzore, saqë të gjitha thëniet që prodhojnë gjuhët tona për të përshkruar madhësinë e Tij, janë të pamjaftueshme përballë madhësisë së Tij të vërtetë. Madhësinë e Tij mund ta imagjinojmë vetëm duke studiuar veprat e Tij. Kurani gjithmonë na fton në këtë. Madje, ai nuk ngurron edhe nga sjellja si argument i një mushkonje. (shih. Bekare, 2/26.)

Zoti ynë, duke na shpallur se ky nocion është emri i Tij dhe se në lidhje me njerëzit kjo shpreh një gjendje të kritikueshme¹, ka paralajmëruar se madhështia e Tij, është prej lavdisë që zotëron dhe se, kush tenton të kërkojë madhësi në mënyrën që nuk i takon, Ai do t’i tregojë madhësinë e Vet. Në këtë mënyrë, -pa u shfaqur ende- parandalohen të gjitha dëshirat hipotetike për madhësi, të cilat do të bëhen shkak i padrejtësive të njerëzve ndaj njeri-tjetrit.

Të përpiqesh të shohësh veten të ngritur, në të vërtetë do të thotë t’i përgatitësh falimentimin vetes, sepse sëmundja e cila quhet mendjemadhësi, bëhet pengesë që virtytet e larta të zënë vend në karakterin tonë.

Ashtu si mëshira (shiu) që zbret prej qiellit, e cila nuk qëndron në vende të larta por zbret në vende të gjera... Mbi të gjitha, kur është duke kaluar prej atyre vendeve të larta, merr me vete edhe vlerat e tokës që gjenden atje.

Në sajë të dëshirës së Allahut, njeriu mund të ketë arritur në këtë botë një fuqi që nuk e kanë pasur fat shumë njerëz të tjerë. Nëse kjo situatë bëhet shkak që

1. - shih. Hashr, 23.

ai të tregohet kryelartë dhe të kaplohet nga ndjenja se është superior dhe sundues mbi çdo gjë, pikërisht aty fillon edhe rënia e tij. Kjo, sepse gjendja e mendjemadhësisë dhe e lazdritimit, e bën egon e njeriut të mbyllur ndaj çdo lloj paralajmërimi (vulosja e zemrës).²

Nëse mendohet mirë, cilësia e madhështisë, që është e veçantë vetëm për Zotin tonë, është pengesa më serioze ndaj mendjemadhësisë dhe pabindshmërisë së mundshme të njeriut. Në Kuranin Fisnik, në 18 vende të ndryshme, me anë të cilësive të ndryshme që rrjedhin prej rrënjës së të njëjtës fjalë, tregohet qartë se madhështia është e posaçme vetëm për Allahun dhe se njeriut i thuhet “ndaj kujt e mban veten me të madh ti?”.

Sa më shumë të shtohet dija e njeriut ndaj madhështisë së Krijuesit, aq më shumë shtohet edhe devotshmëria e tij. Dikush që e kupton me mendje dhe me zemër faktin se Allahu është Mutekebbir, në të njëjtën kohë, në sajë të këtij kuptimi atij i bëhet e pamundur pabindshmëria ndaj Tij.

Këtë gjendje shprehin edhe hadithet fisnike që thonë se, kur veprojmë një gjynah, drita e besimit dhe e mendjes e braktisin njeriun. Në një hadith kudsij, Allahu i Madhëruar na njofton se për Të, madhështia dhe madhëria, janë si roba që mbulon njeriun. Prandaj, atë që kërkon ta sfidojë në këtë çështje, do ta hedh në zjarr. Në këtë mënyrë, Ai na ka bërë të qartë edhe përfundimin e hidhur të mendjemadhësisë që filloi me shejtanin.³

Autorët që kanë përmbledhur “Esmau’l-Husna/ Emrat e Bukur të Allahut”, në shpjegimin e këtij emri, kanë marrë parasysh edhe kuptimin që jepet në hadithin kudsij dhe këtij emri i kanë dhënë kuptimin:

2. Shih. A'raf, 146 dhe Gafir, 35.

3. -shih. Xhathije, 37.

“Ai që i shfaq madhështinë e Vet atyre prej robërve të Tij, të cilët guxojnë të garojnë me Të në madhësi dhe që u jep dënimin e merituar”. Sipas Ibni Arabiut, fakti se Allahu i Madhëruar është Mutekebbir, ashtu siç kuptohet se Ai është i pastër/larg prej cilësive që zotërojnë krijesat, shpreh edhe se Ai i nënshtron me fuqinë e Tij edhe njerëzit e egër e mizorë, të cilët tentojnë të tregohen kryelartë.

Gjithashtu, po sipas atij, shfaqja e këtij emri tek njeriu, bën që ai të jetë i vetëdijshëm ndaj fisnikërisë së vet. Kur robi nuk e sheh veten aspak superior ndaj asnjë prej krijesave, Allahu e bën atë të kuptojë drejt emrin e Tij, Mutekebbir. Ja pra, kjo është madhështia e vërtetë. Në këtë mënyrë, njeriu është i ruajtur nga madhërimi i krijesave të tjera si vetja, duke rënë në shirk. Njeriu duhet të punojë e të përpiqet sipas gjykit të këtij emri fisnik dhe të bëhet njeri i madh. Mirëpo, asnjëherë nuk duhet të duket i madh. Ai duhet të strehohet tek modestia prej mendjemadhësisë. Në fakt, modestia është një virtyt moral që në të vërtetë mund ta shfaqin vetëm njerëzit e mëdhenj.

Gazaliu, thotë se kryelartësia që i shkon robërve, është vetëm përçmimi i çdo lloj mashtrimi të kësaj bote që mund të ndikojë negativisht në jetët e tyre shpirtërore dhe mospërfillja e tyre. Sipas tij, tek njeriu ku shfaqet ky emër hyjnor, nëse ai e kupton ashtu siç duhet madhështinë e Allahut, e ruan veten nga çdolloj situatë të shëmtuar me një dorëzim që vetëm Allahu e meriton. Ai nuk bëhet kurrë robi i dëshirave dhe kënaqësive të veta. Në këtë mënyrë, atij i shtohet respekti ndër njerëz dhe bëhet dikush që i dëgjohej fjala, i vlerësohet mendimi, i ngritur dhe i respektuar. Ky është edhe dallimi ndërmjet pretendimit për madhësi dhe të qenit njeri i madh.





Dashuria për Allahun

Prof. dr. Sulejman Derin

KALON NGA ROBËRIT E TIJ

Një besimtar gjithmonë duhet të ketë kujdes se me cilët njerëz shoqërohet e bën miqësi, në mënyrë që të arrijë përsosmërinë në besimin e tij. Të jetuarit bashkë me njerëzit dijetarë, të devotshëm e të urtë dhe marrja e së njëjtës frymë me ata, e lartëson përsheptjen e besimtarit. Për këtë arsye, besimtari që hyn në rrugën e përsheptjes, së pari duhet të dojë Zotin (xh.xh.), pastaj të Dashurin e Zotit (a.s.) dhe pastaj sahabët e të Dashurit të Zotit. Sipas Imam Rabbanit, dashuria për besimtarët e devotshëm, për të urtët dhe veçanërisht për besimtarët e varfër ndërmjet atyre është kapital i ahiretit për besimtarin. Imami, në një letër që ia ka shkruar një nxënësi të tij (vëll. I, letra e 74-t) thotë kështu:

“Letra juaj e vlefshme dhe fisnike ka arritur në dorën tonë. Nga përmbajtja e letrës kuptohet se ju i doni dhe jeni të interesuar për të varfrit dhe njerëzit e devotshëm. Kjo gjendje është kapital i lumturisë, sepse të devotshmit janë njerëz që gjithmonë i zbatojnë dispozitat e Allahut të Lartësuar. “(Të devotshmit) janë njerëz të atillë që edhe të tjerët nuk i lënë të bien në mëkate dhe në fatkeqësi kur rrinë bashkë me ta.” (Muslim, Dhikr, 8, nr: 1689.) I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë për të varfrit: “*Ka shumë njerëz me flokë të shkapërderdhura dhe të përzënë nga dyert, të cilët, nëse betohen në emrin e Allahut, Allahu nuk i nxjerr gënjeshtarë në betimin e tyre.*” (Buhari, Sulh, 8.)

Për këtë arsye, besimtari nuk duhet të përdorë masat e kësaj bote, por të botës tjetër në dashurinë e tij. Ai duhet t’i bëjë shokë ata që janë miq të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, edhe nëse janë të varfër dhe të dobët, sepse ai që e do atë që e do Allahun Teala, pas pak kohësh fillon ta dojë edhe Zotin e tij. Përkundër kësaj, ai që i do ata që nuk e duan Allahun dhe të Dërguarin e Tij, privohet nga dashuria hyjnore. I Dërguari i Allahut (a.s.), e shpjegon kështu në një hadith fisnik rrjedhën e kësaj gjendjeje shpirtërore ndërmjet njerëzve: “*Shoku i mirë dhe shoku i keq janë si ai që tregton erë të mirë dhe ai që i fryn shakullit. Ai që tregton erë të mirë mund të të japë prej saj ose mund të blesh prej tij ose mund të ndjesh aromën e këndshme. Ndërsa ai që i fryn shakullit ose mund të të djegë rrobat ose merr erën e keqe prej tij.*” (Muslim, Birr, 146.) Për këtë arsye, mistikët i kanë dhënë shumë rëndësi qëndrimit bashkë me të devotshmit dhe të sinqertët. Veçanërisht në ditët tona, me daljen në pah të miqësive artificiale me anë të shtypit dhe medias, shoqëritë e këqija kanë rrethuar çdo anë.

Imam Rabbani, krahas sugjerimit që të rrimë me njerëz të mirë dhe t’i duam ata, nuk heziton ta kundërshtojë edhe ekstremizmin e mistikëve në këtë çështje. Po, ne e duam të Dërguarin e Allahut (a.s.) dhe të gjithë dijetarët e të devotshmit që të çojnë te Allahu Teala, por kjo dashuri nuk mund të jetë e verbër dhe pa rregulla. Për fat të keq, edhe në ditët e sotme, atribuimi i fuqi-

ve përtej njerëzore ndaj disa udhëzuesve radikalë dhe shpirtërorë në dashuri, shembujt e këqij të së cilës po i hasim çdo ditë me shumicë, edhe në atë kohë ka qenë një problem për sufitë/mistikët. Veçanërisht, nëse këto lavdërime i bëhen vetë njeriut, atëherë, formohet një situatë edhe më e vështirë për ta parandaluar. Imam Rabbani e kritikon me një metodë mjaft domethënëse nxënësin e tij që e lavdëroi pa masë:

“O miku im i nderuar! Në letrën tuaj ka një shprehje të formës “dielli i dy botëve”. Kjo është një cilësi që i përket Allahut Teala, i Cili është vaxhibu'l-vuxhud. Andaj, si mundet një rob i dobët, i cili nuk ka fuqi për asgjë, të kërkojë ortakëri me Allahun Teala dhe të vrapojë në një rrugë të tillë? Si mund të ndodhë kjo veçanërisht në jetën e ahiretit, dija e së cilës i përket vetëm Allahut Teala, i Cili është sunduesi i ditës së fesë (ditës së gjykimit)?”

Sipas asaj që kuptohet nga këto fjalë, ajo që i ka hije robit është të qenët i vetëdijshëm për nënshtrimin ndaj Zotit (xh.sh.) dhe mosmashtimi nga komplimentet dhe lavdërimet e njerëzve. Përveç të tjerash, Imam Rabbani, gjendjen e vështirë me të cilën njerëzit do të përballen në ahiret dhe dobësinë e njerëzve kundrejt Zotit (xh.sh.), e shpreh kështu duke e përshkruar me ajetet e Kuranit Fisnik:

“Allahu i Lartësuar do të thotë kështu Ditën e Kia-metit: **“...Kujt i përket pushteti i kësaj dite...?”** Përsëri do të përgjigjet vetë duke thënë: **“...Allahut, të Vetmit, Ngadhënjimtarit!”** (Gafir, 16) Atë ditë nuk do të ketë gjë tjetër për robërit përveç frikës dhe shqetësimit.”

Sipas Imamit, edhe dashuria që shfaqet ndaj murshidit nuk duhet të jetë një dashuri e thatë. Dashuria e gjen vlerën e saj të vërtetë vetëm me bindje ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, sepse në të vërtetë, murshidi e ka marrë rrugën për ta çuar nxënësin e tij të këto dy burime. Për këtë arsye, Imami e këshillon nxënësin e tij, i cili shprehet se e donte Imamin, që ta pasojë të Dërguarin e Allahut (a.s.) dhe që dashuritë ndaj gjërave të kësaj bote të mos e pengojnë në lidhje me këtë çështje:

“Ti duhet ta pasosh të Dërguarin e Allahut (a.s.), sepse shpëtimi është i pamundur pa u pasuar ai. Ti nuk duhet t'u bësh komplimente stolive dhe joshjeve të kësaj bote dhe duhet të mos preokupohesh me ekzistencën apo mosekzistencën e tyre, sepse kjo botë ka tërhequr zemërimin e Allahut. Ajo nuk ka aspak vlerë te Allahu Teala. Mospreokupimi me këtë botë duhet të jetë më i mirë për robërit se preokupimi me të. Tradhtia e kësaj bote dhe e vërteta se si ajo të ikën nga duart me shpejtësi, dihet, madje edhe shikohet. Andaj merr mësim nga banorët e kësaj bote që kanë ardhur më parë dhe tashmë kanë vdekur!”

Imam Rabbani është kundër çdo lloj mëvetësimi që mund të bëhet ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.). Veçanërisht, nxjerrja e të Dërguarit të Allahut (a.s.), jashtë boshtit të besimit me qëllim për të fituar zemrat e njerëzve të tjerë, Allahu na ruajt, është një mëkat që

i shpie në kufër ata që e bëjnë. Imami e shpjegon me detaje këtë gjendje në letrën e 80-të të vëllimit të parë. Sipas Imamit, bindja dhe dashuria ndaj Allahut Teala nuk mund të realizohet pa bindjen dhe dashurinë ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.):

“Allahu Teala ka thënë: **“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut...”** (Nisa, 80) Atëherë, bindja ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), është bindje ndaj Allahut të Madhëruar. Ndërsa mosbindja ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), është mosbindje ndaj Allahut Teala. Për ata që pandehin se bindja ndaj Allahut Teala është ndryshe nga bindja ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), Allahu (xh.xh.), na ka lajmëruar se janë qafirë duke thënë: **“Vërtet, ata që mohojnë Allahun dhe të dërguarit e Tij dhe dëshirojnë të ndajnë Allahun nga të dërguarit e Tij, duke thënë: “Ne disa i besojmë e disa nuk i besojmë” dhe duke dashur që kështu të zgjedhin një rrugë të ndërmjetme, pikërisht ata janë mohuesit e vërtetë. Ne kemi përgatitur dënim poshtërues për mohuesit.”** (Nisa, 150-151)

Siç fillon dashuria ndaj Allahut Teala së pari duke dashur të Dërguarin e Allahut (a.s.), edhe dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), së pari fillon duke dashur shokët e tij. Sipas Imamit, dashuria dhe bindja ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), nuk mund të realizohet pa i dashur dhe pa i pasuar sahabët e tij:

“Nisur nga kjo, nëse i kthehemi sërish temës sonë, mund të themi se pohimi për pasim të të Dërguarit të Allahut (a.s.), pa pasuar rrugën e sahabëve të nderuar është një pohim i humbur, domethënë, i pavlerë. Ata që pohojnë se e duan të Dërguarin e Allahut (a.s.), duke mos i pasuar sahabët e tij, jo vetëm që nuk e pasojnë të Dërguarin e Allahut (a.s.), por janë edhe në kundërshtim të plotë me të. Si mund të jetë i mundur shpëtimi i atyre që ndjekin këtë rrugë të gabuar? Ajete i mëposhtëm e shpreh qartë gjendjen e njerëzve të tillë: **“Ata pandehin se janë në të drejtë, por dijeni se ata janë gënjeshtarë.”** (Muxhadele, 18)

Ai njeri që e do Allahun Teala, e do edhe të Dërguarin e Tij, edhe sahabët që e ndjekin rrugën e të Dërguarit (a.s.). Imami në shumë letra të tij i refuzon fuqishëm ata që i nënçmojnë sahabët, ndërkohë që pohojnë se e duan të Dërguarin e Allahut dhe Ehli Bejtin:

“Nënçmimi i sahabëve të nderuar me të vërtetë është nënçmimi i të Dërguarit të Allahut Teala (a.s.). Ai njeri që nuk i respekton sahabët, nuk i beson të Dërguarit të Allahut, sepse mendimi se ata kanë qenë të këqij, të çon te rezultati se edhe Pejgamberi (a.s.), ka qenë i keq. Andaj, i kërkojmë mbrojtje Allahut Teala që të mos biem në një besim të tillë të gabuar.

Shkrimin tonë le ta përfundojmë me këtë lutje të të Dërguarit të Allahut (a.s.): **“O Zot! Më bëj që të dua Ty, të dua ata që të duan Ty dhe të dua ata që më afrojnë te Ti!”** Amin!..

VENDOSMËRIA PËR T'U BËRË NJË UMET KRENAR

Idris Arpat

Allahu i Lartësuar thotë: **“...Në të vërtetë, krenaria është e Allahut, e të Dërguarit të Tij dhe e besimtarëve...”** (Munafikun, 8) Po, ky umet është një shoqëri e lartë që formohet nga robërit krenarë të Zotit krenar dhe është një umet krenar i një profeti krenar. Në një ajet tjetër fisnik, Allahu Teala e cilëson kështu këtë umet të nderuar: **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin...”** (Al' Imran, 110) Atëherë, ky umet asnjëherë nuk duhet të bjerë në poshtërim dhe gjithmonë duhet të dijë t'ia dalë mbanë për ta mbrojtur krenarinë e tij. Për t'ia dalë mbanë kësaj, së pari duhet të kërkojë përgjigje për pyetjen, **“Çfarë umeti është umeti krenar?”** – në vështrimin e Zotit (xh.xh.).

Kurani Fisnik në ajete të ndryshme na e shfaq kornizën se si duhet të jetë ky umet. Ja, në këtë shkrim do të përpiqemi të shpjegojmë anët kryesore të kësaj kornize.

Historia është si shtegu i umeteve. Krenaria për mbartjen e amanetit hyjnor shpesh herë ka ndërruar dorë dhe vendin e njerit e ka marrë tjetri. Ky ndryshim, siç ka shkaqet e tij të dukshme, ka edhe ato të padukshme. Ky ajet fisnik na tregon qartazi se sipas cilit ligj hyjnor realizohet kjo e fshehtë:

“O ju që keni besuar! Nëse ndokush prej jush braktis besimin e vet, dini se Allahu do të sjellë njerëz, që i do dhe që e duan; të përlurur me besimtarët dhe të ashpër me femohuesit; që luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi. Kjo është mirësia e Allahut, të cilën Ai ia jep kujt të dojë. Allahu është Bujar i madh dhe i Gjithëditur.” (Maide, 54)

Në këtë ajet fisnik bien në sy këto pesë cilësi të umetit

prej të cilit Allahu Teala është i kënaqur:

1. Ndërmjet Allahut dhe këtij umeti ka një marrëdhënie me në qendër dashurinë. Ky umet është një popull që e ka zemrën të përkushtuar ndaj Allahut Teala. Asnjë dashuri tjetër nuk mundet dot t'ia kalojë dashurisë së Allahut te ai. Një dashuri e tillë është e domosdoshme dhe primare për të përfaqësuar sundimin e Zotit (xh. xh.), në sipërfaqen e tokës, sepse, të bësh një punë në emër të Atij, t'i japësh përparësi vullnetit të Atij ndaj vullnetit personal dhe vullneteve të tjera, të bëhesh rob vetëm i Atij dhe t'ia dedikosh çdo gjë Atij sa herë që të jetë e nevojshme, mund të realizohet vetëm në sajë të një dashurie të atillë. Andaj, pa dashuri nuk mund të bëhemi umet krenar.

2. Njerëzit e këtij umeti janë të përlurur ndaj besimtarëve. Mendjemadhësia është një pengesë mjaft e madhe që qëndron si kala e pamposhtur në frenimin për t'u bërë umet. Siç nuk mund të zhvillohen ndjenjat e vëllazërisë nëpër shoqëritë që e përcmojnë njëra-tjetrën, gjithashtu ato nuk mund të miqësohen, të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe të bëhen si një ekip. Shoqëritë, të cilat formohen nga trupa që në zemrat e tyre nuk ka miqësi e dashamirësi për të tjerët, nuk mund të quhen as xhemat dhe as umet. Si mund të bëhet një umet krenar me grupet e njerëzve që formohen nga individë që nuk e respektojnë dhe nuk kanë konsideratë për njëri-tjetrin?!

3. Njerëzit e këtij umeti dinë të qëndrojnë denjësisht, fuqishëm dhe ndershmërisht ndaj femohuesve që nuk e pranojnë Zotin dhe të vërtetën. Asnjëherë nuk do të dalë një umet krenar nga ata që pothuajse e pranojnë



poshtërimin për shkak të interesave të ndryshme të kësaj bote dhe bëjnë miqësi me qafirët. Ata që përpiqen ta fitojnë krenarinë jo duke qëndruar në anën e Zotit (xh.xh.) dhe të vërtetës, por në anën e qafirëve dhe duke u përpjekur që t'u duken sa më mahnitës atyre, asnjëherë nuk do ta shijojnë krenarinë. Kjo është njëra prej humbjeve më të mëdha, në të cilën ka rënë sot umeti islam. Nga ana tjetër, edhe shoqëritë që nuk synojnë të bëhen të fuqishme nga çdo aspekt dhe fushë, do të poshtërohen kundrejt të fuqishmëve. Nisur nga kjo, umeti islam asnjëherë nuk duhet ta neglizhojë të qenët i fuqishëm nga aspekti ushtarak, ekonomik, shkencor dhe politik.

4. Ata nuk hezitojnë asnjëherë për të luftuar në rrugë të Allahut, por e kryejnë këtë obligim duke flijuar pasurinë e jetën e tyre. Gjithashtu, asnjëherë nuk bien në plogështi dhe nuk reshtin së flijuari për këtë çështje. Sepse populli që e lë xhihadin (luftën në rrugën e Allahut), e meriton poshtërimin. Xhihad është emri i përbashkët i çdo lloj përpjekjeje, mundimi dhe veprimit që bëhet për ta lartësuar emrin e Allahut dhe për ta bërë sundues ligjin e Tij në sipërfaqen e kësaj bote. Mirësia dhe epërsia është e drejtë jo e atyre që rrinë këmbëkryq, por e atyre që përpiqen dhe mundohen. Ata që janë robër të interesave dhe të të ardhurave të kësaj bote, sigurisht se nuk mund të marrin pjesë nga gjërat sublime. Xhihadi është cilësi e rixhalëve, domethënë, e burrave. Popujt që nuk kanë rixhal, detyrimisht poshtërohen nga popujt e tjerë.

5. Ata nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi në rrugën e Zotit (xh.xh) dhe të vërtetës. Ai që nuk i beson kauzës së vet, nuk mund të ketë besim te vetja e tij. Ndërsa ata që nuk kanë besim në veten e tyre, nuk mund të bëjnë vepra proaktive, domethënë, vepra me në qendër vlerat. Njerëzit e tillë shtypen, nënshtrohen dhe e ulin kokën nga ndikimi i presionit që mund t'u bëhet. Andaj, krenaria nuk mund të fitohet me këndvështrimin "çfarë do të thonë të tjerët". Përkundrazi, respektin dhe krenarinë e fitojnë vetëm ata që thonë: "Ajo që duhet të bëhet është ajo që kërkon Zoti (xh. xh.) dhe e vërteta."

Umeti më i mirë është umeti mesatar. Domethënë, jo një umet në të cilin përfaqësohet radikalizmi, por në të cilin përfaqësohet mesatarja, ekuilibri dhe drejtësia. Në ajetin fisnik thuhet kështu për këtë cilësi të umetit krenar:

"Kështu, Ne ju kemi bërë një umet të mesëm, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju..." (Bakara, 143)

Ifrati dhe tefriti janë pengesa të mëdha për t'u bërë

një umet prijës dhe lider. Nëse dëshirojmë të bëhemi prej atyre që njerëzit i shikojnë dhe ne u caktojmë drejtimin, patjetër duhet të kemi një masë ekuilibruese. Kjo, në një aspekt, do të thotë që të bëhemi përfaqësues të drejtësisë. Një umet që nuk hesht ndaj padrejtësisë së të padrejtës dhe që nuk rri indiferent ndaj rënkimit të të dhunuarit, herët apo vonë do të fitojë krenari në ekuilibrat ndërkombëtarë dhe do të lartësohet në një pozitë që e respektojnë të gjithë popujt. Mbrojtja e njerëzisë arrihet vetëm në sajë të një umeti të tillë, pra, krenar dhe të denjë.

Umeti krenar është një umet që ia del mbanë për të vepruar me një mendje të përbashkët, sepse Allahu i Lartësuar tregon një cilësi jetike të këtij umeti kur shprehet në ajetin fisnik: **"...Ata konsultohen ndërmjet tyre për punët e veta..."** (Shura, 38) Nëse umeti islam dëshiron të arrijë krenarinë, është i detyruar të formojë "Qendrën e Konsultimit të Umetit". Një këshill konsultimi që do të lindë nga bashkimi i dijetarëve dhe liderëve, do të marrë vendime që u hapin rrugë zgjidhjeve të problemeve të umetit dhe do të ndërtojë përsëri krenarinë dhe dinjitetin e umetit islam.

Umeti krenar dhe më i mirë nuk është një umet që merret vetëm me hallin e tij, por është një umet që merr mbi supë përgjegjësinë e nxjerrjes së të gjithë njerëzisë nga errësira në dritë. Qëllimi i ekzistencës së këtij umeti nuk mund të jetë vetëm shpëtimi i vetes së tij. Allahu Teala thotë në ajetin fisnik:

"Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun..." (Al' Imran, 110)

Umeti më i mirë e arrin këtë cilësi sublime duke thirrur në mirësi. Një umet i tillë është i obliguar të sigurojë mirëqenien e kësaj bote. Ndalimi i krimeve dhe tiranive, zhdukja e të këqijave dhe ligësive, mbrojtja e mirësive dhe virtyteve është një detyrë hyjnore që i është dhënë umetit më të mirë.

Nëse sot individët e umetit islam nuk përpiqen në rrugën për ta fituar krenarinë dhe dinjitetin që e presin nga Allahu i Madhëruar dhe e privojnë veten duke rënë në neglizhencë dhe në mjerimin e sëmundjen e dembelizmit, duhet ta dinë se në vend të tyre mund të vijë një umet tjetër më i mirë dhe krenar. Ajo që duhet të bëjmë është: T'i drejtohem pendimit të gjithë së bashku, ta nisim rrugën me vendosmëri duke thënë "Bismi'l-lahi'rr-Rrahmani'rr-Rrahim" në përpjekjen për t'u bërë përsëri një umet i madh e krenar dhe t'i mbështetemi Allahut Teala. Ai që e jep rezultatin është Allahu i Lartësuar.





Të jesh pjesëtar i umetit të të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili u dërgua si profet për të gjithë njerëzit me cilësitë: “Udhërrëfyes për në besim”, “Mëshirë për botët”, “Zotërues i një morali të lartë” dhe “Shembulli më i mirë”, padyshim se është mirësia dhe lumturia më e madhe.

Ku je, **o umeti i Muhamedit?**

— *Mehmet Dinç* —

Umeti është një strukturë sociale e mbështetur në lidhjen e besimit ndërmjet vëllezërve të fesë që ndërtohet me në qendër peygamberin. Umeti i Muhamedit është një koncept i gjerë me dy faza, që në veçanti shpreh shoqërinë njerëzore që i ka besuar të Dërguarit të Allahut (a.s.), pra, “Ummeti Ixhabet” dhe në përgjithësi shpreh shoqërinë njerëzore të cilës i drejtohet predikimi Islam, pra, “Ummeti Davet”. Ne, kur themi umet apo umeti i Muhamedit synojmë “umeti ixhabetin”, domethënë, myslimanët. Menjëherë le ta shpjegojmë se në këtë kuptim umeti i Muhamedit është një strukturë sociale dhe një realitet i formuar me traditën e Profetit Muhamed (a.s.).

Siç shprehet edhe në Kuranin Fisnik, edhe grupeve e shoqërive që kanë cilësi të caktuara dhe që zbatojnë urdhra e detyra të caktuara, u thuhet umet. Allahu Teala thotë: **“Le të dalë prej jush një umet (grup) që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.”** (Al Imran, 104) Edhe për umetin e Muhamedit (duke përfshirë umeti ixhabetin) ndërmjet umeteve të lidhura ndaj të vërtetave të njëjta, përdoret i njëjti term: **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun. Sikur ithtarët e Librit të besonin, do të ishte më mirë për ata; ka prej tyre besimtarë**

të vërtetë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë.” (Al Imran, 110)

Nisur nga këto që thamë më lart, Umeti i Muhamedit;

1. Mbart si medalje nderi ajetin fisnik: **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin...”** (Al Imran, 110)

2. Është një umet që cilësia e tij themelore shprehet në ajetin fisnik: **“Ju ju kemi bërë një umet mesatar.”** (Bekare, 143)

3. Është një umet i ftuar nga ana e Hz. Ibrahimit dhe birit të tij, Ismailit (a.s.), nëpërmjet lutjes së tyre: **“O Zoti ynë! Na bëj të përlulur ndaj Teje! Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë të përlulur ndaj Teje! Tregona ritet e Haxhit dhe pranoje pendimin tonë, se, pa dyshim, Ti je Pranuesi i pendimit, Mëshirëploti!”** (Bekare, 128)

Të jesh pjesëtar i një umeti të tillë, domethënë, të jesh prej umetit të Muhamedit (a.s.), siç shprehet edhe i ndjeri Sulejman Çelebiu, sigurisht se është një “mirësi”. Kur Sulejman Çelebiu feston miraxhin e të Dërguarit të Allahut, alejhi’s-salam, në Mevludin e tij, tregon se sahabët e nderuar kanë thënë:

“Neve na mjafton të qenët umeti yt.

Neve na mjafton shërbimi që të bëjmë ty.”

Të jesh pjesëtar i umetit të të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili u dërgua si profet për të gjithë njerëzit me cilësitë: “Udhërrëfyes për në besim”, “Mëshirë për botët”, “Zotërues i një morali të lartë” dhe “Shembulli më i mirë”, pa dyshim se është mirësia dhe lumturia më e madhe.

UMETI MERHUME

Krahas cilësive të larta të umetit të Muhamedit që u shprehën në ajetin fisnik të mësipërm, gjendet edhe një cilësi e umetit që e mësojmë nga i Dërguari i Allahut (a.s.), e cila është: Umeti Merhume... Që do të thotë, umeti që ka fituar mirësinë, nderimin dhe begatinë hyjnore... I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, në një hadith fisnik që mbështetet te Ebu Musa el-Esh’ariu, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, thotë: “Me të vërtetë, ky umeti im është umeti merhume. Ai

nuk do të ndëshkohet në Ahiret. Ndëshkimi i tij është në këtë botë.” Pastaj tregon se ndëshkimi i këtij umeti në këtë botë do të jetë “me duart e tyre”, “ndërmjet tyre”, “përçarjet”, “tërmetet” dhe “vrasjet”. (Shik. Ebu Davud, Fiten 7; Ibn Maxhe, Zuhd 34; Ahmed ibn Hanbel, Musned, IV, 408, 410, 418.)

Hadithi fisnik e vlerëson umetin e mirë si “një umet i tërë” brenda kornizës së umeteve. Prandaj ky hadith nuk duhet të kuptohet sikur asnjëherë nuk do të ndëshkohet ai që e ka merituar dhe që nuk është falur. Qëllimi i hadithit është ky: Në Ahiret umetet para nesh do të trajtohen sipas parimit të ndëshkimit në përputhje me mëkatin. Ndërsa umeti ynë do të trajtohet sipas parimit të mëshirës, faljes, mirësisë dhe dhembshurisë. Domethënë, Allahu Teala umetet e mëparshme do t’i trajtojë me drejtësinë e Tij, ndërsa këtë umet do ta trajtojë me mëshirën e Tij.

Pa dyshim se myslimanët duhet të jenë të ditur dhe të zgjuar për obligimet që lindin nga të qenët umet dhe duhet të jenë mjaft të kujdesshëm e të përpiqen pareshtur për t’i kryer përgjegjësitë e tyre kundrejt këtij sihariqi dhe veçanërisht kundrejt deklaramit e paralajmërimit se “ndëshkimi i atyre në këtë botë do të jenë përçarjet, tërmetet dhe vrasjet”. Përndryshe, gjendja e turpshme për të cilën flet i ndjeri Mehmet Akif Ersoji: “Ki turp o umeti merhume, ki turp nga ky emër që ke!” – do të jetë e pashmangshme.

Në të kaluarën, kur shfaqej ndonjë rrezik apo bëhej fjalë për ndonjë ngjarje negative, populli ynë kërkonte ndihmë duke thirrur me të madhe: “Ku je, o umeti i Muhamedit!” “A ka ndonjë nga umeti i Muhamedit që mund të na ndihmojë?” Populli ynë asnjëherë nuk thërriste në emër të familjes apo prejardhjes së tij dhe asnjëherë nuk nxirrte përpara ndonjë klasë sociale. Ky edukim kaq domethënës, kaq gjithpërfshirës dhe kaq reflektues më mirë kuptohet sot, ngaqë marrëdhëniet e pandjeshme dhe të dobëta me fqinjët dhe fanatizmi i papërbalueshëm i grupacioneve kanë thurur mure ndërmjet njerëzve. Ekzistenca e të njëjtës gjendje edhe në marrëdhëniet ndërmjet popujve myslimanë dhe e vërteta se ata presin zgjidhje, mëshirë dhe ndihmë nga armiqtë e përbashkët të tyre, është burim i një dhimbjeje dhe vuajtjeje të thellë.



Përse fëmijët e parë JANË MË TË NDJESHËM?

M. Emin Karabaxhak



Nënat dhe baballarët në përgjithësi ankohen se fëmijët e tyre të parë janë më të mbyllur në vetvete në krahasim me fëmijët e tjerë dhe se ata nuk mund të shprehen aq shumë sa fëmijët pas tyre. Prindërit, të cilët nuk janë të kënaqur me gjendjen e fëmijëve të tyre, dëshirojnë të kenë një fëmijë që i kupton ata ende pa folur, një fëmijë që nuk është i mërzitshëm, që mund ta shpjegojë shqetësimin e tij dhe më kryesorja, një fëmijë që mund ta shprehë veten e tij. Fëmijët e parë janë më të ndjeshëm dhe më të turpshëm në krahasim me fëmijët e tjerë që mund të vijnë pas tyre. Edhe në lojë dhe karakter janë të ndryshëm nga vëllezërit dhe motrat e tyre. Fëmijët e tjerë në krahasim me fëmijët e parë janë më aktivë dhe përshtaten më shumë me mjedisin që i rrethon. Përveç të tjerash, më shumë se të ndjeshëm, ata janë më racionalistë, i besojnë vetes aq sa të përballen me rrezikun dhe përshtaten shpejt me mjedisin e shoqërisë.

Prindërit që shprehin shqetësimet në lidhje me fëmijët e parë i ftoj që të mendojnë rreth periudhave të shtatzënisë dhe metodës që i kanë rritur fëmijët. Sapo jeni martuar dhe akoma pa e kuptuar se çfarë është martesë vini re se njerëzit që ju rrethojnë presin një fëmijë prej jush. Pastaj filloni të shikoni se ata presin fëmijë prej jush në emër të lajmit të mirë dhe se kur vonohet ky lajm i mirë, bëhet shkak për komente të ndryshme. Këto shpresa apo pritje, dashje apo pa dashje ndikojnë negativisht te ju. Ju keni shkuar si nuse në një mjedis të ri. Ndërkohë që përpiqeni të përshtateni me njerëzit dhe mjedisin, papritur vini re se keni ngelur shtatzënë. Krahas përshtatjes me mjedisin social, për herë të parë po përjetoni edhe periudhën e shtatzënisë. Krahas vështirësisë së shtatzënisë, presioni psikologjik nën emrin e këshillës, sugjerimit, shqetësimit dhe ankesës që fillon me: “Kur ishim shtatzënë në kohën tonë...” – ndikon negativisht në gjendjen shpirtërore të kandidatës për nënë. Krahas këtyre, vetmia dhe ndjeshmëria psikologjike e kandidatës për nënë, pritjet në lidhje me gjininë e fëmijës, mendimet e tilla: “A do të bëhem dot një nënë e mirë për fëmijën tim dhe a do të përkuqdesem dot mirë për të?” – e fusin atë në stres. Këto lloje shqetësimesh që janë rezultat i atyre që thamë më sipër, dashje apo pa dashje, ndikojnë te fëmija në bark aq sa ndikojnë edhe te nëna. Në lidhje me këtë, nënës i bëj veçanërisht

këtë pyetje: “A është e njëjtë periudha e shtatzënisë së fëmijës së parë me periudhat e shtatzënisë së fëmijëve të tjerë?” Përgjigja e nënës në përgjithësi është kjo: “Atë kohë kam qenë pa përvojë dhe nuk kam ditur shumë gjëra.”

Sidoqoftë vazhdojmë të mendojmë. Ndërkohë që fëmija lindi dhe ju përpiqeni për ta rritur atë, fillojnë ndërhyrjet edhe nga njerëzit rreth e rrotull. Krahas shqetësimeve dhe informacionit të paktë në çështjen e rritjes dhe edukimit të fëmijës që keni, vini re se nuk jeni vetëm në edukimin e fëmijës dhe se nuk mund ta rrisni atë sipas dëshirave tuaja pa ndërhyrë te fëmija edhe të mëdhenjtë e shtëpisë. Për shkak të këtyre, në emër të të qenit një nënë sa më e mirë, filloni të interesoheni më shumë seç duhet për fëmijën. Pra, ia jepni ushqimin para se ai të ketë uri, e vishni shumë trashë që të mos ftohet, nuk i jepni leje të vrapojë, duke u shqetësuar se mund të rrëzohet dhe e mbushni me lodra ngaqë nuk ka vëlla, motër apo shok për të luajtur. Shkurtimisht, gjërat që duhet t'i bëjë fëmija, fillon t'i bëjë nëna.

Prindërit i pyes: “A i keni rritur vallë edhe fëmijët e tjerë me këtë mjedis dhe psikologji?” Përgjigja që marr është kjo: “Jo, për fëmijët pasardhës nuk kanë ndërhyrë të tjerët. Mbi të gjitha, edhe unë kam pasur përvojë.”

Fëmijëve që rriten pa vëllezër, motra dhe shokë nuk u jepet mundësia ta përjetojnë sa më shumë fëmijërinë e tyre. Normalisht, ndërkohë që fëmijët mësojnë me anë të lojës, me anë të provës dhe të gabuarit dhe në një ambient me shokë e shoqe, shumica e prindërve i privojnë fëmijët e tyre të parë nga kjo mundësi.

Prindërit e këtyre fëmijëve, të cilët mësojnë me anë të lojës dhe duke u argëtuar bashkë me fëmijët e tjerë, nuk u japin leje fëmijëve që të bashkohen me grupin e fëmijëve të tjerë, ngaqë janë të dhënë më shumë se ç'duhet pas tyre. Po, edukimi i këtyre fëmijëve që nuk gjejnë dot moshatarë për të luajtur me ta, fiton një dimension shumë të ndryshëm kur në këtë punë ndërhyjnë edhe gjyshja me gjyshin. Për këtë arsye, këta fëmijë në shumicën e rasteve shfaqin sjellje kontradiktore.

Një fëmijë që nuk i jepet leje për të dalë jashtë dhe që nuk gjen ndonjë moshatar për të luajtur me të, më së shumti mbytet te lodrat që ia blen familja. Fëmijët që lozin vetëm me lodrat e tyre, në të ardhmen përjetojnë vështirësi në të shprehurit e vetes dhe në fitimin e besimit ndaj vetes së tyre. Këtyre fëmijëve, të cilët rriten pa iu dhënë leje për t'iu bashkangjitur shumë mjedisëve me fëmijë të tjerë dhe pa vëllezër e motra, u blihet çdo gjë që dëshirojnë, ngaqë janë fëmijët e parë dhe që të mos mërziten.

Në përpiqemi të jemi prindër të shkëlqyer, duke i bërë në emër të fëmijës aktivitetet që duhet t'i bëjë vetë fëmija, si të shprehurit e vetes, përdorimi i

aftësive dhe marrja e përgjegjësisë. Domethënë, e sjellim fëmijën në një gjendje saqë të gjitha punët e tij i bëjmë ne. Pastaj kur të rritet, themi: “Përse është bërë kështu ky fëmijë?” Në këtë situatë, prindërit nuk ia kanë idenë se po u bëjnë keq fëmijëve të tyre ndërkohë që mundohen t'u bëjnë mirë. Për këtë arsye, është e kotë që të presësh një sjellje si “të bëjnë detyrat apo të mësojnë mësimet” nga këta fëmijë që e presin çdo gjë nga prindërit e tyre. Ndërsa anët që duken pozitive te këta fëmijë janë këto: Ata janë më të pjekur, më seriozë dhe më të heshtur se moshatarët e tyre. Nëse kjo gjendje e fëmijës i kalon përgjegjësitë që ai duhet të marrë përsipër, është e dëmshme, sepse çdo fëmijë duhet të sillet dhe të veprojë në përputhshmëri me moshën dhe strukturën e personalitetit që ka.

ÇFARË DUHET TË BËHET PËR FËMIJËT E PARË?

1. Fëmijëve të parë duhet t'u krijohet mundësia për të luajtur me moshatarët e tyre dhe duhet të inkurajohen në këtë çështje.

2. Prindërit nuk duhet të presin prej fëmijëve gjëra që janë të pamundura për moshën dhe aftësitë e atyre. Përkundrazi, fëmijëve duhet t'u japin përgjegjësi në përputhje me moshën e tyre. Prandaj, prindërit nuk duhet të presin prej fëmijëve pjekuri më të madhe se moshja e tyre duke u thënë: “Ti je motra e madhe apo ti je vëllai i madh.”

3. Kur fëmijët të shfaqin sjellje pozitive në përputhje me moshën dhe aftësitë e tyre, duhet t'i ndihmojmë ata që t'i përforcojnë edhe më shumë ato sjellje.

4. Ne duhet t'ua mundësojmë që t'i mendojnë vetë punët dhe nuk duhet t'i bëjmë ato punë në emër të tyre.

5. Ne duhet t'ua mundësojmë fëmijëve që ta shprehin veten e tyre. Për këtë arsye, atyre nuk duhet t'u japim ndonjë gjë pa e kërkuar dhe duhet t'i presim derisa t'i plotësojnë fjalitë.

6. Gabimet e fëmijëve nuk duhet t'i ekzagjerojmë duke marrë parasysh se fëmijët mund të gabojnë.

Nisur nga këto që thamë më lart, fëmijëve duhet t'u jepen përgjegjësi, në mënyrë që ta zhvillojnë besimin ndaj vetes. Ndërsa për përgjegjësitë që i kryejnë me sukses, prindërit duhet të shfaqin reagime inkurajuese. Ata fëmijë, të cilëve u rrihet gati në çdo aspekt, do të përjetojnë probleme në çështjen e marrjes përsipër të përgjegjësive. Te fëmijët që lozin me prindërit apo me lodrat e tyre në shtëpi në vend të mjedisit me bashkëmoshatarët, do të ketë ndryshime nga aspekti i socializimit prej fëmijëve që lozin me bashkëmoshatarët. Fëmijët që i formojnë sjelljet e tyre në ambient normal jo me metodën e provës dhe gabimit, por me këshillat dhe sugjerimet e prindërve, do të mendojnë si fëmijët më të rritur në moshë, por kurrë nuk do të sillen si moshatarët e tyre.

KUJDES NGA RËNKIMI I ATIJ QË I ËSHTË BËRË PADREJTËSI

Dr. Durak Puzmaz

Ngjarjet e kohëve të fundit tregojnë se bota islame po vuan edhe më shumë se më parë. Tashmë thuajse në të gjitha trevat islame kjo gjendje alarmante ka arritur përmasat marramendëse, megjithatë ka mbretëruar një heshtje absolute acaruese ose disa institucione ndërkombëtare që pretendojnë të shërbejnë në emër të humanizmit duket qartë se mbajnë qëndrim pro mizorëve. Pamjet e dhunës që shkatërrojnë zemrën e çdo njeriu, të shfaqura në media dhe në instrumente të tjera komunikimi masiv, shpeshherë s'të lënë fjalë për të thënë. Ekziston një aprovim i heshtur i të gjithëve që tashmë kemi mbërritur në një pikë ku mbaron fjala. Shkurtimisht, në një kuptim të përgjithshëm, kohët të vështira për myslimanët nuk kanë reshtur kurrë.

Allahu i Madhëruar përmes pejgamberëve ka përmirësuar aktualitetet e kohëve të vështira që ka pasur njerëzimi dhe i ka drejtuar ata drejt horizonteve të reja. Vështirësitë e aktualitetit tonë sërish mund të zgjidhen përmes së njëjtës metodë. Meqë pas Pejgamberit (a.s.), nuk do të vijë ndonjë tjetër pejgamber, atëherë udhëzimin e Pejgamberit tonë (a.s.), ta bartim në aktualitetin tonë përmes udhëzimit dhe orientimit që ai bën përtej kohës. Me siguri kjo është si domosdoshmëri paraprake e të qenit **“i Dërguari i ymetit”**.

Ashtu siç dihet, Pejgamberi ynë (a.s.), kur po udhëzonte njerëzimin dhe ymetin, ka përdorur metodën e motivimit (tergib) dhe të qortimit/paralajmërimit (terhib). Përgjithësisht ka qenë e tillë radhitja e përdorimit të metodave, por ndonjëherë mundet të ketë fituar epërsi qortimi ndaj motivimit.

Duke u nisur nga kjo ide, kemi planifikuar të ndajmë me ju një buqetë me hadithe që përfshijnë qortimet “Kujdes/Ruajuni!” të Resulullahut (a.s.), nën titullin e përgjithshëm “Qortimet nga Njeriu Shembullor – i Dërguari i fundit”. Këshillën dhe qortimin e tij: “Kujdes nga rënkimi i atij që i është bërë padrejtësi”, e zgjodhëm si temë të parë të kësaj serie si diçka të rëndësishme, shumë të rëndësishme e thënë kundrejt shtypësve të të drejtave dhe atyre që i mbështesin ata, atyre që pëlqejnë në mënyrë të fshehtë apo të hapur cenimin e së drejtës së tjetrit.

Rivajeti i hadithit, i cili përbën thelbin e temës sonë, është në këtë mënyrë:

Sipas asaj çfarë transmetohet nga Abdullah ibn Abasi (r.a.), Pejgamberi (a.s.) kishte emëruar (si vali), Muadh-in (Ibn Xhebel), në Jemen. (Sipas udhëzimit që i kishte dhënë, në fund) thoshte kështu:

- (O Muadh!) Kujdes nga mallkimi i atij që i është bërë padrejtësi! Pasi mes rënkimit të atij që i është shtypur e drejta dhe pranimit të atij mallkimi nga Allahu nuk ka asnjë pengesë.¹

Fjalja e fundit është transmetuar edhe si “nuk ka asnjë pengesë mes atij që i është bërë padrejtësi dhe Allahut (pranimit të asaj duaje)².

Tirmidhiu, në fund të transmetimit, pasi ka thënë: “lidhur me këtë çështje ekzistojnë edhe transmetime të Enesit, Ebu Hurejres, Abdullah bin Omerit, Ebu Saidit”, përcakton gjithashtu se hadithi është “hasen”³.

Thuajse në të gjithë transmetimet e hadithit, është mjaft interesant fakti që koha kur është bërë kjo vërejtje është viti i nëntë i hixhretit, atëherë kur Pejgamberi (a.s.) Muadh bin Xhebelin e emëron vali në zonën Xhened të Jemenit, pasi e kishte këshilluar që kur të mblidhte zekatin, në mesin e mallrave që do mblidhte si zekat, të mblidhte ato të mesmet dhe pastaj i kishte tërhequr vëmendjen përmes këtij paralajmërimi që cituam më lart. Kësisoj, në çfarëdo lloji situatë dhe rrethana që të jetë njeriu, keqpërdorimi i pushtetit të shtetit konsiderohet zullum, padrejtësi, shtypje e të drejtave të tjetrit.

Udhëzimi “*kujdes nga rënkimi i atij që i është bërë padrejtësi*” në fakt është në kuptimin “kujdes se mos të bësh padrejtësi”. Pasi, rënkimi i atij që i është bërë padrejtësi, është një përfundim i çfarëdo lloji padrejtësie që atij i bëhet. Por, mallkimi që bëhet pa i ushtruar njeri padrejtësi, nuk konsiderohet “rënkimi i atij që i është cenuar e drejta”.

Padrejtësia për të cilën bën fjalë hadithi është padrejtësi materiale. Edhe shprehja e Pejgamberit (a.s.), “Matlu’l-ganijji dhulmun = Ai që ka mundësi dhe që e vonon huanë bën zullum”⁴, në marrëdhëniet ekonomike përbën një konstatim dhe kërcënim mjaft me rëndësi.

Kuptohet qartë se mallkimi i atij që i është cenuar e drejta, në çfarëdo lloji situatë le të jetë padrejtësia/zullumi i bërë, nuk përbën ndonjë pengesë mes atij dhe Allahut. Atëherë, paralajmërimi kryesor këtu është që të përqendrohemi në pikën e asaj që të mos i japim shkas një situatë të tillë, pra të mos shtypim të drejtat e tjetrit.

Në një tjetër hadith të Pejgamberit (a.s.), masën që ndërmerret në Ahiret e shpjegon në këtë mënyrë: “*Kini kujdes se mos cenoni të drejtën e ndonjërit. Pasi padrejtësia shndërrohet në errësirë në Ditën e Kiametit.*”⁵

Në fakt nuk ka njeri me mend në kokë që ta dëshirojë që, brenda tmerrit që e karakterizon vetë Ditën e Kiametit, të rrish edhe në errësirën e krijuar në sajë të padrejtësive që ke bërë kur ishe në botë. Zgjidhja e kësaj është: përpjekja për të qëndruar larg çdo lloji padrejtësie të mundshme ndaj tjetrit.

TRE DIMENSIONET E PADREJTËSISË

Dijetarët myslimanë, të cilët janë përpjekur të bëjnë shpjegime lidhur me këtë temë, padrejtësinë e ndajnë në tri pjesë të ndryshme:

1. Padrejtësia mes njeriut dhe Allahut: shirku, kufri, nifaku dhe isjani.

2. Padrejtësia mes njerëzve: padrejtësia, vrasja, shpifja dhe gjynahe të ngjashme.

3. Padrejtësia mes njeriut dhe vetes së vet: padrejtësia që njeriu i bën vetvetes duke mos kryer detyrat ndaj Allahut dhe duke u bërë padrejtësi të tjerëve.

Çdo gjynah është një padrejtësi e bërë ose ndaj vetes ose ndaj tjetrit. Padrejtësia që i bëhet tjetrit në fakt është një padrejtësi që njeriu bën njëkohësisht edhe kundër vetes së vet. Ai do të japë llogari për të dhe do të ndëshkohet.

PADREJTËSIA ËSHTË PRODUKT I PAAFTËSISË

Të paaftit dhunojnë. Ndonjëherë padrejtësia forcohet dhe përhapet në mënyrë marramendëse. Mirëpo, mund të zhduket po ashtu papritur dhe pamenduar.

Kurrë nuk do të mbetet pa përgjigje padrejtësia dhe zullumi i ushtruar kohëve të fundit kundrejt gjithë popujve myslimanë. Pasi mes duave – dëshirave të të shtypurve dhe Allahut nuk ekziston perde. Rënkimet e tyre mbërrijnë direkt tek Allahu. Kurse Allahu i Madhëruar mundet që ta shtyjë (ta vonojë) dënimin që do u bëjë dhunuesve.

Në një hadith kudsit thuhet kështu:

“O njerëzit e mi! Unë ia kam ndaluar vetes padrejtësinë. Ashtu sikundër kam ndaluar edhe për ju bërjen e padrejtësisë ndaj njëri – tjetrit. Kësisoj, mos i bëni padrejtësi njëri – tjetrit.”⁶

Në një ajet kuranor thuhet: “**...Mallkimi i Allahut goftë mbi të padrejtët!**” Kjo do të thotë që Allahu i Madhëruar do t’i mbajë larg mëshirës së Vet ata që bëjnë padrejtësi. Të qenit larg mëshirës së Tij është

dënimi më i madh dhe më i rëndë që mund t'i jepet një njeriu.

Në një hadith thuhet kështu: *“Mallkimi i atij që i është cenuar e drejta do të marrë përgjigje medoemos.”*⁸ Nuk duhet harruar që një nga çështjet për të cilën Pejgamberi (a.s.), ka kërkuar mbrojtjen e Allahut është *“rënkimi/mallkimi i atij që i është cenuar e drejta.”*⁹

Ekzistojnë edhe dy transmetime që sqarojnë më tutje këtë postulat të dalë nga hadithi i lartcituar, të cilët tregojnë se për t'u pranuar shqetësimi i tyre mjafton që ata të jenë vërtet të shtypurit.¹⁰ Që do të thotë se, edhe nëse është gjynahqar apo afetar ai që ndaj tij është bërë padrejtësi, nuk ndikon aspak në pranimin e rënkimit/mallkimit të tij:

“Mallkimi i atij, kundrejt të cilit është bërë padrejtësi, qoftë ai edhe gjynahqar, do të pranohet. Të qenit gjynahqar është për veten e vet.”

“Mallkimi i atij, kundrejt të cilit është bërë padrejtësi, qoftë ai edhe gjynahqar, do të pranohet. Pasi mes atij që i është bërë padrejtësi dhe realizimit të duasë së tij nuk ekziston asnjë lloj pengese.”

Në fakt padrejtësia që i bëhet tjetrit është një faj. Kundrejt kujt do që të bëhet një gjë e tillë, ajo asnjëherë nuk është legjitime nga aspekti islam. Ndaj dhe është thënë: *“Nuk është e lejuar padrejtësia ndaj tjetrit, qoftë edhe ndaj femohuesit.”*¹¹

TRI DUATË E PRANUARA

Ndërkohë, ekzistojnë tri kategori lutjesh – mallkimesh që pranohen:

*“Ekzistojnë tri dua që me patjetër do të pranohen: dua e atij që i është bërë padrejtësi; dua e mysafirit dhe dua e prindërve për fëmijën.”*¹²

Ata që bëjnë mallkime, ndërkohë që nuk janë pjesë e njëres prej këtyre tri kategorive, dëmin ia bëjnë më shumë vetes sesa tjetrit. Është një fakt që Pejgamberi (a.s.), ka mallkuar mushrikët mekas, të cilët u bënë shkak që, gjatë betejës së Hendekut, myslimanët të linin për kaza namazin e ikindisë: *“Allahu i mbushtë me zjarr shtëpitë dhe varret e tyre! Na penguan që të falnim namazin e ikindisë derisa të perëndonte dielli.”*¹³

Po ashtu, dihet se Pejgamberi (a.s.), ka mallkuar parinë e mushrikëve, si Sefvan b. Umejjen, Suhejl b. Amrin dhe Haris bin Hishamin, duke u përmendur emrat, si dhe për një muaj rresht ka mallkuar fiset Ri'l, Zekvan dhe Usajj, duke kënduar kunutin pas ruku-së së rekatit të dytë të namazit të sabahut, pasi u kishin përgatitur kurth dhe i kishin vrarë thirrësit islamë në Bi'r-i meune. Pastaj, nëpërmjet ajetit **“Ti nuk ke asgjë në dorë, nëse do t'ua pranojë Ai pendimin apo do t'i dënojë, se ata janë vërtet keqbërës.”**¹⁴, është ndaluar një praktikë e tillë.

Këtu, Allahu i Madhëruar bën të ditur që dënimi apo shpërblimi i njerëzve është tërësisht në dorën e Tij. Gjithashtu në këtë ajet duket qartë tërheqja e vërejtjes edhe ndaj Pejgamberit (a.s.), lidhur me këmbënguljen e tij përmes mallkimeve për t'i ndëshkuar Zoti ata.

Kjo pikë duhet bërë mjaft kujdes. Kjo do të thotë që, të çohet dikush dhe të mallkojë disa myslimanë të tjerë, ashtu kuturu, haptazi, publikisht dhe të vetëkategorizohet si viktimë e padrejtësisë, kjo gjë është e diskutueshme, madje e papranueshme se sa është **“rënkim i atij që i është bërë padrejtësi”**. Kësisoj, mundet që të mos jetë ashtu siç pretendohet. Pasi ajo çfarë është përcaktuar në hadith është që të ruhet prej mallkimit të atij që vërtet i është bërë padrejtësi.

Allahu i Madhëruar i ruajtë të gjithë myslimanët nga padrejtësia e tjetrit dhe nga padrejtësia ndaj tjetrit!

Shënimet: **1)** Buhâri, Medhalim 9; Xhihad 180; Megazi 60; Muslimi, Iman 29; Ebu Davud, Zekat 5; Nesâi, Zekat 1, 46; Tirmidhiu, Birr 68; Ibn Mâxhe, Zekâ 1; Muvatta, Davetu'l-madhlum 1; Ahmed b. Hanbel, Musned, I, 223; III, 153. **2)** Buhari, Megazi 60. **3)** Tirmidhiu, Birr 68. **4)** Buhariu, Havâlât 1, 2; Istikrâz 12; Muslimi, Musâkat 33. **5)** Muslim, Birr 56. **6)** Muslim, Birr 55. **7)** Hud (11), 18. **8)** Buhari, Xhihad 180. **9)** Shih. Ibn Ebi Shejbe, *Musannef*, X, 359. **10)** Ahmed b. Hanbel, Musned, III, 153; VI, 353 (Për këto dy transmetime, Shuajip el-Arnavudi thotë se janë “me isnad të dobët”) **11)** Muvatta, (Kopja e Hasen esh-Shejbani) III, 261. **12)** Ibn Maxhe, Dua 11. **13)** Buhari, Xhihad 98; Megazi 29; Tefsiru sure 2, 42; Muslimi, Mesaxhid, 202-206; Ebu Davud, Salat 5. **14)** Al-i imran (3), 128.

Dashuria për pasurinë nuk duhet të pushtojë zemrën

Imam Adham Ebu Hanife përveç se ishte shumë i zënë me veprimtaritë edukative, ai ishte edhe një person i pasur që merrej me tregti. Ky njeri i madh nga mëngjesi deri në drekë jepte mësim në xhami, pa pushuar asnjë moment. Ndërsa pas drekës merrej me punët e tregtisë. Një ditë, teksa po jepte mësim, në xhami erdhi një burrë dhe i tha:

- O imam, anija jote u fundos!

Imam Adhami ngurroi për disa çaste pastaj tha:

- Elhamdulillah.

Pas pak erdhi përsëri i njëjti njeri dhe i tha:

- O imam, ka ndodhur një gabim. Anija që është fundosur nuk ka qenë e jotja.

Imami edhe për lajmin e ri tha:

- Elhamdulillah.

Burri që solli lajmin u çudit dhe e pyeti:

- O imam edhe kur të thashë se anija është fundosur ti falënderove Zotin, edhe kur të thashë që nuk është anija jote ti përsëri falënderove Zotin. A mund të ma shpjegosh pak?

Imam Adhami iu përgjigj:

- Kur më solle lajmin e fundosjes së anijes unë kontrollova zemrën time, në të nuk kishte asnjë gjurmë



që të tregonte mërzitje për pasurinë e kësaj bote. Për këtë arsye unë e falënderova Allahun. Kur më solle lajmin se anija e fundosur nuk ishte anija ime, unë bëra të njëjtën gjë dhe kuptova se në zemrën time nuk kishte dashuri për pasurinë e kësaj bote. Për këtë arsye falënderova Allahun që ma ka larguar interesin për gjërat e kësaj bote.

FAKTE INTERESANTE

* Kulla e parë e sahatit është ndërtuar në Moskë, ne vitin 1404.

* “Tom Sojeri” është romani i parë i shkruar në makinë shkrimi.

* Çdo grimcë sheqeri ka plot 16 kënde.

“ NJË LUTJE ”

“O Allahu im!

Më bëj mua nga robërit e Tu që kur i bëhet një e mirë, gëzohet ndërsa kur i bëhet një e keqe, kërkon falje për to.”

(Ibni Maxhe, Edeb, 57)

“ NJË PERLË ”

Kurani nuk është libër artistik, ai është libri i jetës. Për këtë arsye, sapo ta shikoni me këndvështrimin e një mënyre jetesë dhe jo linje filozofike, do të zhduken të gjitha vështirësitë.



Mendjemadhësia nuk është **VETËBESIM**

Tuba Sëkmen

Një nga temat për të cilën ekspertët flasin shpesh kohët e fundit mbi zhvillimin personal është “vetëbesimi” (besimi në vetvete). Vetëbesimi me një shpjegim të thjeshtë është besimi i njeriut në aftësinë e tij. Kjo është një veçori individuale e cila e mbështet zhvillimin personal, ia lehtëson njeriut përballjen me problemet, i jep atij energji dhe motivacion. Një person e ka më të lehtë ta mbarojë një punë, nëse e fillon atë me perceptimin pozitiv në lidhje me aftësitë e tij.

Megjithatë themelet e vetëbesimit hidhen që në vitet e fëmijërisë, është shumë e rëndësishme që prindërit të sillen me maturi. Sjellja e prindërve mund të bëhen shkak që fëmijët të kenë ose të mos kenë vetëbesim. Disa nga sjelljet mbështetëse që këshillohen për prindërit të cilët duan të edukojnë individë që i besojnë vetes, janë: t’i vësh fëmijës përgjegjësi sipas moshës që ka, ta ndihmosh të zbulojë aftësitë e tij, t’ia vlerësosh sukseset dhe t’ia nxjerrësh ato në plan të parë.

Shkrimet në lidhje me këtë temë zakonisht flasin për domosdoshmërinë e vetëbesimit dhe për problemet që hasen në rast të mungesës së tij. Në rast të mungesës së vetëbesimit individi nuk i beson aftësisë së tij dhe nuk beson se mund të ketë sukses në një punë. Nuk tenton ta bëjë një punë për të cilën mendon se nuk ka sukses. Në vende ku duhet ta tregojë veten, tërheq vëmendjen me qëndrimin e tij të ndrojtur dhe ngurues. Për të mos u përballur me mungesën e vetëbesimit te fëmijët, prindërit përpigën pa fund për t’u dhënë besim atyre, madje garojnë me prindërit e tjerë në këtë çështje.

Në këtë shkrim dëshiroj të shtjelloj një temë tje-

tër për t’u tërhequr vëmendjen prindërve. Aq sa shqetësuese është mungesa e vetëbesimit të cilën mundoheni t’u jepni fëmijëve, po aq shqetësuese është edhe teprica e tij.

Nëse personi me vetëbesim të tepërt fillon ta shohë veten më lart se të tjerët, do të thotë se brenda tij ka filluar të burojë mendjemadhësia. Vetëbesimi dhe mendjemadhësia mund të shihen në sjellje të njëjta; në të dyja rastet personi beson se do t’ia arrijë një punë, por nga ana e ndryshimit mes tyre ka një ndryshim shumë të madh. Vetëbesimi nuk është mendjemadhësi; mendjemadhësia është motra e mbërapshtë e vetëbesimit. Për një njeri mendjemadh, nuk mund të bëhet fjalë se ka besim te vetja. Por mendjemadhësia dhe vetëbesimi mund të bëhen shkak për ndjenja të ndryshme dhe sjellje të njëjta. Personi mund të mos i ndajë këto dy ndjenja të cila bëhen shkak për sjelljet e tij.

Për të bërë të mundur dallimin e këtyre ndjenjave, duhet t’i njohim më nga afër ato. Personi që ka besim në vetvete, ia atribuon suksesin përpjekjes dhe mundit të tij. Ndërsa personi mendjemadh ia atribuon suksesin veçorive të tij personale. Për shembull personi me vetëbesim thotë: “Pata sukses sepse punova”. Ndërsa mendjemadhi thotë “Pata sukses, sepse jam i zgjuar!”

Personi me vetëbesim edhe dështimin ia atribuon mungesës së përpjekjes dhe mundimit. Ndërsa mendjemadhi e kërkon arsyen e dështimit te shkaqet e jashtme. Në vend që të thotë “Nuk ia dola ngaqë nuk punova mjaftueshëm”, thotë “Nuk ia dola, sepse pyetjet ishin gjeputura!” Në këtë mënyrë në asnjë mënyrë nuk e pranon gabimin.



Prandaj personi me vetëbesim merr mësim nga dështimi dhe mund ta rregullojë gabimin, por mendjemadhi, ngaqë nuk e shikon shkakun e gabimit, nuk mund ta rregullojë atë.

Personi me vetëbesim formon një atmosferë përreth, i pranon dhe i vlerëson anët e fuqishme të të tjerëve. Ndërsa personi mendjemadh nuk mund ta pranojë faktin që dikush tjetër qëndron më lart se ai. I nënçmon dhe i poshtëron njerëzit përreth. Personi me vetëbesim është sigurt në vetvete, ndërsa mendjemadhi është vazhdimisht në shqetësimin e mundësisë për të qenë i dytë.

Ndërkohë që edukojmë fëmijën, nëse pa dijeni hedhim farën e vetëbesimit duke mos marrë parasysh vijën e hollë mes gjendjes së vetëbesimit dhe mendjemadhësisë, kjo përsëri mund të përfundojë me zhgënjim. Mendjemadhësia e cila nuk i shkon aspak njeriut, zhvillohet nga prindërit me anë të sjelljeve të gabuara stimuluese dhe vlerësuese të tyre. Për të mundësuar vazhdimësinë e sjelljeve pozitive gjatë zhvillimit të fëmijëve, stimulimet dhe vlerësimet janë shumë të rëndësishme; kjo i ndihmon fëmijët të bëhen të edukuar dhe të disiplinuar gjithashtu ndihmon edhe në zhvillimin e sjelljeve sociale.

Një çështje shumë e rëndësishme është që prindërit të mos vlerësojnë personalitetin e fëmijës, por përpjekjet e tij. Për shembull vizatimet që fëmijët e vegjël i bëjnë me shumë dëshirë, ua tregojnë të emocionuar pjesëtarëve të familjes; në këtë rast vlerësimi i familjes duhet të jetë për mundin e fëmijës, kujdesin, përshtatjen e ngjyrave që janë përdorur etj., sepse shprehjet stimuluese që i bëhen aftësisë

dhe inteligjencës së fëmijës si (“Je shumë i aftë...”, “Je shumë i zgjuar...”) bëhen shkak për forcimin e ndjenjës së egoizmit të fëmija, shkaktojnë mburrje dhe rrjedhimisht shkaktojnë mendjemadhësi.

Me të njëjtën logjikë shigjetat e kritikave që përdoren për të bërë të qartë pakënaqësinë që ndjehet nga veprimet negative, ndikojnë në drejtimin personal të fëmijës dhe bëhet shkak për mungesën e vetëbesimit të ai. Për shembull, nëse një fëmijë në klasë të parë ka ngelur pas shokëve në mësimin e leximit dhe prindërit i thonë se nuk është i zgjuar, kjo mund të bëhet shkak që gjatë gjithë jetës fëmija të formojë një mosbesim në aftësitë e tij akademike. Në vend të kësaj është më e drejtë të përdoren kritika të formës “Nuk ke punuar mjaftueshëm...”.

Vetëbesimi është një veçori e cila fitohet në ambientin familjar dhe përmirësohet nga ana e mësuesve në shkollë. Forca e vërtetë formuese që një fëmijë të ketë besim ose jo i takon familjes. Familja, nganjëherë nuk e vlerëson aspak ndjenjën e vetëbesimit dhe edukon fëmijë të ndrojtur; nganjëherë, me qëllim që të rrisin individë me vetëbesim, pa dashur i mësojnë ata të jenë mendjemëdhenj. Me zhvillimin e vetëbesimit të tepërt që prindërit u ngarkojnë fëmijëve, përpjekjet e prindërve shkojnë dëm dhe fëmijëve të dashur të tyre, u veshin me duart e veta rrobën e “mendjemadhësisë” që nuk i shkon aspak një myslimani.

Si në çdo cilësi, për të mbajtur masën në çështjen e vetëbesimit, duhet të ndiqet një metodë e ndjeshme edukimi në mangësinë dhe tepërcën e vetëbesimit.



Sulbe të zgjedhura

Naim Drijaj

Gjërat me të cilat arrihet ëmbëlsia e besimit

Enesi (r.a.), transmeton se Profeti (a.s.), ka thënë: *“Ai që ka këto tri cilësi, ka gjetur ëmbëlsinë e besimit: Të dojë Allahun dhe të Dërguarin e Tij më shumë se çdo gjë tjetër. Ta dojë një person vetëm për hir të Allahut. Ta urrejë kthimin në mosbesim (kufr), ashtu siç urren të hidhet në zjarr”*.¹ Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“E ka shijuar besimin ai që është i kënaqur me pranimin e Allahut si Zot, Islamit si fe dhe Muhamedit si të dërguar”*.²

Pejgamberi (a.s.), na ka lajmëruar, se besimi ka shije dhe zemra e shijon atë, ashtu siç e shijon goja ushqimin dhe pijen. Kush e arrin diçka të tillë, zemra i qetësohet dhe ai ka fituar kënaqësinë e Allahut.

Ëmbëlsia e besimit në Zot nuk krahasohet me asnjë ëmbëlsi tjetër, që ekziston mbi tokë. Kur njeriu e shijon ëmbëlsinë e besimit, do të thotë ashtu siç kanë thënë të parët tanë: “Sikur ta dinin pasanikët se çfarë ëmbëlsie kemi ne në zemrat tona, do të luftonin për të na e marrë, qoftë edhe me shpatat e tyre”. “Shija e imanit nuk është si shijet e tjera, sepse shija e një ushqimi largohet pas ngrënies së ushqimit tjetër, kurse shija e imanit mbetet një kohë të gjatë, sepse njeriu kur bën një ibadet me zemër, përkushtim dhe përlulje ndaj Allahut, vëren se ushqehet një kohë të gjatë me atë ibadet”³

Profeti (a.s.), ka thënë: *“Rruga e parë për të shijuar ëmbëlsinë e besimit është: “Ta duash Allahun (xh.sh.), dhe Muhamedin (a.s.), më shumë se çdo gjë tjetër që ekziston në gjithësi”*.

Abdullah ibn Hudhafe, ishte një nga shokët e profetit Muhamed (a.s.). Ai u kap rob nga bizantinët, bashkë me disa shokë të tjerë. Komandanti bizantin, bëri disa tentativa që ta thyejë dhe ta nxjerrë nga besimi, por dështoi. Fillimisht, ai e lidhi në një pemë dhe i urdhëroi ushtarët të hidhnin shigjeta drejt tij, por pa e goditur. Abdullahu nuk lëvizte fare dhe nuk tregonte shenja frike dhe dëshpërimi. Komandanti mori dy nga shokët e Abdullahut dhe i hodhi të gjallë në një kazan me vaj të nxehtë. Ai i kërkoi të braktiste fenë Islame, në këmbim të faljes së jetës, por Abdullahu sërish refuzoi. Kur e afruan pranë kazanit me vaj të nxehtë, Abdullahut i rrodhën disa pika lot. Kjo e gëzoi komandantin bizantin, pasi mendoi se e kishte rrënuar qetësinë shpirtërore, e cila e kishte karakterizuar gjer atëherë. Duke qeshur me ironi, ai i tha: “Përse qan? Apo je gati që tani ta braktisësh fenë tënde, në këmbim të jetës?” Abdullahu iu përgjigj: “Jo, unë qava pasi kam vetëm një shpirt të vetëm, të cilin do ta jap për hatër të Zotit. Do të doja që të kisha shpirta aq sa kam qime në trup dhe të gjithë t’i jepja për hatër të Zotit.”

Ibn Tejmije (Allahu e Mëshiroftë) ka thënë: “Në dynja ekziston një xhenet, kush nuk e shijon atë, nuk e shijon xhenetin e ahiretit. Ai xhenet është njohja e Zotit dhe dashuria për Të.”

Rruga e dytë për të shijuar ëmbëlsinë e besimit është: “Ta duash tjetrin vetëm për hir të Allahut”.

Vëllazëri e vërtetë është ajo që lidhet për hir të Allahut, larg interesave të dynjasë, qofshin ato poste apo gjëra materiale, sepse sado dhe sido që të jenë, ato mbeten të përkohshme. “Allahu i madhëruar Ditën e Kiametit do të thotë: ‘Ku janë ata të cilët kanë

1. Buhariu dhe Muslimi.

2. Muslimi.

3. “Kitabu Teuhid” Ibn Ulthejmini.



dashur njëri tjetrin për hir të Madhërisë Sime? Sot do të jenë nën hijen Time, në këtë ditë kur nuk ka hije tjetër pos hijes Sime.”⁴ “Allahu thotë: ‘ata që duan njëri tjetrin për hir të Madhërisë Sime, ata do të jenë në piedestale të dritës dhe do t’ua kenë lakmi pejgamberët dhe shehidët.’”⁵

“Një njeri vendosi të vizitojë vëllain e tij në një qytet tjetër. Allahu ia caktoi një melek në rrugë. Kur iu afrua meleku e pyeti: Për ku je nisur? Kam një vëlla në këtë qytet dhe desha ta vizitoj, tha ai. Meleku e pyeti: “A mos të ka borxh ndonjë pasuri dhe shpreson ta marrësh atë?” Ai tha: “Jo, unë e dua atë vetëm për hir të Allahut.” Meleku tha: “Unë jam i dërguar i Allahut te ti për të të lajmëruar se Allahu të do ty siç do ti vëllain tënd për hir të Tij.”⁶

Tregohet se Ahmed Ibn Hanbeli⁷, një dijetar shumë i madh, shkoi nga Bagdati në një vend tjetër. Nata e zuri në xhami, por pasi u fal namazi i jacisë, pastresi i saj, i cili nuk e njihte, i tha: “Dil se do të mbyll xhaminë dhe nuk lejohet askush të rrijë në xhami”. Imam Hanbeli doli në shi dhe nuk dinte ku të strehohej. Dikush e pa dhe i tha: “O njeri përse rri në mes të shiut”. Imam Hanbeli u përgjigj: “Vallahi nuk kam ku të rri sonte”. “Hajde rri tek unë” - ia ktheu tjetri. Ky person e mori Imam Hanbelin në shtëpinë e tij dhe ia ndërroi rrobat. Imam Hanbeli shikoi se ky njeri e përmendte shumë Zotin. U habit nga kjo gjë dhe e pyeti: “O njeri, po e shoh se ti po e

përmend shumë Zotin. Ç`është kjo punë”? Burri ia ktheu: “Vallahi nuk më ka dalë keq kjo punë. Me këtë përmendje që bëj, Allahu (xh.sh.), më ka dhënë një sekret. Për çdo dua` (lutje) që bëj më vjen përgjigja. Vetëm një dua nuk më është plotësuar dhe inshallah ma pranon Zoti para se të ndërroj jetë. E kam lutur Zotin të mos ma marrë shpirtin pa u takuar me dijetarin e madh Ahmed Ibn Hanbel dhe shpresoj, se Zoti do të ma pranojë këtë dua”. Atëherë Imam Ahmedi i tha: “Allahu (xh.sh.), ta ka pranuar lutjen, sepse unë jam Ahmed Ibn Hanbel”. Atëherë ky person filloi të qajë dhe ta përqafojë Imam Hanbelin. Imam Hanbeli u habit dhe pyeti: “Po ti kush je”? Ai tha: “Unë jam Is`hak Ibn Rahauej (një tjetër dijetar i madh).

Rruga e tretë për të shijuar ëmbëlsinë e besimit është: “Të urrejë njeriu kthimin në mosbesim, ashtu siç urren hedhjen në zjarr”.

Ta urresh kufrin e ta duash besimin, do të thotë të thuash gjithmonë: “O Zot! Ty të falenderoj që më udhëzove, se nëse nuk do të më udhëzoje, unë do të isha prej të humburve”.

Ta duash besimin, do të thotë të sakrifikosh për këtë gjë. Pse u hodh në zjarr Ibrahim (a.s.)?! Sepse ai e dinte se zjarri i dynjasë nuk krahasohet me zjarrin e Ahiretit dhe pranoi me kënaqësinë më të madhe, që të mbante besimin dhe të hidhej në zjarrin e kësaj dynjaje. Nuk iu lut askujt për ndihmë. Nuk kërkoi as ndihmën e Xhebrailit (a.s.), por tha: “Vetëm për Allahun (xh.sh.), kam nevojë”.

4. Muslimi.

5. Tirmidhiu.

6. Muslimi.

7. Është lindur në vitin 164 hixhri (780) në Bagdat po ashtu ka ndër - ruar jetë ditën e xhuma në të njëjtin vend më 12 Rabiul evvel 241 (31 Korrik 855).

Lidhja e Ngjyrave me Vlerat e Specave



Përse specat jeshilë janë më të lirë se specat me ngjyrë tjetër? Specat jeshilë janë më pak të pjekur se të tjerët, ato mblihen më shpejt se sa koha e duhur e pjekjes. Specat e tjerë kërkojnë më shumë kohë të marrin ngjyrën, e si rrjedhojë duan më shumë shërbim, çka i bën ata më të shtrenjtë. Çmimet variojnë sipas ngjyrave, aktualisht në treg të vetmet specat të vendit janë ata jeshilë të Divjakës, ndërsa specat e kuq janë import nga Greqia dhe Turqia dhe kushtojnë më shtrenjtë. Specat janë burimi më i mirë i Vitaminës C, por kur vjen puna te ngjyrat, ato ndryshojnë. A e dini kush është ndryshimi mes specit të kuq, të verdhë dhe jeshilë? Përveç faktit që specat me ngjyrë të ndezur kushtojnë më shtrenjtë, e vërteta është që specat jeshilë janë varianti i papjekur i specave me ngjyra më të ndezura. Thënë shkurt, speci jeshilë është i papjekur mirë. Shija e tij është pak më e hidhur dhe shpesh sipas disa studimeve mund të shkaktojë probleme me tretjen. Problemet me tretjen vijnë sepse specat janë të pabërë plotësisht. Kur hamë fruta apo perime të papjekura, stomaku e ka të vështirë t'i tresë ato.

CILËT SPECAT KANË MË SHUMË VLERA USHQIMORE?

Të gjithë specat janë një burim i jashtëzakonshëm i vitaminës A dhe C. Por të dhënat tregojnë se specat e kuq përmbajnë 11 herë më shumë beta karoten se specat jeshilë. Specat e verdhë nga ana tjetër kanë më shumë vitaminë C se specat e gjelbër por më pak vitaminë A dhe më pak beta-karoten. Specat e gjelbër kanë shumë kalium që rregullon qarkullimin e gjakut dhe mbron muskujt. Specat e kuq që janë edhe më të pjekurit kanë shije më të ëmbël dhe kanë më shumë antioksidantë të vlefshëm.

VLERAT SHËNDETËSORE TË SPECIT

Speci i ëmbël dhe ai djegës janë një aleat i rëndësishëm në përpjekjet e gjithkujt për të një peshë të ekuilibruar. Studimet kanë treguar që kapsaicina, një substancë që i bën specat djegës, fuqizon metabolismin dhe pengon formimin e plotë të qelizave dhjamore. Edhe specat e ëmbël kanë në përmbajtjen e tyre një element të njohur si CH-19 që i ngjan kapsaicinës dhe ka të njëjtin efekt kundër qelizave dhjamore përveç ndjesisë djegëse.

MBAN NËN KONTROLL KOLESTEROLIN

Kapsaicina që gjendet tek specat djegës ndihmon në uljen e kolesterolit në gjak. Sa më djegës speci aq më shumë kapsaicinë ka e si rrjedhojë aq më efektive është çdo përpjekje për të ulur kolesterolin.

LUFTON ARTRITIN

Nëse konsumon gjysëm filxhani çaji me specat të grirë (të kuq ose të verdhë) ke marrë dyfishin e dozës ditore me vitaminë C. Njerëzit që kanë doza të ulëta të kësaj vitamine në organizmin e tyre janë trefish të rrezikuar nga artriti.

I BËN MIRË ZEMRËS

Një filxhan çaji me specat të gjatë përmban 36% të dozës ditore të vitaminës B6 dhe 10 përqind folat. Specat e kuq dhe specat e verdhë kanë respektivisht 35% dhe 20% të dozës ditore të vitaminës B6 dhe 7% dhe 10% të dozës ditore të folatit. Sa më i pasur të jetë ushqimi juaj me këto përbërës, aq më i ulët është rreziku për infarkt, sëmundjet koronare dhe të zemrës në përgjithësi. Specat si edhe perimet e tjera kanë më shumë vlera ushqimore kur konsumohen të pagatuar.

Fiku i freskët



Fiqtë e kanë prejardhjen e lashtë nga Lindja e Mesme, por shtëpia e tyre natyrale gjendet në vendet e Detit Mesdhe dhe me krenari edhe në Shqipëri. Që nga lashtësia, koncepti i qytetërimeve për këtë frut dhe për pemën e tij, ka qenë ai i pemës së kënaqësisë, kjo prej ëmbëlsisë dhe mirësive të fiqve. Fiku, është një nga frutat më domethënës në historinë e njerëzimit, përmendet si fruti më i dashur i Kleopatërës së Egjiptit, madje disa studiues besojnë se "fruti i ndaluar" në Kopshtin e Edenit, nuk ishte Molla, por ka qene një pemë Fiku. Ekzistojnë rreth 150 lloje fiqsh, me ngjyra të ndryshme si të zinj, kafe, vjollcë, deri në disa variacione të fiqve të bardhë. Në Shqipëri rriten disa lloje fiqsh, disa më të hershëm në prodhim e disa të tjerë më të vonshëm, kryesisht të bardhë dhe të zinj, si edhe varietete të fiqve më të vegjël, të quajtur rreka të cilët dalin në treg në fund të verës. Turqia zë vendin e pare në botë për prodhimin e fiqve, ndërsa Shqipëria raportohet të renditet si vendi i tetë në botë për prodhimin e këtij fruti. Përmeti, Berati, Elbasani, por edhe Tirana dhe mjaft zona të tjera të Shqipërisë, sidomos asaj jugore, janë prodhuesit dhe kultivuesit kryesorë të fiqve shqiptarë, ndërkohë që një pjesë e mirë e fiqve vendas përpunohet për reçel, marmelatë, apo thahet për t'u përdorur gjatë muajve të tjerë të vitit. Fiqtë konsiderohen si një ndër frutat që kanë ndikim

pozitiv në shëndetin e njeriut. Të shijshëm dhe të ushqyeshëm, fiqtë janë një zgjidhje e mrekullueshme për shkak të vetive të tyre, të cilat po i listojmë në vijim.

1. Fiqtë kanë veti tretëse të shkëlqyera, për shkak të enzimave të cilat bëjnë të mundur asimilimin e ushqimeve dhe substancave si kalciumi, hekuri, potasi, magnezi dhe vitaminat A, B1, B2, B6, PP dhe C. Ata konsiderohen një aleat i mirë i aparatit tretës.

2. Janë anti inflamatorë. Ndihmojnë në rastet e enjtjeve dhe infeksioneve. Fiqtë luftojnë inflamacionet e mushkërive dhe ato të rrugëve urinare, por edhe kolitin e gastritin.

3. Ruajnë shëndetin e syve, lëkurës, kockave dhe dhëmbëve, kjo falë substancave ushqyese që kanë në përbërjen e tyre. Fiqtë lejla janë më të përhapurit dhe më të ëmblit nga të gjitha llojet. Fiqtë jeshilë janë më të lëngshëm dhe kanë një lëkurë më të hollë. Fiqtë e zinj janë më të thatë dhe qëndrojnë më gjatë në pemë në krahasim me të tjerët. Fiqtë e vegjël rreka janë paksa të rrudhosur dhe me një shije mes fiqve të thatë dhe atyre të njomë.



SHPJGOHET PARADOKSI I TRURIT TË ADOLESHENTËVE

Gjatë adoleshencës truri përfiton më shumë materie gri, ja përse përmirësohen aftësitë konjitive, ndonëse bie në volum.

Këtë çështje që shkencëtarët e studiojnë prej dekadash e zgjidhën disa studiues të drejtuar nga Ruben Gur, në Universitetin e Pensilvanisë.

Ky fenomen bie më shumë në sy tek vajzat, truri i të cilave ka dimensione më të vogla, për shkak të proporcioneve trupore, por ka dendësi më të madhe të materies gri. Kjo shpjegon përse rezultatet e tyre janë ekuivalente me ato të meshkujve.

Prej vitesh teoria e përgjithshme mbi zhvillimin njerëzor bazohej mbi idenë se materia gri, që gjendet

në pjesët e trurit që kanë lidhje me kontrollimin e muskujve, shikimit, dëgjimit, memories, emocioneve, të folur, vendimmarrjen dhe vetëkontrollin, zvogëlohet gjat adoleshencës.

Por, ideja se një volum më i madh i trurit përkon me performancë konjitive më të lartë nuk shpjegon përse këto rriten shumë nga fëmijëria tek adoleshencën, pikërisht kur vëllimi bie.

“Nëse mbeteni të habitur nga sjelljet e adoleshentëve në një moment kur ju kërkohen më shumë rezultate dhe se duhet të kenë një sjellje më të pranueshme, mund të ndihmojë të dimë faktin se truri i tyre në këtë periudhë ndryshon në dimension dhe përbërje”, shpjegon Gur.

BIMËT MUND TA DËGJOJNË UJIN!


Bimët kanë shqisa shumë më të zhvilluara nga sa mund të mendohet, në veçanti të dëgjuarit, që e ndihmojnë në luftën për mbijetesë, sipas një studimi nga universiteti “Western Australia”, ku tregohet se bimët mund të dëgjojnë zhurmën e ujit që rrjedh nën tokë ose nëpër tubacione dhe të rrisin rrënjët e tyre në drejtim të burimit.

Për më tepër ky studim ka treguar se bimët nuk i pëlqejnë disa zhurma kanë tendencë t’i largohen. Studiuesit kanë analizuar bimë të bizeles, duke i vënë të dëgjojnë një seri tingujsh si ai i ujit që rrjedh. Duke vërejtur sjelljen e tyre kanë zbuluar se bimët

njohin zhurmën e ujit dhe rrisin bimët vetëm në atë drejtim.

Një aspekt tjetër i jashtëzakonshëm është se bima është në gjendje të njohë zhurmën e ujit të vërtetë dhe atij të regjistruar. Por nëse në tokë është e pranishme sasia e nevojshme e ujit, bima nuk i përgjigjet më zhurmës.

“Vetëm tani po fillojmë të kuptojmë kompleksitetin e ndërveprimeve të bimëve me tingujt dhe si i përdorin për të marrë vendime”, deklaroi Monica Gagliano, drejtuesja e këtij studimi.



Allahu
nuk e ndryshon
gjendjen
e një populli,
derisa ata të
ndryshojnë
veten e tyre.

(Rad, 11)